

Një nga gazetarët më të mëdhenj të shekullit XX, në vitin 1963 vizitoi Shqipërinë dhe shkroi këtë reportazh.

JAMES CAMERON:

SHQIPËRIA: PARAJSA E FUNDIT MARKSISTE

Përktheu dhe përgatiti Ndrek Gjini (Dublin, Irlandë)



90-vjetori i lindjes

Adem Demaçi i letërsisë

Nga Ymer Çiraku

Pjesë e aktivitetit të tij të shumanshëm është edhe krijimtaria letrare. Kjo krijimtari, është e përmbledhur dhe botuar tashmë në 10 vëllime në Kosovë. Që në krye të një studimi të gjerë e mjaft vlerësues, bën përshtypje pohimi i studiuesit të mirënjohur Rexhep Qosja se kjo krijimtari nuk mund që të prezantohet dot asnjëherë e plotë dhe kjo, pasi aty ka jo pak pjesë të munguara, të cunguara, të ndaluara, të konfiskuara, pse jo, të mallkuara, nga censura shoviniste - nëpër vite të ndryshme.

(fq. 6)

“Vatra”, “Onufri” dhe Qendra Kulturore “Nënë Tereza” promovuan romanin “Brenja” të autorit Dr. Pashko Camaj

Nga Sokol Paja

(fq. 22)

SHËNIME MBI LIBRAT

Rreth vëllimit me poezi të zgjedhura “Nata një kryq i bardhë dashurie.”

Individualiteti krijues i një poeti filozof, Nuri Plakut

Prof. Dr. Klara Kodra

(fq. 7)

Rreth poezisë filozofike të Aleksandër Çipës

ERA E DETIT ZGJON
KUJTESËN

Nga Philippe Preux

(fq. 8)

Mbi tregimin “Eksperiment dashurie” të Aleksandër Kluges
Një eksperiment dashurie në kampet e përqendrimit

Nga Xheni Shehaj

(fq. 9)

Dy fjalë për autorin e romanit “Bonjakët”, skenaristin e filmit artistik shqiptar “Lulëkuqet mbi mure”, mikun tim Petraq Qafëzezi

Jeta ka gjithmonë një mënyrë për të lulëzuar...!

Nga Ilir Çumani

(fq. 10)

“Zenit Gallery”, Tiranë – ekspozita vetjake e artistit austriak Peter Assmann

“Peter Assmann – një parathënie artistike për të drejtat e njeriut”

Nga Ylli Drishti

(fq. 19)



Fernando Pessoa, diamanti me shkëlqim të fshehtë

Nga Pirro Loli

(fq. 14)

Imazhi në përmasën kohore të Prustit


Nga Xhyher Cani, PhD

(fq. 20)

Paul Éluard,
poeti i surreales

Nga David Staker

Përktheu: Jola Tasellari



(fq. 18)

BIBLIOTEKË

Enver Kushi

(fq. 15)

Rrëfime në kohë pa kohë

Odise Kote

(fq. 13)

Gjylyzari

Ag Apolloni

(fq. 12)

Blloku i Bostonit

Oscar Wilde

(fq. 16)

Tragjedi florentinase

Përktheu: Orin Manxhari

Mirela Papuçiu

(fq. 23)

Ikja e diejve

Arben Meksi

(fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Arti është politikë dhe politika është art


Nga Dr. Bledar Kurti

(fq. 13)

Libri shqip
në Amerikë

Dërgesa të shpejta e të sigurta
brenda SHBA-së

www.albllibris.al



Për vite me radhë, shumë kohë para prishjes së marrëdhënjeve mes Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik që ndau botën lindore, dhe e shndërroi këtë enklavë të vogël komuniste në fenomenin politik të kohës, kisha ushqyer një ambicie të çmendur për të hyrë në Shqipëri.

Duhet ta pranoj se qëllimi im nuk ishte plotësisht akademik; në të padysim përzihej një lloj kureshtjeje koleksionisti. Rasti e solli që të kisha punuar, ose të paktën vizituar, pothuajse çdo vend në botë; udhëtimi ishte profesioni im. Por, ndonëse kisha kaluar nëpër të gjitha shtetet komuniste, përfshirë edhe Kinën, Shqipëria më dukej e padepërtueshme. Herë pas here bëja përpjekje zyrtarisht pranë misioneve dhe konsullatave shqiptare në Paris, Romë, Ankara, Sofje — përfaqësi diplomatike të vendosura në rrugica të panjohura. Dhe gjithmonë përballeshë ose në refuzim të plotë për të folur mbi këtë çështje, ose — më shpesh — me një dëre të mbyllur, ku varej një tabelë e pluhurosur që shpjegonte se funksionari kishte dalë për drekë. Kështuqë kisha hequr dorë prej kohësh nga ideja për të vizituar Shqipërinë.

Dhe pastaj, papritur, u gjenda aty.

Disa muaj më parë, një reklamë e një agjencie udhëtimi në Këln doli në një gazetë të Gjermanisë Perëndimore, duke njoftuar një udhëtim në grup, tetëmbëdhjetëditor nëpër Shqipëri. Asgjë në të nuk linte të kuptohej se u drejtohej vetëm komunistëve. Për pasojë, duke ndjekur parimin që gjithçka duhet provuar të paktën një herë, dërgova një kërkesë për t'iu bashkuar këtij udhëtimi, i bindur se ajo do të refuzohej — ose, më shumë gjasë, do të injorohej. Për habinë time, përgjigjja erdhi menjëherë, shoqëruar me disa formularë për t'u plotësuar, një kërkesë për një kapar prej njëqind paundësh dhe lutjen që pasaporta ime të dërgohej në Gjermani për t'u pajisur me vizë shqiptare. Supozohej se kjo do të kryhej në Berlinin Lindor.

Nuk ndjeva asnjë shtysë për t'ia besuar pasaportën time një zyre udhëtues gjermane pa adresë të qartë. —Kjo pasi, nga pasaporta ime varej puna ime, njësoj si një punëtori veglat apo një mjeku diploma. Megjithatë, këto çështje sot janë më të lehta se dikur për t'u zgjidhur. Një konsultim i shkurtër në vendin e duhur prodhoi një pasaportë tjetër, e cila u nis në rrugën e saj drejt Gjermanisë.

Për javë të tëra nuk ndodhi asgjë. E lashë çështjen mënjanë. Pastaj, me atë lloj befasi spektakolare që duket se karakterizon shumicën e gjërave që më ndodhin mua, mbërriti një mesazh urgjent: turneu do të zhvillohej, grupi ishte gati. Me sa dukej, kishte një fluturim inaugurues të linjës holandeze drejt Tiranës. Do të shkoja menjëherë, më tha agjencia, në Mynih, ku grupi turistik do të mblidhej në aeroport dhe ku do të merrja pasaportën dhe vizën time turistike shqiptare?

M'u duk se duhej të kishte diçka ose tepër naive, ose tepër tinëzare në një agjenci që mund të propozonte me aq qetësi që një njeri të udhëtonte nga një vend në tjetrin për të marrë pasaportën e vet. Megjithatë, iu binda; nëse ata nuk kishin ndërmend të bënin pyetje, as unë s'kisha përse të bëja. Kështu arrita në Mynih, dhe aty nisi komedia.

Pranoj se më kishte shkuar ndër mend se, ndonëse plani im për të depërtuar në Shqipëri si pjesë e një grupi turistësh ishte mjaft i zgjuar, ai s'mund të ishte domosdoshmërisht i vetmi. Ishte e mundur që ndonjë tjetër shkrimtar, gazetar apo profesionist i ngjashëm të ishte bashkuar me këtë trupë vizitorësh të pafajshëm. E pranova këtë mundësi dhe u përgatita aq sa munda.

Por ajo që nuk e kisha pritur të gjeja në takimin tonë në Mynih ishte kjo: nga shtatëmbëdhjetë vetët që ishim, nuk kishte asnjë që mund të quhej, në asnjë kuptim, turist.

Kjo nuk kërkonte ndonjë talent të veçantë për t'iu kuptuar, sepse, larg së qenit të fshehtë për qëllimet e tyre, gjithë grupi — përveç meje — ishte dukshëm i ngarkuar me pajisje teknike: kamera 35-milimetrëshe, tripodë, aparaturore zanore, ndriçime dhe lente, tela e kabllo, dhe makineri televizive të rënda e të ndërlikuara, ndërsa rrinin përreth me qëndrimin dukshëm të lodhur, si të atyre që janë mësuar me të tilla punë.

Kështu, kur grupi ynë "turistik" disa orë

Një nga gazetarët më të mëdhenj të shekullit XX, vizitoi Shqipërinë në vitin 1963 dhe e botoi këtë reportazh në revistën "The Atlantic", qershor 1963

JAMES CAMERON:

SHQIPËRIA: PARAJSA E FUNDIT MARKSISTE

Përktheu dhe përgatiti gazetari Ndrek Gjini (Dublin, Irlandë)



James Cameron (17 qershor 1911 – 26 janar 1985) ishte një gazetar britanik.

Ai lindi nga prindër skocezë në Battersea të Londrës; babai i tij ishte shkrimtar. Filloi karrierën në mesin e viteve 1930 në të përjavshmen The Weekly News, më vonë punoi në gazetën Daily Express. Pas luftës shkroi ndër të tjera për testet bërthamore në atolin Bikini, u bë pacifist dhe në vitin 1957 ishte bashkëthemelues i Fushatës për Çarmatimin Bërthamor.

Pas largimit nga Daily Express (1950), për një kohë të shkurtër kontribuoi në revistën foto-gazetareske Picture Post, ku së bashku me fotografën Bert Hardy mbuloi Luftën e Koresë. Në vitin 1952 publikoi në The Illustrated London News një ese nekrologjike "The King Is Dead" për vdekjen e mbretit Xhorxh VI. Më pas punoi në gazetën News Chronicle.

Në vitin 1965 udhëtoi në Vietnamin e Veriut, ku realizoi intervista me udhëheqës politikë, përfshirë Ho Chi Minh (fotografuar nga Romano Cagnoni). Reportazhin nga ky udhëtim e botoi në librin Here Is Your Enemy (1965).

Në fund të jetës shkruante kolumna për The Guardian dhe punonte në televizion. Vdiq nga një goditje në tru gjatë gjumit në shtëpinë e tij në Londër, në moshën 73 vjeç.

Nga viti 1987 deri në vitin 2016 u dha Çmimi "James Cameron"

më vonë mbërriti më në fund në Tiranë. Ai ngjante më shumë me ndonjë grup të një klubi gazetarësh të dehur që vinte nga një feste fund viti, sesa me një grup turistësh kureshtarë të etur për kënaqësi.

Ky fakt, natyrisht, i befasoi disi zyrtarët e aeroportit shqiptar, të cilët, me shumë qetësi, u përmbajtën nga çdo koment. Ju jeni turistë?, — thanë ata, ndërsa pasaportat zhdukeshin një nga një në një çantë të zeze lëkure. Të gjithë pohuam me zell. Shumë mirë, tha zyrtari me një ton të qetë: — Mirë se erdhët; dhe ne zbritëm nga aeroplani.

Nuk e di çfarë kisha pritur. Shumica e aeroporteve të republikave lindore janë, nga përvoja ime, më shumë a më pak të njëjta: kanë një cilësi të përbashkët të ftohtë e pa hijeshi, ndodhen gjithmonë në fund të rrugëve të gjata e të drejta dhe janë të ngarkuara me pritjen e delegacioneve "të partive komuniste vëllazërore".

Tirana premonte çdo lloj ndryshimi. Nën dritën e zbehtë të mbrëmjes ajo ofronte një skenë bukurie magjepsëse: në sfond, male si të gdhendura çuditshëm, një pamje e purpurt mbi blunë që errësohej, një luginë e gjerë mes shpateve me ullinj, një bllok ndërtesash të ulëta që vetëm me mirësjellje mund të quheshin aeroport, e megjithatë të rrethuara dhe të mbushura me trëndafilë. Përtej perimetrit mund të shihja dy skuadrone avionësh MIG të modelit të vjetër, tashmë shumë të ndryshkur; mes tyre dhe pistës, një plak me qeleshe kujdesej për një tufë delesh.

Kontrolli në aeroport ishte i zakonshëm, tipik i modelit të Demokracive Popullore, i kryer me një mirësjellje të paqte dhe të ftohtë, por që u ndërpre në mënyrë befasuese nga një kamarier me mëngë të përveshura që mbante një tabaka me gota të vogla rakië. Inspektorja e doganës e pranoi me qetësi gjithë teknologjinë televizive, dhe pronarët, mbi të cilët kishte rënë

një lloj heshtje e dëshpëruar, filluan ngadalë të gëzoheshin. Por siç doli më pas, ky gëzim ishte i parakohshëm. Zyrtarët shqiptarë nuk kishin aspak ndër mend të lejonin përdorimin e kamerave; përkundrazi, kishin shpikur një teknikë frymëzuese disiplinore. Në vend që t'i konfiskonin pajisjet, ata i mbyllën në pako, i vulosën dhe ngulmuan që pronarët t'i merrnin me vete, duke u përkulur nën peshën e gjithë atij mekanizmi që nuk kishte asnjë qëllim tjetër, përveçse t'u kujtonte, se në rast se i hapin apo i përdorin do kishin pasojë.

Gjendja ime ishte krejt ndryshe, dhe qëndrimi im prirej (sërisht, nga një optimizëm i marrë) drejt vetëkënaqësisë. I vetëm mes këtij grupi të rremë njerëzish, më dukej se unë kisha bërë përpjekje për t'iu dukur si turist — të paktën në atë që nuk mbaja asgjë të veçantë me vete: as makinë shkrimi, as fletore. Megjithatë, ishte valixhja ime e pafajshme dhe e dukshme që e tërhoqi më shumë vëmendjen e zonjës së doganës, sepse, në fakt, valixhja ime përmbante gjysmë duzine librash me botime të lira — një a dy romane, një libër esesh dhe Tristram Shandy-n, të cilin e kisha zvarritur rreth e qark botës për vite të tëra, duke pritur ditën kur, nga mërzia më e madhe, do të ndihesha i detyruar ta lexoja.

Zonja e doganës i nxori librat në banak me shpejtësi të rrufeshme dhe i shikoj me dyshim, krejt e pakënaqur, si një udhëheqëse skautësh që nuk është e sigurt nëse ato janë ndonjë përktim bullgar i Henry Miller. Pas pak ajo i mori librat në një dhomë tjetër, ku iu bashkuan edhe dy zyrtarë të tjerë, dhe për një kohë pashë kokat e tyre të përkulura bashkë me njëfarë hutimi përçmues. Kur zonja e doganës u kthye, ajo e mbylli valixhen, por librat nuk ishin më aty, dhe nuk i pashë kurrë më.

Hipëm në një autobus dhe u nisëm drejt Tiranës përmes muzgut që binte. Rreth nesh madhështia fizike e vendit zbehej në errësirë, dhe cingërima e brumbujve kumbonte mes pemëve. Gjatë rrugës me gropa kaluam pranë grupeve të njëpasnjëshme ushtarësh; të rinj me uniformat e dala mode të Ushtrisë Sovjetike — pjesë e ndihmës ruse, që mua m'u duk mjaft e përkorë — nga ditët kur të dy vendet ende kishin miqësi me njëri-tjetrin. Në atë mbrëmje të parë, më dukej sikur Shqipëria ishte e banuar vetëm prej djemve ushtarë, me koka të qethura, me rroba gri dhe çizme të buta të gjata. Kjo përshtypje do të ndryshonte shpejt; megjithatë, ky komb i vogël ishte, në mënyrë të dukshme, më i tejmbushuri me ushtri nga të gjithë që kisha parë ndonjëherë në botë.

Nuk kishte asgjë për t'iu habitur. E gjithë e kaluara e historike e Shqipërisë ka qenë pothuajse një varg i pandërprerë trazirash dhe dhune — një histori pushtimesh dhe tiranish, shtypjesh dhe kryengritjesh, okupimesh dhe çlirimesh, pushtimesh të hidhura dhe revolucionesh të përsëritura. Shqipëria është një vend me gjenezë të fortë fisnore e lufrash të pafundme; shto këtu faktin që popullsia shqiptare ishte ende kryesisht myslimane, me gjithë ekskluzivitetin dhe mbylljen shpirtërore që kjo fe sjell, dhe kur shton mbi to dhe disiplinën e reja të komunizmit të shekullit njëzet kjo nuk përbën më çudi.

Ndërsa dritat e zbehta të Tiranës afroheshin, ndjeva se Shqipëria ishte një vend i vështirë për t'iu ndjerë si në shtëpi.

Shqiptarët janë ndër popujt më të lashtë të Evropës, fiset ilire që arritën të ruanin identitetin e tyre nën grekët për gjashtë shekuj para Krishtit, që mbijetuan pesëqind vjet nën pushtimin romak dhe pesëqind të tjerë nën bizantinët, që zgjodhën këto male të pashkelura si fushëbetjeje e tyre kundër mbretërisë bullgare. Shqipëria ishte ura e kalimit për sulmet e njëpasnjëshme të Evropës drejt lindjes – normanët në shekullin e njëmbëdhjetë, venedikasit në të trembëdhjetin. Edhe pas pushtimit të madh turk në vitin 1478, shqiptarët nuk pranuan të bëheshin kolonë të bindur por vazhduan të ishin shqetësimi më i madh në Perandorinë Osmane edhe për katërqind e pesëdhjetë vjet të tjera.

Kur austro-hungarezët, francezët dhe italianët ishin përpjekur shumë për Shqipërinë gjatë Luftës së Parë Botërore, erdhi ndërmjetësimi i çuditshëm i prijësit fisnor Ahmet Zogu, i cili në vitet 1920 shpalli veten fillimisht President, pastaj Mbret, dhe që u zhduk si era me pushtimin italian të Musolinit në Pashkën e vitit 1939.

Në rrjedhën e pashmangshme të kohërave, Lufta e Parë Botërore solli fashizmin, e dyta solli komunizmin. Duke përfutur nga plagët e tmerrshme të viteve të luftës partizane dhe duke numëruar humbjet e tyre – 28.000 të vdekur, 43.000 të deportuar në kampet e përqendrimit, 60.000 shtëpi të shkatërruara – partizanët e maleve shqiptare shpallën Republikën e tyre Popullore në vitin 1946, nën përkrahjen e Bashkimit Sovjetik. Kështu kaloi muaji i tyre i mjalit për pesëmbëdhjetë vjet. Pastaj erdhi divorci i madh. Përsëri, ky komb mjaft i vogël, por me krenari të madhe dhe të zjarrtë, mbeti sërish vetëm.

Hoteli në Tiranë ndodhej paksa larg bulevardit kryesor, pas një brezi me pisha të gjelbërta. Ishte çuditërisht madhështor. Si pothuajse çdo gjë tjetër me pretendime të larta në qytet, kishte qenë ndërtuar nga italianët në një çast frymëzimi të bollëku, por prej kohësh kishte marrë atë zbehtësi pa ngjyrë, dhe ftohtësi që karakterizon të gjitha hotellet e demokracive popullore. Kjo është e vështirë të përkufizohet; ndofta ka të bëjë me kursimin. Dhe dallohet gjer dhe në zbehtësinë e llambave të dobëta elektrike, me mos funksionimin e ashensorëve, me boshllëkun e pluhurosor të vitrinave, me ngjyrën e çarçafëve, me mungesën e shërbyesve dhe me numrin e shtuar të funksionarëve hijerëndë e të pidentifikueshëm që nuk dukeshin as si pjesëtarë të stafit, as si mysafirë. Këto gjëra, nga përvoja ime, i gjen në çdo hotel të vendeve komuniste, dhe shpjegohen thjesht me faktin se, me kalimin e kohës, ato hotele kanë pushuar së qeni hotele dhe janë shndërruar në institucione, siç e kërkon jeta në shoqëritë ku njerëzit veprojnë vetëm me instruksione të posaçme.

Megjithatë, Hoteli “Dajti” në Tiranë krijonte aq mikpritje sa i lejohej, e kjo edhe nga mungesa e përvojës. Për të kundërshtuar fjalët e disa turistëve se Shqipëria është vend i papastërtisë së paparë, e gjithë hapësira mbante erë mikatësh e dezinfektuesish.

Mua më dhanë një dhomë të madhe, të trishtë, por të pastër, me një banjë të stolisur në detaje, madje dhe me vaskë – pa dyshim një kujtim i pushtimit italian. Bollëku i çezmave e rubinetëve prodhonte një seri zhurmash të zbrazëta dhe gërvishitjesh, por as një pikë ujë në to. Nga pesë llampat e dritës në mur, vetëm një ishte në punë, duke dhënë një dritë mjaft të zbehtë.

Ishte e padrejtë të ankoheshe. T’i kërkoje Shqipërisë, mikpritjeje për turistët – madje për turistët të maskuar si ne – ishte absurditet. Dhe megjithatë, fakti i çuditshëm ishte që Shqipëria vërtet bënte sikur besonte se ishte një qendër turistike. Holli i zymtë i hotelit ishte mbushur me fletushka dhe broshura që lavdëronin “pasuritë arkeologjike”, “kulturën artistike”, “jetën shoqërore”, “traditat etnografike”. Disa dukeshin sikur kishin qenë aty prej shekujsh; të tjerat, qartë, ishin të reja. Ishin shtypur në gjermanisht, frëngjisht, rusisht dhe italisht. Të printohej një version anglisht, mbase, ishte e pavlefshme. Amerikanët nuk lejohen, me Britaninë nuk kanë patur marrëdhënie që nga viti 1946, kur Shqipëria, në mënyrë të papërshtatshme, kishte minuar dy nëndetese britanike në Kanalin e Korfuzit.

Nuk kishte arsye përpjekja për të tërhequr vizitorë, ndërkohë që ishte pothuajse e pamundur hyrja në vend? Tani, natyrisht, nuk kishte më as rusë. Ndarja e madhe mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik mund të ketë qenë një nga fenomenet më të çuditshme të kohëve të fundit, që shprehte dallime doktrinare me rëndësi shumë më të gjerë sesa vetë Tirana, por ndikimi i saj mbi Shqipërinë ishte i qartë. Shqipëria ishte si një degë e bllokuar nga lumi sovjetik- dhe po thahej dukshëm.

Përçarja midis Nikita Hrushovit dhe udhëheqësit shqiptar, gjeneral Enver Hoxha, kishte filluar të ziente ngadalë që nga viti 1959 dhe shpërtheu në verën e vitit 1961. Në fakt, gjithë grindja ishte pjesë e përçarjes në rritje midis Rusisë dhe Kinës, me Shqipërinë që luante rolin e topit politik të ping-pongut – gjë që tani është tashmë e dukshme; kështu që Shqipëria e vogël papritur u gjend duke mbajtur lart flamurin e marksizëm-leninizmit të pastër kundër valës korruptuese të “revizionizmit sovjetik” dhe “imperializmit të Titos”.

Thuhet se zënka filloi kur Hrushovi, gjatë vizitës së tij zyrtare tek Enver Hoxha, u bë i vetëdijshëm për herë të parë për prapambetjen e madhe dhe të thellë të Shqipërisë, madje edhe sipas standardeve ballkanike, dhe, në mënyrë atërore, e këshilloi atë të hiqte dorë nga planet e çmendura për industrializim. Shqipëria është një vend me natyrë fshatare të prapambetur, thuhet se i tha Hrushovi; le të mjaftohet me rritjen e domateve dhe ullinjve, dhe të mos merret me rafineri çeliku dhe fabrika plehrash kimike. Lehtë mund ta imagjinosh se pse Hrushovi e tha këtë. Por këto fjalë të tij nuk patën asnjë efekt tek gjenerali gjakatar Hoxha.


Dhe më pas stuhia shpërtheu; Hrushovi e dënoi Shqipërinë në Kongresin e 20-të të Partisë, pezulloi çdo ndihmë sovjetike, tërhoqi të gjitha kreditë, thirri mbrapsht të gjithë teknikët dhe e harroi Shqipërinë përfundimisht. Godina e madhe dhe luksoze e ambasadës së re sovjetike në Tiranë, që ishte në ndërtim e sipër, u ndal në gjysmë të punimeve dhe që nga ajo ditë ka mbetur ashtu siç e lanë punëtorët rus- pa çati.

Goditja për ekonominë shqiptare, aq ekonomi sa ekzistonte, qe sigurisht e tmerrshme, por edhe më e rëndë qe goditja e krenarisë. Duke mos pasur asnjë kartë ekonomike në duar me të cilën të kundërpërgjigjej, Shqipëria mund të merrte hak vetëm në një mënyrë që sot ende duket disi komike: e ringriti në piedestal Stalinin. Në Moskë, Pragë, Sofje dhe Bukuresht, statujat e Stalinit u hoqën; në Tiranë, përkundrazi, bustet e tij të mëdha prej betoni jo vetëm që nuk u lëvizën, por u stolisën me lule. Ishte një rast i përsosur, një shembull i pastër dhe i dukshëm i këmbënguljes njerëzore të kthyer në aksion kombëtar. Kishte diçka pothuajse të admirueshme në atë arrogancë të pakuptimtë.

Por e gjithë kjo e la Shqipërinë pa asnjë mik në botë – përveç kinezëve. Afrimi i ri diplomatik midis Kinës dhe Shqipërisë i çuditi shumë të gjithë, sepse vështirë se mund të përfytyroheshin dy kombe për të cilat një aleancë kaq ekskluzive do të ishte më e pamundur nga ana kulturave dhe e temperamentit dhe më e pa kuptimtë nga ana e numrit të popullsisë: Kina kombi më i madh në botë dhe Shqipëria një nga më të vegjlit; Kina një vend i madh oriental me 650 milionë banorë dhe Shqipëria një provincë ballkanike me 1.6 milionë, të ndarë jo vetëm nga shtatë mijë milje, por nga çdo ndryshim i mundshëm njerëzor, tradicional, racor e gjuhësor – madje si mund të komunikohet?

Edhe po të pranohesh se marrëdhënia ishte në fakt një mbulesë politike – që Shqipëria ekzistonte vetëm për t’u anatemuarr nga Rusia dhe lavdëruar nga Kina – gjithsesi, kinezët duhej të bënin diçka për këtë, dhe nëse po, çfarë? Thuhej se kinezët kishin dhënë një kredi prej 140 milionësh. Por ç’ishte kjo “prania kineze” në Shqipëri – ku ishin vallë këto ndihma?

Nuk mund të pritej, sigurisht, që rrugët e Tiranës të kumbonin tani nga thirrjet e djemve të rinj kinezë ose nga zërat e kuadrove që flisnin mandarinisht e vishnin kostume blu. Megjithatë, sapo kisha dëgjuar se dy aeroplanë



të rinj me teknikë kinezë kishin mbërritur së fundmi në vend – për të bërë çfarë, vallë?

A do t’u këshillonin shqiptarëve mënyrën e mbledhjes së ullinjve?

Në të vërtetë, disa qindra kinezë në Shqipëri sillleshin saktësisht ashtu siç sillleshin rusët dikur në Kinë tetë vjet më parë: mbanin kokën ulur dhe qëndronin në heshtje, jashtë syve të publikut. Vetëm një herë, ditën e dytë në Tiranë, u futa gabimisht në një pjesë të gabuar të restorantit – dhe ja ku ishin ata, rreth dy duzina kinezësh, duke ngrënë të ndarë dhe të përmbajtur. Më panë të habitur dhe unë u tërhoqa me ndrojtje.

Dy ditë përpara se të bëja atë gafën e pashlyeshme, e pata krejt Tiranën në dispozicion, shetisja i lirë kudo. Magjia e këtij qyteti vinte më shumë nga e vjetra sesa nga e reja. E reja ishte përnjëmend banale: një rrjet rrugësh të gjera, madje madhështore, të rreshtuara me godina ministrishë në stil italian, me bulevardet aq të gjera sa të mbanin disa kors automjetesh, por që në 80 për qind të ditës ishin krejt bosh.

Zbrazëtia e rrugëve ishte tronditëse. Në çdo kryqëzim qëndronte një polic trafiku me uniformë të bardhë, i gatshëm për të drejtuar një vrull automjetesh që nuk vinte kurrë. Ndoshta një herë në pesë minuta shfaqej një kamion i vjetër jeshil, me numra të mëdhenj anash, në stilin rus, që ngjitej rrugës duke gërvishitur e gjëmuar; polici ngrihej në gadishmëri dhe e përshëndeste me një lëvizje të ngrohtë, pa pasur asnjë mjet tjetër përballë. Me më pak se atë shpeshësi kalonte ndonjë limuzinë ZIM e zezë, e mbuluar me perde të trasha, në ndonjë mision misterioz zyrtar. Në gjithë Shqipërinë sot, siç më thanë zyrtarisht, nuk ekziston as edhe një veturë private.

Poshtë Bulevardit të “Shqipërisë së Re”, përtej Sheshit “Skënderbej”, ku statuja gjigante e Stalinit qëndronte e errët mbi pyllin e flamujve që kërkonin jetë të gjatë për

shtetin e punëtorëve, Tirana shuhej ngadalë mes një rrjeti rrugicash të ngushta e të varfra, gjithnjë e më tërheqëse. Aty, ku zanatxhinjtë rrihnin llamarinat e tyre e grykët e ibrikëve, shëtisnin lloje shqiptarësh që njeriu s’do t’i kishte imagjinuar ndofta kurrë jashtë ndonjë feste folklorike. Gjysma e njerëzve vishnin stofin e zbehtë të proletariatit urban, por gjysma tjetër, pa asnjë sjellje të ndrojtur, ecte krenarë me qeleshen e bardhë maqedonase, me xhubletën e qëndisur dhe me pantallonat e gjera të malësorit mysliman. Shqipëria duhet të jetë ndër vendet e vetme ku ajo që quhet “veshje fshatare” vishet vërtet nga fshatarët. Kjo u jepte rrugicave të Tiranës një hijeshi të shpenguar.

Këta burra të egër e madhështorë kishin një zakon të unik dhe të bukur: mbanin lule në gojë, ashtu siç mbajnë disa të tjerë një karafil në xhakëtë. Dhjetëra herë mund të takoje ndonjë burrë fytyrëzë, me mustaqet të trasha dhe pamje grabitqari, nga buzët e vyshkura të të cilit varej një trëndafil ose një degë jasemini. Kjo pamje të jepte një përshtypje të çuditshme, si tek ajo e demit Ferdinand. Edhe ushtarët e fytyrë zbehtë e të rroga grisur e gjallëronin disi fytyrën e vrejntur e me këtë zakon të shkujdesur. Një herë, jashtë Tiranës, pashë një roje të fytyrë ngrysur në një post-blok të rrethuar me tela, që kishte futur një tufë lulesh të egra tek gryka e pushkës së tij.

Problemi i parë dhe shumë serioz me të cilin u ndesha ishte ai i komunikimit. Shqiptarët flasin një gjuhë që, sipas meje, të cilën po të guxosh ta flasësh ndeshesh me vështirësi të pakapërcyeshme. Kjo gjuhë më ngjan me një lloj turqishteje të miksuar me ndërlikime të rënda sllave, që nuk mund të mësohet kurrësi brenda natës. Ka, ndër të tjera, një alfabet prej tridhjetë e gjashtë shkronjash, me shtatë zanore dhe njëzet e nëntë bashkëtingëllore. Fjalët për “po” dhe “jo” janë po dhe jo, por kjo s’duhet ta mashtrojë

askënd për thjeshtësinë e saj. Së shpejti zbulova, për shembull, se Shqipëria, në gjuhën e vet, nuk quhej aspak Albania, por Shqipëri, gjë që më tingëlloi si diçka krejtësisht e paarsyeshme.

Sado e pakuptueshme të dukej shqipja, pak njerëz flisnin ndonjë gjuhë tjetër. Meqenëse grupi ynë turistik kishte ardhur nga Gjermania (dhe madje përbëhej kryesisht nga gjermanë), përkthyesi i ngarkuar fliste gjermanisht, gjë që nuk më ndihmonte, pasi gjermanishten nuk e zotëroj mirë. Nuk takova askënd që të fliste anglisht. Kur më ndodhi një keqkuptim që solli një diskutim të ashpër e të ndërlikuar, çështja u përkthye në një mënyrë komike me përkthyes shumëpalësh — nga shqipja në rusisht, nga rusishtja në gjermanisht dhe nga gjermanishtja në frëngjisht.

Ky “stil përkthimi”, si të thuash, ia vlen të rrëfehet, sepse ndryshoi krejt karakterin e një udhëtimi që ishte që në fillim disi i paformë. E vura re që autoritetet shqiptare (me fjalë të tjera, kushdo me të cilin binim në kontakt) ishin tronditur nga natyra haptazi profesionale e grupit tonë turistik, ndonëse m'u duk se qenë sjellë për çudi mjaft qytetarisht. Të nesërmen pas mbërritjes sonë, dërgova një telegram të shkurtër në gazetën londineze me të cilën bashkëpunova. E nisa në mënyrën e zakonshme, përmes recepsionit të hotelit, dhe ndërsa qëllimi kryesor ishte t'u jepja adresën time, mendova se nuk do të bëja asnjë mëkat po të shprehja në të edhe disa fjalë që Republika Popullore nuk do t'i kundërshtonte. Në fund të fundit, kishte njëfarë rëndësie lajmi për ardhjen e të huajve perëndimorë në Shqipëri, dhe këtë kisha si qëllim. “Kjo republikë e vogël, krenare dhe e vetmuar, që ka sfiduar me guxim si lindjen ashtu edhe perëndimin,” shkruajta unë, “ka hapur portat e saj,” e më tej, etj., etj. I vetmi dyshim që kisha për mënyrën e shprehjes, ishte se mua më dukej shumë vlerësuese, pothuaj deri në teprim; dhe kjo gjë mund të ngjallte të qeshura nga ndonjë censor shqiptar me shije.

Nuk e kisha parashikuar reagimin e jashtëzakonshëm që do të pasonte ky telegram. Pas pak, u gjenda përballë një grupi funksionarësh të ftohtë dhe të zymtë në fytyrë, të cilët dukeshin qartësisht armiqësorë. Pas shumë përplasjeve shumëgjuhëshe të stisura, më bënë të kuptoj se telegrami im ishte konsideruar i pakëndshëm, armiqësor, përcusues, me tone fashiste dhe si shkelje e pa telorueshme e statusit tim si turist.

Fillimisht unë mendova se duhej të ishte ndonjë keqkuptim i vogël. Për çfarë, saktësisht, kundërshtonin? “Për termat me të cilët përshkruaja Republikën e Shqipërisë, natyrisht, mbiemrat fytes,” më thanë. Por unë kundërshtova dhe i habitur u thashë se fjalët që përdora, si “guximtare”, “e vogël”, “krenare”, “e izoluar”... nuk janë aspak armiqësore. “Ja pra!” – thirrën ata – “E izoluar! Kush tjetër veç një person që është vegël e Perëndimit do të përdorte një fjalë kaq të hidhur, kaq të pasaktë!” Tani ndihesha sikur isha futur thellë në botën e Alicës në Vendin e Çudirave, dhe u përpoqa të shpjegoja se “e izoluar” nuk është një term përgjues. Pse, ju thashë unë, – jo shumë vite më parë, gjatë ditëve të para të luftës, ne në Britani krenohemi që ishim të izoluar. “E saktë,” kllithën ata, “dhe ashtu ishit, ndoshta ashtu jeni ende, por Shqipëria nuk është! Kjo fjalë është një shpifje një poshtërsi e neveritshme.”

Biseda po kalonte tashmë në kufijtë e absurditetit. “Mirë,” u thashë me nervozizëm, “atëherë unë po e kuptoj që telegrami im nuk është dërguar.” “Jo aspak,” u përgjigj komandanti i tyre; “e vetmja gjë që ndodhi ishte se punonjësit e postës, të tronditur nga përmbajtja armiqësore e telegramit, refuzuan ta transmetonin.

Do ishte më mirë të mos më kapnin fare duke dërguar telegrame, qofshin të mirë apo të këqij. Por, pasi kjo ndodhi ata e kishin menduar gjatë këtë punë, dhe kishin vendosur një vizë daljeje në pasaportën time – dhe më thane se s'kishin ndërmend të më pengonin të largohesha sa më shpejt që të deshiroja.”

Në këtë pikë, megjithatë, doli në pah një pengesë e pakëndshme dhe mjaft e sikletshme për ta. Është mirë të bësh gjestin e madh – të hapësh derën dhe ti thuash vetes “ik!” – por gjithë kjo drama e humb ritmin kur s'ke askund ku të shkosh e si të shkosh. Kjo pasi Tirana nuk është aspak nje trafikku në Evropën Lindore. Aeroporti dërgon rreth dy avionë çdo pesëmbëdhjetë ditë. Rrugët kufitare ishin të mbyllura dhe hekurudha nuk funksionon me jashtë. Përveçse të më hidhnin në fund të ndonjë moli, nuk kishte mënyrë tjetër praktike për të shpëtuar prej meje për të paktën edhe dhjetë ditë të tjera. Zyrtarët e kuptuan këtë pak me vonesë, dhe u larguan – pas një shtrëngimi duarsh të ftohtë e formal – për të rishqyrtuar situatën.

Kështu mbeta vetëm dhe i mbyllur brenda edhe për një ditë, ndërsa zyrtarët e Republikës Popullore mendonin hapin e radhës. Pozita ime, në të vërtetë, nuk ishte aspak emergjente. Unë u bera kërkesë, që grupi ynë turistik të mund të vizitonte Universitetin e Tiranës, dhe kjo për çudi u pranua me shumë gatishmëri. Universiteti ishte, në fakt, godina më mbresëlënëse e qytetit dhe përshkruhej me njëfarë krenarie si monument i Demokracisë së Re Popullore. Në të vërtetë, si shumica e ndërtesave madhore të Tiranës, ishte monument i së kundërtës: ishte ndërtuar rreth njëzet vjet më parë nga Musolini si Casa Fascista e trupave pushtuese. Megjithatë, ishte një ndërtesë e hijshme, dhe studentët, të rinj të pashëm dhe energjik. Ata i afroreshin grupit tonë me një kureshtje të frenuar; për mua ishte si të isha sërish në Moskë, pesëmbëdhjetë vjet më parë. Vërtet, shumëçka në Shqipëri më kujtonte Rusinë e pasluftës, përpara se “fryma e Gjenezës” të hapte aq shumë shtige lirie e të

kthente sinqeritetin e kontrolluar në virtyt qytetar. Ishte si Kina shtatë vjet më parë, kur kisha parë në shkollat dhe universitetet e saj mijëra të rinj të etur nga dëshira e pa përmbajtur për t'u shprehur, por krejt të pamundur për t'u shprehur dhe pa zotësi në teknikën e komunikimit.

Problemi kryesor në këto rrethana — përveç gjuhës, dhe pranisë së përhershme të përkthyesve — ishte se të vetmet pyetje që më vinin në mendje ishin ato të vështirat. Në një lloj gjuhe të përzjerë franko-gjermane fillova, me vështirësi t'i pyesja.

Pse keni kaq shumë urrejtje e neveri ndaj qeverisë sovjetike? Ishte një pyetje e ndërlikuar kjo që u bëra, por, sido që të ishte, sipas tyre dukej se Hrushovi u kishte premtuar diku grekëve të mbështeste pretendimin e tyre për Epirin e Veriut, që për ta ishte Shqipëria e Jugut. Ai kishte rënë në ujdë mashtruese për të përkrahur Titon, dhe të gjithë e dinin mirë se çfarë ishte Tito. Kur Hrushovi kishte vizituar Shqipërinë në vitin 1959, ishte sjellë me një arrogancë ekstreme dhe e kishte quajtur vendin një “kopsht tregu perimesh”. Zoti Hrushov, thoshin ata, kishte tradhtuar frymën bazë të marksizëm-leninizmit duke përbuzur të drejtën kombëtare të Shqipërisë së lirë për t'u bërë një fuqi e vërtetë. Përtej kësaj, askush nuk ishte në gjendje të shkonte.

Pyetjes se a ndjeheshin të vetmuar në botë — ata iu përgjigjen: – Jo aspak, pasi ne jemi të lidhur pazgjidhshmërisht me kombin më të madh në botë, kinëzët

Por, pyeta unë sërish, kinëzët janë një popull i madh dhe i fuqishëm, por a nuk janë tepër larg? Jo, nuk janë larg-përgjigjeshin ata.

Mesa duket në dallimet më të mëdha dhe më të ndërlikuara mes Moskës dhe Pekinit Shqipëria po përdorej si kukull? Jo, nuk është e vërtetë thonin ata. Ndofta është e paevitueshme që, herët a vonë, ky komb i vogël e i pathyeshëm do të duhej të binte në marrëveshje me dikë, qoftë vetëm për të mbijetuar? Jo, nuk është e vërtetë, përgjigjeshin ata. Më pas debati vazhdoi pa ndonjë shkëmbim të ndërsjellë mendimesh dhe u fashit shpejt.

Të nesërmen na futën të gjithëve në një autobus, na çuan poshtë drejt portit të Durrësit dhe na lanë atje. Unë nuk do ta shihja më Tiranën.

DURRËSI, Durazzo-ja e kohëve italiane, është një nga vendet vërtet më të lashta të Europës. Ishte Epidamnusi i grekëve, Dyrrahiumi i romakëve. Kishte qenë kryeqyteti i dinastisë ilire të Taulantëve; e pikërisht nga këtu romakët nisën kolonizimin e Europës Lindore, porta hyrëse e Ballkanit. Thuajse çdo dorë e huaj e kishte pushtuar, zhvilluar, plaçkitur e më pas braktisur Durrësin — bullgarët, serbët, ostrogotët, spanjollët, venedikasit, turqit, italianët. Tani dukej sikur askush s'kishte dashur ndonjëherë të merrej me të.

Unë pashë pak nga Durrësi. Për një orë a dy, ndalua rrugës, pimë një uzo në një kafene buzë rruge dhe shkuam të shikonim muret e mbuluara me bimësi të fortesës bizantine të vjetër. Një varg i gjatë vogëluesh ecte rrugës për në shkollë, të gjitha të veshur njësoj me përparëse rozë, secila duke mbajtur fundin e asaj përpara. Dyqanet ishin tepër të zymta, ofronin për shitje pothuajse vetëm broshura leniniste dhe ëmbëlsira të vjetra e të mbuluara me pluhur. Thuajse gjithë ushqimi shitej në MAPO, ekuivalenti shqiptar i zinxhirit rus “Gastronom”; përbëhej kryesisht nga fruta dhe peshk në kuti.

Vetëm dy gjëra ishin befasuese. Teksa shoqëruesi na thërriste të hipnim sërish në autobus, dëgjova një si vajtim të lehtë ajror, një melodi si ajo e një muezini — dhe, kur ngrita sytë, pashë se ishte vërtet një muezin; lart, në minaren e xhamisë së madhe të Durrësit, ai thërriste besimtarët në lutje në shtatë emrat e Zotit. Ishte e qartë se këtu, të paktën, si në republikat myslimane sovjetike, komunizmi kishte arritur një marrëveshje me islamin. (Më vonë zbulova se si në Durrës, ashtu edhe në Tiranë, kishat ortodokse dhe ato katolike ishin të hapura dhe mbanin një numër të ndershëm besimtarësh, dhe se priftërinjtë e tyre toleroheshin, edhe pse nuk inkurajoheshin.)

Tronditja tjetër e momentit ishte kur hodha vështrimin mbi një vitrinë të errët dhe të zymtë dhe pashë rastësisht, mes kartolinave të Hoxhës, Leninit, Stalinit dhe gjithë pjesës tjetër të panteonit lindor, fytyrën e njohur dhe flokët e shpupuritur të asaj që, pa nevojë, ishte etiketuar “Brixhid Bardë”.

Rreth pesë milje jashtë Durrësit ndodhej hoteli i ri bregdetar i quajtur “Adriatik”. Ishte njëri nga disa hotelet aty rreth që shikonin nga deti, dhe ishin në kushte të ndryshme disa gjysmë të përfunduara. Dukej qartazi se ishin ndërtuar nga rusët për përdorimin e tyre si vend pushimi, dhe kur kishte ndodhur përçarja, rusët i kishin braktisur, ashtu si kishin bërë me ambasadën. Vetëm “Adriatiku” ishte funksional, dhe nga treqind dhomat e tij, të vetmet dhoma me bujtës ishin dhomat tona.

Ishte ndërtuar në atë që mund të quhej stili sovjetik i Detit të Zi — pra, me një shtrirje dhe madhësi që do të kishin qenë të justifikueshme vetëm nëse do ishin mbushur me materiale luksoze. Por ishte ngritur me ngut dhe me pak mjete: në vend të drurëve të mirë dhe mermerit të pasur, kishte dërrasa tallzhi dhe cemento të ashpër; në sallën e gjerë, bimët të përhershme rriteshin nga fuçi vaji të lyer jeshile. Në dhomën time, divani ishte vendosur në mënyrë të tillë që, për të shkuar në shtrat, duhej të çoje dollapin mënjane, dhe për të hapur dollapin, duhej të zhvendosje shtratin. Ndjesia e përgjithshme ishte irrituese.

Poshtë tarracës së hotelit shtrihet plazhi që më vonë do ta njihja mirë. Sipas çdo standardi, plazhi i Durrësit ishte mahnitës, duke zgjeruar krahët e tij në veri e në jug përgjatë

Adriatikut të qetë. Ishte një lloji i plazhit që do ta shihje në një broshurë pushimesh me ngjyra, plot me çadra shumëngjyrëshe, me vajza zbatimëse në veshje të lehta, dhe kamarierë që sillnin gëzueshëm tabaka me pije fluskuuese. Por sot plazhi ishte i shkretë, një shtrirje rëre aq e pabanuar sa rrallë e kisha parë atje larg brigjeve të largëta të Afrikës Perëndimore. Pa çadra, pa vajza me rroba banje mbi karriget metalike të mbinxehura të tarracës. I vetmi kamarier e kalonte pjesën më të madhe të kohës nën hije, duke dalë vetëm pasi dërgonin ndonjë përfaqësues ta zgjonte nga përhumbjet e tij. Për milje e milje nuk dukej askush tjetër përveç një grushti turistësh të mërziur dhe ndonjë polici të rastit që ecte ngadalë përgjatë rërës, i djersitur dhe i mërziur nën uniformën e rëndë prej stofi të trashë.

Vetëm për ndonjë njeri pa ndonjë ambicie më të madhe se marrja e një nxirrije diellore dhe të një relaksimi truri nga deti, plazhi i Durrësit nuk mund të kishte asgjë për t'u ankuar. Por për këdo që kërkonte qoftë edhe diçka më shumë nga përvoja shqiptare, ishte tepër i mërziutshëm. Në të dy anët e hotelit tonë shtriheshin ndërtesat e tjera — hotele më të vogla, vila, shtëpi pushimi, baza verore për sindikatat dhe institucionet shtetërore — dhe të gjitha ishin krejt bosh. Të reja siç ishin — disa madje të sapo ngritura, me dritare pa xhama e mure të suvatuara — sërish kishin marrë një pamje trishtimi e braktisjeje. Ne të shtatëmbëdhjetë e hotel “Adriatiku” zhurmonim dhe përplaseshim nëpër zbrazëtirën e saj si bizele të thata në një kanaçe. Çdo ditë kamarierët, me një lloj filozofie të nënshtruar, shtronin tryezat e restorantit të mëdha për treqind persona; çdo ditë u shërbenin të njëjtëve, vetëm neve, shtatëmbëdhjetë klientëve.

Ushqimi ishte i varfër dhe i papërshtueshëm për keq për nga shija. Unë nuk jam gastronom, por kam ngrënë për vite të tëra në rrethana të pafavorshme e në kuzhina vërtet të këqija, aq sa e konsideroj veten një farë njohësi të ushqimit të keq, ashtu si dhe të ushqimit të mirë. Por këtu në Durrës ushqimi ishte diçka që i kapërcente të gjitha kujtimet e mia. Është e vështirë ta përshkruash, përveçse ta quash ushqim ballkanik i skaduar: makarona që dukeshin sikur ishin gatuar shumë ditë më parë e më pas shtypur disi; copa të paqarta mishi të vjetër që kishin parë vetëm pak nxehtësi; domate bosh të mbushura me një lloj pluhuri bimor. U habita që nuk kishte fare peshk, deri sa më ra ndër mend arsyeja: nuk kishte peshkatarë.

Nuk kishte peshkatarë sepse nuk kishte anije. Me Italinë vetëm pesëdhjetë milje përtej Adriatikut, kush do ta linte ndonjë peshkatar të pashkonte disa milje larg bregut të detit, kur dihej se ai s'do të kthehej më?

Pra, gjatë qëndrimit tim në Durrës, ushqimi që unë haja përbëhej pothuajse vetëm nga bukë, e cila ishte mjaft e mirë; kajsi, që ishin të mrekullueshme; dhe konjak, që ishte më i mirë se asgjë. Një zhgënjim i madh më bëri nervoz gjithë javën: për herë të parë në gjithë botën m'u shërbye një verë krejtësisht e papijshme — dhe këtë e them unë që normalisht mund të pi gjithçka.

Gjatë gjithë “veprimtarive” tona, nëse mund t'i quajmë veprimtari, ishim gjithmonë nën vëzhgimin dhe ndjenjën e pranisë së një numri të konsiderueshëm personash, që në këto shtete quhen në mënyrë të pasaktë “polici sekretë”. Ata rrinin në qoshe, në çifte në skajet e bareve, ose bredhnin rreth hollit me një mënyrë gati demonstrativisht të fshehtë. Ishin gjithmonë të grumbulluar në ato pjesë të ftohta e të parradura të hollit të hotelit ku asnjë mysafir normal s'do të ndalej. Kur ndodhte rrallë që të kryqëzoje shimimet me to, ata ulnin sytë menjëherë drejt tavolinës. Ishin, pa asnjë dyshim, policët sekretë më të dukshëm që kam parë ndonjëherë në një përvojë mjaft të gjatë me mjeshtërinë e tyre. Veshja e tyre përbëhej nga këmisha dhe rroba pak më të mira se ato të njerëzve të tjerë, dhe rruanin fytyrën pak më mirë se mesatarja. Por të gjithë kishin një gjë të përbashkët — këpuccë lëkure, ndoshta të prodhuara nga shteti, që lëshonin në çdo hap një zhurmë të ashpër e kërcitëse.

Këta individë njiheshin me disa emra: “Sigurimi”, ose ndonjëherë “fantazmat”. Shoqëritë e këtij lloji gjithmonë shpikin një eufemizëm për spiunët e tyre; për arsye të çuditshme, në Shqipëri i quanin “Historianë”. Emër jo pa vend që përmbledhte respektin, përbuzjen dhe një lloj saktësie të lirshme.

Këta “Historianë” rrallëherë dilnin në dritën verbuese të detit, duke preferuar të rrinin brenda në heshtjen e tyre të mbuluar me mister. Kështu që unë pjesën më të madhe të kohës e kaloja në det ose në plazh. Nga njëra anë kishte një mol të vogël; nga ana tjetër, pas disa qindra metrave, fillonin ushtarët. Ata rrinin të mbështetur në një bunker betoni, me automatikë në dorë dhe pasi përtyreshin nxirrnin nga goja bërthamat e qershive. Përtej atij vendi nuk mund të kaloje, “sepse,” më thanë, “ende nuk i kemi pastruar minat që nga lufta.” Arsy e çuditshme, mendova. Pas muzgut, një brezare dritash ndriçonte shkëmbinjtë përtej detit. Diku në atë breg ndodheshin dikur bazat nënujore që kishte ndërtuar Flota Sovjetike. Rusët ishin larguar muaj më parë, por, sipas legjendës, shqiptarët kishin arritur të mbanin dy nëndetëse për vete. Por ato ishin shumë më në jug, dhe unë, tashmë i vënë nën “vëzhgim”, nuk kisha dëshirë të rrezikojta më shumë fatin tim me pyetje shtesë.

Përballë hotelit, në ujërat para portit të Durrësit, ndonjë anije futej ose dilte herë pas here. Njëra nuk lëvizte kurrë, sepse ishte përgjysmë e fundosur dhe qëndronte e anuar mbi rërën e detit. Pak kohë para mbërritjes sonë, kishte ndodhur e pashmangshmja: një nga ato anije të rralla që vinin në portin pothuaj të braktisur, për ndonjë rastësi të pabesueshme, ishte

përplasur me një tjetër. Mbeturinat e saj qëndronin aty gjatë gjithë kohës që isha në Durrës; pa dyshim, ndoshta ndodhen ende aty.

Megjithatë, Durrësi ishte lidhja me botën. Vitin e kaluar, shqiptarët ia kishin dalë të importonin një ngarkesë gruri: blerë nga kinezët në Kanada, paguar me rubla, transportuar përmes Atlantikut në anije të Gjermanisë Perëndimore. Një hallkë e ndërlikuar dhe e brishtë me botën e jashtme.

Tani po ndjeja mungesën e madhe që më mundonte që prej ardhjes në Tiranë: nuk kisha asgjë për të lexuar. Nuk ishte faj menaxhimi — doganierët më kishin konfiskuar librat. Në hotel nuk kishte asgjë për të lexuar, as në ndonjë gjuhë tjetër; sikur arti i të shkruarit të mos ekzistonte fare; sikur Gutenberg të kishte jetuar kot. Mund të kisha kaluar ndonjë orë duke u përpjekur të nxirrja ndonjë fjalë nga gazeta vendase, Zëri i Popullit, por, sado absurde të dukej, nuk më lejua as ta kem në dorë. Madje, kur i kërkova përkthyesit tonë të më shpjegonte ndonjë titull, më tha se as kjo nuk ishte e mundur. Nuk ishte e besueshme që të kishte frikë se ndonjë sekret bibliik ishte fshehur në faqet e një gazete aq të censuruar sa Zëri i Popullit; ndaj mendoj se ishte pjesë e dënimit tim për “fjalën e papërshtatshme”. Nëse ishte kështu, ndëshkimi që i efektshëm — fillova të haja thonjtë nga mungesa e leximit. Çfarë nuk do të jepja për ndonjë kopje të Tristram Shandy!

Prandaj, u lehtësova pa masë kur autoritetet na njoftuan papritur se mund të shkonim në një “ekspeditë.” Do të na çonin në Krujë — një qytet malor me rëndësi të madhe historike, rreth njëzet milje larg, në malet e Shqipërisë qendrore. Duhej të qëndronim të gjithë bashkë, thanë ata, dhe të mos bredhnim më vete, dhe nëse gjithçka shkonte mirë, do të ktheheshim në mbremje. Pas ditëve të gjata të izolimit në plazhin e Durrësit, udhëtimi për në Krujë më dukej si një çlirim i vërtetë.

Të gjithë ishim ngjeshur në një autobus shumë të vjetër Ikarus, i cili dukej disi më pak i rrënuar se zakonisht (vura re se kishte dy goma të reja, një Barum nga Çekosllovakia dhe një New China), por sidoqoftë, jam i sigurt se nuk do ta kalonte asnjë provë të botës perëndimore. Vura re me njëfarë ankthi se rrotullimi i timonit ishte aq i madh, sa që shoferi dukej sikur po drejtonte një anije oqeanike, duke e rrotulluar timonin në çdo kthesë.

Për herë të parë munda të shihja se rruga e fshatit pas hotelit ishte zburuar çdo njëqind metra me parulla, që shpallnin bekime për fitoret e socializmit. Fjala shqipe për “roftë” është “Rroftë,” dhe dukej vërtet onomatopeike me ato dy r të arta mbi pëllhurën e kuqe. Parullat lexonin: “Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!” (të rrojë mirë partia, s’kish tjetër), “Rroftë Marksizëm-Leninizmi!”, dhe “Rroftë Shoku Enver Hoxha!”

(Një veçori tjetër e çuditshme e gjuhës shqipe ishte kjo fjalë shoku, që tingëllonte si “shocker” në shqiptime të huaja, duke i dhënë një ton shumë imagjinar çdo përsëritjeje: “Mirëmengjes, Shocker!” ose “Në fjalët e udhëheqësit tonë të madh, Shocker Hoxha...”)

Udhëtimi drejt Krujës ishte ndër përvojat më elektrizuese që kisha pasur prej kohësh. Rruga e ngushtë, e ashpër, aty këtu me gurë, ngjitej me kthesa të forta me një peizazhi mahnitës, bukurinë e të cilit s’mund ta shijonte askush, sepse sytë e të gjithëve ishin ngulur me ankth në humnerat e frikshme rreth të cilave rrapëlleshim. Diçka nga frika jonë duhet t’i ishte përcjellë edhe shoferit, i cili ishte një malësor me sy të egër, por plot hare e vetëbesim. Teksa e rrotullonte me forcë autobusin që kërciste në çdo kthesë, ai këndonte: “Hup-la! Hup-la!”, dhe në çastet më të rrezikshme e të tmerrshme kthehej nga pasagjerët me një buzëqeshje djallëzore sigurimi. U çlirova me të vërtetë, kur përshkuam tarracat e fundit me ullinj e sallgama dhe ndalëm me një fërshëllim frenash në sheshin kryesor të Krujës.


Kruja ishte me të vërtetë mahnitëse — një qytet i vogël e i çuditshëm, që varej sikur të ishte një kokë me vetulla mbi shpatet e një mali madhështor; me çati të kuqe e mure të bardha, me trëndafila dhe kanale të hapura, me rrugë të mbushura me kalldrëme gjigande ku karrot s’guxonin të hynin, dhe në majë, rrënojat e një kalaje madhështore të shekullit XV. Kruja zë një vend të veçantë në kujtesën historike të shqiptarëve, sepse për shumë vite ishte shtëpia, fortësia dhe selia e heroit të tyre të pa-krahasueshëm kombëtar, Skënderbeut.

I madhi Skënderbe e kishte bërë këtë fortesë qendër të qëndrësës shqiptare kundër osmanëve në vitet 1450. Ai kishte qenë një nga gjeneralët më të zotë të sulltanit, derisa papritur iu bashkua popullit të vet kundër ish-udhëheqësit të tij. Për tridhjetë e pesë vjet me radhë, kjo “fole shqiptonje”, siç quhej Kruja, i qëndroi rezistencës turke, duke përballuar katër rrethime me nga 120 mijë ushtarë të sulltanit. Në fund, ajo u mund vetëm nga uria dhe pas vdekjes së Skënderbeut.

Edhe pesë shekuj më vonë, vendi dukej i pathyeshëm. Nga çdo cep i qytetit, pamja shtrihej përtej maleve të egra – kreshta si sharra, lugje si plagë.

Na u dha një orë për t’u çlodhur. Vapë përvëluese, dhe mungesë e plotë për çdo lloj “gabimi”. Historianët e grupit u mblodhën në hijen e një peme e pinë duhan me qetësi. Unë shëtitja në rrugën kryesore të pjerrët dhe çuditësia me numrin e madh të berberëve, gjithnjë plot: mos vallë këta pasardhës të Skënderbeut nuk bënin asgjë tjetër veçse qetheshin?

Pas pak, arrita në një vend që ngjante me një kafene. Në hyrje, me shkronja të mëdha, ishte shkruar: “Klub.” Duke menduar se kushtet e anëtarësimit nuk mund të ishin të rënda, hyra brenda dhe i kërkova kamarieres simpatike një uzo – jo se kisha ndonjë pasion të veçantë për uzon shqiptare (e cila,



ndryshe nga ajo greke, kur përzihet me ujë merr një nuancë të frikshme të gjelbër), por sepse ishte gjëja më pak e paqartë për t’u porositur, dhe sepse kushtonte vetëm tetë lekë – afërsisht pesë centë.

Klubi ishte plot me burra të heshtur me mustaqe, edhe ata po pinin uzo, të shpërndarë në grupe me poza të fytyrave të ngrira të krijonin përshtypjen se çdo çast mund të ngriheshin për të kënduar ndonjë këngë apo ndonjë operë. Dhe më pas dodhi ajo që tashmë e dije: çdo sy në atë klub u kthye vetëtimthi dhe me një vështrim të gjatë e shbirues nga unë; pastaj u kthyen mbrapsht dhe nuk më shikuan më.

Ishte e habitshme, që në këtë vend ku thuhej se puna vlerësohej mbi gjithçka, qytetarët kishin kaq shumë kohë të lirë për të qëndruar në klub gjithë ditën. Çdo kafene e vogël, pothuajse në çdo orë të ditës, kishte gjysmë duzine punëtorë me pantallona të gjera, që flinin përmbi një gotë të vogël rakije. Tek i shihja pyes veten: a kanë punë këto qytetarë – apo ndoshta puna në shoqërinë shqiptare ishte aq e lehtë sa që linte hapësira për pushim të pakufizuar? Apo mos ndoshta, fillova të mendoj më pas, se një pjesë e çdo grupi, në secilin klub, ishin Historianët?

Në atë çast, pashë se më kishin mbaruar shkrepëset, dhe i bëra me shenjë fqinjët në tavolinën ngjitur që të më ndizte cigaren. Ai nxori një kuti shkrepësesh, të cilën, me një buzëqeshje miqësore, më tha ta mbaja. Ishte një dhuratë zbatimëse. Deri atëherë kisha parë vetëm një lloj shkrepësesh, një markë “Jumbo” e prodhuar në Poloni, por etiketa e së cilës shpallte në mënyrë të mistershme se shpërndahej nga një firmë indiane në të gjitha vendet e botës, Mauritius. Kjo më ishte dukur mjaft e çuditshme, por lloji i ri i shkrepësesh që më dha fqinji ishte edhe më i habitshëm: quhej (po ashtu në anglisht) “Channel Island Match,” dhe etiketa mbante një hartë të qartë të Jersey dhe Guernsey – burimet më të pamundura të shkrepësëve në botë.

Teksa e sodisja këtë kuti shkrepse, një polic me uniformë hyri në Klub; çizmet e tij prej lëkure kërcisnin si dyer të ndryshkura. U ul në një tavolinë. Menjëherë, në një mënyrë të çuditshme ra një heshje e plotë dhe e thellë. Pa ndonjë lëvizje të dukshme, ndjehej se diçka kishte ndryshuar – një lloj mpirjeje kishte rënë mbi gjithë të pranishmit. Dhe, nga ai moment u bë menjëherë e qartë se cilët nga të pranishmit në Klub ishin Historianët dhe cilët jo.

Polic i nuk porositi asgjë, dhe pas pak u largua. Brenda disa minutash dëgjova autobusin në shesh që bënte borinë për kthimin tonë.

U KTHYEM në plazhin e Durrësit, dhe jeta rifilloi normalisht, me një dallim të vetëm: atë të shtunë kishim vizitorë. Shqipëria, mesa dukej, kishte gjithashtu një fundjavë me më shumë vizitorë në bergdet, dhe për një orë a dy, holl i zbrazët u mbush me një frymë të lehtë feste të kontrolluar. Lart e poshtë bregut të detit, grupe të vogla shqiptarësh që e kishin ditë pushimi pinin në diell, ushqenin fëmijët, lanin me topa gome. Në tarracën tonë ekskluzive të hotelit u shfaqën VIP-at – një grup çekësh të nxirë nga dielli, nxorën një shportë me ushqim dhe porositën një radhë limonatësh. Pastaj mbërriti një grup prej dymbëdhjetë kinezësh që u vendosën në skajin tjetër të tarracës, në një rreth të ngushtë, të cilin personeli i hotelit e izoloi edhe më shumë duke hequr karriget në mes. Dhe, më në fund, pa ndonjë përshëndetje të bujshme, një burrë i qetë dhe i sjellshëm i veshur me rroba banje tha me një buzëqeshje: “J’ai le plaisir de vous dire bonjour.” (Është kënaqësi për mua të ju përshëndes.)

Në Republikën Popullore të Shqipërisë sot kanë mbetur vetëm tre përfaqësi perëndimore: ajo franceze, italiane dhe turke. Janë mbetje diplomatike, si Robinsonët e diplomacisë. Selitë e tyre – tri vila të vogla në Tiranë – janë të ngushta, lëvizjet

e tyre të kufizuara, dhe problemet e tyre janë të mjaft të mëdha. Njëri prej tyre ishte vizitori ynë në plazhin e Durrësit. Kishte dëgjuar për praninë tonë dhe, me një mirësjellje të përsosur e prekëse, për të cilën shpresoj që një ditë të shpërblehet me postin më të lartë të mundshëm, kishte sjellë me vete një shishe viski diplomatik.

Para se të largohej, ai diplomat i vetmuar psherëtiu lehtë dhe tha: “Jeta mund të ishte më keq për ne të tre, por do të ishte e pavërtetë të fshihnim se është mjaft e mërzitshme. Në të vërtetë, vdekjeprurëse. Nuk ka asnjë mundësi njohjeje amerikane. Njeriu pyeste, kot së koti, nëse britanikët mund të bëjnë ndonjë ditë ndonjë kompromis. Nuk jam i pasionuar pas politikës. Por do të ishte e mrekullueshme të kishim, më në fund, një person të katërt për një lojë me letra.”

Të nesërmen, autoritetet zyrtare të shtetit erdhën me autmjetin e tyre për të më çuar mua në Tiranë. Më në fund kishte një avion – për në Bari, dhe pastaj për në Romë.

Bëmë një debat të fundit. Kjo pasi bileta ime e kthimit për në Amsterdam ishte tani e pavlefshme, dhe unë duhej të paguaja për një biletë të re me dollarë amerikanë – kështu më thanë ata me një ton të lartë e agresiv – “Dollarë,” – i pyeta unë, “sigurisht jo për ju?” “Kështu është rregulli,” u përgjigjën me padurim. “Pesëdhjetë dollarë dhe gjashtëdhjetë centë.”

Rastësisht qëllor që kisha dollarë me vete; madje kisha saktësisht aq sa kërkonin. Por ata hezituan: “Nuk na lejohet të marrim monedha metalike,” thanë. “E si mund të jap pesëdhjetë dollarë e gjashtëdhjetë centë pa përdorur monedha metalike?” pyeta unë. “Na jepni vetëm copën e parasë letër,” thanë. Pjesa ime e vetme e mbetur prej letre ishte një pesë dollarësh. “Do të më ktheni kusurin?” pyeta. “Sigurisht,” thanë. “Në çfarë?” “Në lekë,” më thanë, me një ton agresiv që po humbte durimin. “Pra, unë ju jap pesë dollarë, ju më ktheni katër dollarë e dyzet centë në lekë? Dhe çfarë bëj me ato lekë?” “Epo,” u përgjigjën sërish me nervozizëm, “ka dhe një vështirësi tjetër, nuk ju lejohet t’i nxirrni lekët jashtë vendit.” “Pra,” thashë unë, tashmë pa qetësi, “ju propozoni t’me konfiskoni kusurin dhe të më vidhni katër dollarë e gjysmë – çfarë marrëveshje është kjo?” “Kështu janë rregullat,” bërtitën – por autobusi tashmë po i binte borisë, Historianët po bënin me shenjë me ngut, ishim me vonesë. Më rrëmbyen pesëdhjetë dollarët dhe më dhanë me nervozizëm biletën time, por nuk lëvizën nga qëndrimi i tyre: nuk pranonin monedha. Shqipëria i detyrohet Britanisë së Madhe tre milion paund për ato nëndeteset e minuara; unë i detyrohem Shqipërisë gjashtëdhjetë centë.

Më dërguan përsëri përmes Durrësit, nga periferitë e Tiranës, pranë radhëve të ngadalta të njerëzve që nuk i kisha njohur kurrë, njerëz të cilët dukeshin dhe silleshin ashtu si etërit e tyre nën Musolinin, nën Zogun, nën sundimin e pafund të sulltanëve, mbretërve e dushmanëve që i kishin sunduar e shfrytëzuar; të gjitha pushtetet i kishin përmbysur, për të rënë në një tjetër. Ndoshta nuk kishin qenë kurrë njerëz të lirë, por dukeshin të tillë. Kishin shkallën më të lartë të lindjeve në të gjithë Evropën, dhe fëmijët e tyre dukeshin qartazi të dashur. Aty jetonin, ndoshta pa u marrë me kuriozitetet e ndarjeve dhe rrymave ndër-marxiste. Kur buzëqeshja, më buzëqeshnin edhe ata.

Kur mbërrita në aeroport, aeroplani ishte gati. Një Historian më mori mënjane me shpejtësi – i pari me të cilin flisja. Tha me një frëngjishtë të gjysmake: “Duhej t’ju kisha ofruar konjak. Më vjen keq për librat.”

Pjesë e aktivitetit të tij të shumëanshëm është edhe krijimtaria letrare. Kjo krijimtari, është e përmbledhur dhe botuar tashmë në 10 vëllime në Kosovë. Që në krye të një studimi të gjerë e mjaft vlerësues, bën përshtypje pohimi i studiuesit të mirënjohur Rexhep Qosja se kjo krijimtari nuk mund që të prezantohet dot asnjëherë e plotë dhe kjo, pasi aty ka jo pak pjesë të munguara, të cinguara, të ndaluara, të konfiskuara, pse jo, të mallkuara, nga çensura shoviniste - nëpër vite të ndryshme.

Këto janë fate apo histori shqiptare, ku realiteti ka dëshmuar se në këtë hapësirë nuk regjistrohen vetëm troje e njerëz të cinguar, apo të humbur e të syrgjynosur - në stilin më të egër mesjetar, por edhe vepra letrare të ndjekura nga ky fat. Mu për këtë arsye, edhe fazat e krijimtarisë së këtij autori, nuk përcaktohen dhe klasifikohen lehtëazi aq nëpër kufij estetikë e kulturorë, sikundër ndodh në proceset letrare normale, por në faza burgimesh dhe ja se si: fillimisht krijimtaria e tij para dhe gjatë burgosjes së parë (kur nuk ishte veçse një djalosh 20 vjeçar në kulmin e rinisë). Si fazë e dytë, është krijimtaria nëpër vitet e burgosjeve të radhës - deri në lirim më 21 prill 1990, si dhe faza e tretë, ajo e pasburgimeve - deri sa ishte gjallë. Një kronologji e krijimtarisë letrare nëpër këtë model togfjalëshi, ku në çdo periudhë të klasifikuar shquan fjala "burg", është vërtet nga rastet unikale në historinë e letrave. Por ndërkaq, ajo kohë legjendë burgosjesh politike e shkrimtarit, për shkak se qytetari dhe intelektual Adem Demaçit e kishte sfiduar në paqe të plotë me veten heshtjen, apo ca më shumë konformizmin ndaj padrejtësisë, pra, ajo kohë, mbetet unitarisht kurora më e ndritur e veprës së tij, si vlerë modeli tempullar për të tjerët.

Koha e provoi vlerën e këtij modeli, sigurisht me koston e lartë të sakrificave ekstreme të njeriut, të individit, por ama me dobinë e madhe që pati populli, të cilit, i dolën zot martirë të tillë të lirisë, që atij populli të mos i zhbëhej dhe mos t'i shuhej kurrsesi kujtesa, qëndresa dhe rezistenca qytetare e nacionale, të cilat, sistematikisht, kishin qenë tejet të rrezikuara.

Vepra të tilla si kjo e Adem Demaçit, me pengesat dhe pjesët e munguara, nga ato që ia censuruan, ia asgjësuan nëpër kalvare hetimesh e gjyqesh, apo që mund t'i kishte realizuar, po të shkonte jeta e tij në rrjedha normale, u ngjajnë atyre skulpturave antike, të cilat, u flasin njerëzve me tërë elementet e tyre, madje edhe me ato të munguarat. Të shfaqura para publikut si të tilla, ato arrijnë të përcjellin në mënyrën më besnike atmosferën e kohës, me tërë pamjet e ndritshme dhe të errëta të saj, me pengesat dhe peripecitë.

Kësisoj, edhe kjo vepër e autorit, duhet vlerësuar si një "kalendar artistik i kohës" së tij dhe i kohës së popullit të tij, si dy skaje këto, që nuk ndahen dot, por që puqen e shkrihen mes tyre tërësisht. Në tërë përbërësit e saj zhanrorë e stilistikë, ajo rezulton të jetë pasqyruese, interpretuese dhe përcjellëse e qashtë mesazhore, e kësaj kohe. Mund të themi se kemi të bëjmë me një nga ata krijues, të cilët, po bëhen gjithnjë e më të rrallë në racën e shkrimtarëve, në veprën e të cilëve, qendrojnë pranë: shkrimtari i strukturave artistike dhe po aq, misionari i ideologjive dhe i aksioneve sociale. Për një shkrimtar si Adem Demaçi, ky do të ishte një lloj kushtëzimi dhe haraçi, por i paramenduar dhe i llogaritur me sa duket fort mirë prej tij, që kishte të bënte me vendosmërinë dhe paktin e bërë (që në krye të herës), për të mos i ikur apo bishtnuar kurrsesi, në çdo rrethanë, sado të vështirë, as zërit të kohës dhe as zërit të vetes.

Duke lexuar këtë vepër, ku përfshihen krijime në prozë të shkurtër dhe romane, poezi dhe dramë e publicistikë, kupton se autori i saj ka pasur një pasion dhe

90-vjetori i lindjes

ADEM DEMAÇI I LETËRSISË

Nga Ymer Çiraku

Adem Demaçi (1936-2018) mbetet mjaft i njohur si një veprimtar i shquar i çështjes kombëtare në Kosovë. Ai kaloi një kalvar burgosjesh gati 30 vjeçare në ish Jugosllavi, akuzuar si disident i rrezikshëm. Për qëndresën e tij legjendë si "Mandela i Europës", është vlerësuar me çmimin "Saharov" në Strasburg. Aktiviteti i tij vazhdoi edhe si përfaqësuesi politik i UÇK-së. Gjithkush pas viteve '90-të, ka patur rastin që të njihet përmes medias me aktivitetin e tij të palodhur patriotik e intelektual, sa në Kosovë e sa në Shqipëri. Kam patur privilegjin që ta njoh nga afër në një nga takimet në Tetovë, ku organizohej Festivali i njohur Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit". Këtu ai ishte i ftuar nderi dhe i pranishëm në tryezat e takimeve për diskutime. Kujtoj se në tërë qënien e tij, ndihej sikur ishte derdhur statura e një misionari, prej të cilit, buronte një ligjërimit tejet i natyrshëm dhe njëherazi tejet zotërues.

energji të madhe krijuese, për ta zotëruar gjithësisht letërsinë, duke e synuar të shprehurit artistik, pothuaj në tërë zhanret e saj. Pamvarësisht rrethanave të jetës, të cilat, jo vetëm nuk ia mundësuan, por dhe ia vështirësuan këtë mision artistik, kjo krijimtari e pandalur dëshmonte se ai kishte një talent të lindur dhe një vullnet të bekuar për ta mbajtur gjallë e për ta realizuar këtë talent. Ndërkaq, izolimet e gjata nga kontaktet me jetën sociale e kulturore, nuk arritën dot që t'ia shuanin apo t'ia atrofizonin shijet letrare. Brenda *kaushëve* të burgjeve, të kontrolluara sistematikisht, ai diji të krijojë lirinë e tij, ku edhe në ato rrethana ferri, letërsia e tij gëzonte mbase statusin më të pacënuar të kësaj lirie, çka e bënte autorin e saj të mos ndjente kurrfarë kufizimi - për të qënë në kontakt me vlerat dhe shijet e larta letrare, nga ato shqipe dhe ato botërore, të cilat, i ruante të depozituara në shpirtin dhe në fantazinë e tij.

Në veprën e Adem Demaçit ka jetë dhe ritëm, që s' mund të shihen të pashkëputura dot nga ritmi i biografisë së popullit dhe ritmi i jetës së tij. Kuptohet, se në ligjërimin letrar, pra, sipas principeve të kodeve

letrare, këto realitete historike e sociale shqiptare, përthihen në struktura narrative dhe dominanca specifike emocionale, por ku ato e ruajnë gjithësesi, karakterin dhe pushtetin e tyre identitar.

Le të kujtojmë një tregim si atë me titullin "Ezopi". Është konceptuar si një rrëfim në vetën e parë dhe brenda pak fletësh, portretizohen me doza humorit, me ngjyra groteske e deri burleske, një radhë personazhesh me emrin Hasan, të cilët, jetojnë sipas mënyrës së vet në një qytet provincial. Njëri shtatlartë, që femrat i sillen si mizat lugës së mjaltit, tjetri dajrexhi, që ia ka ënda të gënjejë shumë - por pa dëmtuar kënd, Hasani tjetër - pjesëmarrës në luftën antifashiste - por që as i bie një herë në mendje ta kujtojë atë për ndonjë përfitim. Pastaj Hasani tjetër, i shkurtër nga shtati, por që ecën i kacagjelur edhe në përcjelljen e ndonjë të vdekuri - sikur të ishte ndonjë gardist i vet Napoleonit. Për të vazhduar me Hasanin pëllumbaxhi - që më shumë rri pranë kotecit të pëllumbave se sa në shtrat me gruan. Dhe në fund, një Hasan tjetër, vet heroi i rrëfimit, me një defekt fizik: është gungaç. E kjo i faneps atij drojë



e ndjenjë inferioriteti mes shokësh e deri në familje, ku edhe dashuria e nënës, në raport me fëmijët e tjerë, i ngjante se më shumë i përcillej si mëshirë e kjo mëshirë nuk mund ta rriste dot, se ngjasonte si ajo drita e hënës ndaj lules së vyshkur. Por pikërisht tek ky Hasan i fundit, si në një dinasti mbretërore - apo si në shpalljet biblike, ka zbritur ylli për të shenjuar njeriun, që do të mbartë një mision të lartë. Me një kontrapunkt sugjestionues, pra, me një kapërcim artistik, ku dalin pamjet kontrastuese mes pamjes së jashtme dhe vlerave të brendshme shpirtërore, arrihet që të krijohet në këtë tregim, një emocion i thellë human dhe përcillet një mesazh i gjithkohshëm - për t'u orientuar në vlerësimin e njeriut nga shpirti dhe karakteri i tij dhe jo nga lulkat e dukjeve.

Sikundër vrehet, edhe brenda një teksti minimal si ky për nga vëllimi, kryqëzohen shumë fate njerëzore, ndihen alegoria dhe përthyerjet autobiografike, tonet përsiatëse dhe pasazhet përshkruese, ndihet sidomos ritmi i lartë i lëvizjes së lavjerrësit të kohës së ngjarjeve - që i jep këtij tregimi formatin e një skeleti romani.

Në tërësinë e vet, vepra e Adem Demaçit përcillet si zëri i kohës së popullit të tij. Këtu ai mori me vullnetin e tij pengun e përgjegjësive - për t'i mbajtur dhe dëshmuar ato me çdo çmim. Po këtu, mori edhe gëzimin, mbase më të madhin e jetës, për ato që pa të realizuara më pas. Dhe ky realitet i ri në botën shqiptare, i cili po vinte i mbarë (për koincidençë) me mijëvjeçarin e ri, që sapo hynte, do të ishte dhe një blatim i merituar për atë çka ai bëri për këtë vend, pa bërë paraprakisht llogaritë për "hipotekën" e tij personale.



Shumica e poetëve shqiptarë bashkëkohës Se shkrin zërin e vet në një kor të gjerë hermetik dhe pas - hermetik (ka edhe një pakicë poetësh që i qëndrojnë besnikë realizmit, një lloj realizmi modern).

Çuditërisht poetët shqiptarë e kanë realizuar më mirë veten në pesëdhjetëvjetorin e diktaturës, kur ishin në luftë të vazhdueshme me censurën dhe vetëcensurën dhe u duhej të mbroheshin përmes gjuhës së Ezopit. Lufta estetike dhe "e nëndheshme" me drejtimin zyrtar të realizmit socialist i bëri paradoksalisht më të fortë talentet e vërteta duke thyer pseudotalentet dhe talentet mediokër si era që shuan zjarret e vogla dhe u jep flakë zjarreve të mëdha (Përrjashtojmë figura të tilla si Camaj që e zhvilluan krijimtarinë e tyre jashtë atdheut).

Atmosfera e lirisë relative e tridhjetëvjetorit të fundit (në mes të dy shekujve) u ka dhënë jetë pak luleve të mirëfillta lirike me një ngjyrë dhe një aromë të vetën. Midis tyre përfshihet edhe Nuri Plaku, i cili dallohet për një veçanti të poezisë së vet që lëshon aromë deti dhe ullinjsh dhe ka një problematikë ekzistenciale dhe një vullë shqiptare.

Umberto Saba që ishte edhe vetë një poet hermetik tepër origjinal, thoshte: "Poetët, siç e dinë të gjithë, janë egocentrikë. Për ta bota e jashtme ekziston, veçse rrotullohet kryesisht rreth vetes së tyre".

Filozofët (metafizikë) kishin bërë një hap më shumë në rrugën e tyre: ishin "egokozmikë".

Në poezinë e Nuri Plakut ndërthuren egocentrizmi i un-it lirik dhe ego-kozmizmi i poetit filozof.

Një veçori e këtij poeti është shkurtësia e vjershave të tij që ngajnë si fryte të intuitës lirike të ekzaltuar nga Benedeto Kroçe¹. Kjo shkurtësi shpreh thellësi mendimi poetik të strukturuar me një konçizitet të lavdërueshëm.

Fjalët çelësa në poezinë e Plakut janë: udhë, zjarr, dru, dhe, fushë, ulli, kryq, këmbanë, kalë, flutur. Këto fjalë pikturojnë peizazhe të caktuara, po shprehin edhe një afsh vullkanik të fshehur nën një cipë akulli dhe një frymë mistike, ca tradicionale, ca kozmike.

Poeti shkruan në vargje të lira që shprehin dëshirën e tij për liri formale, po nganjëherë ndeshim në to ndonjë rimë, të çelur si lule vetmitare.

Një veçori grafike e këtyre poezive është përdorimi i fillimit të fjalëve me gërmë të vogël në titujt e tyre si për ta zbehur kështu në ndonjë farë mënyre shkëlqimin e formës ose si për të vënë, po të duam të shprehemi me fjalët e D'Anuncios² (dhe të ungjillit të Mateut) "pishtarin nën shinik".

Nuk është e qartë nëse kjo gjë bëhet nga modestia e poetit apo nga dëshira për të evidencuar më tepër përputhjen midis mesazhit dhe formës në poezinë e tij, kështu që po ia lemë lexuesit ta gjejë zgjidhjen e kësaj enigme.

Dihet se drejtimet e shumta letrare të shekullit të kaluar (si, bie fjala, futurizmi dhe surealizmi) e përdornin drejtshkrimin mjaft lirisht.

Nuri Plaku është një poet midis modernizmit dhe pasmodernizmit, hermetizmit dhe pas - hermetizmit, errësisë dhe qartësisë. Vargjet e poezive të tij, ndonëse, siç thamë, mund të karakterizohen si "të lira" janë të organizuara në strofa, distike, katërshë, me të rrallë strofa gjashtëshe.

Këto strofa kanë një veçori befasuese: lidhen midis tyre përmes fjalës së fundit të rimuar të vargut të fundit që luan rolin e fjalës çelës (bie fjala, varfëri - fëmijëri; shtrat të zjarrtë vetëtimash - vdekjes sime). Ky procedim i shërben muzikalitetit karakteristik që e dallon poezinë e Plakut, në dukje larg nga organizimi ritmik tradicional.

Në të vërtetë rima nuk është e huaj për vargun e lirë si dëshmon vepra e shumë poetëve që në dukje kanë flakur vargonjtë e traditës.

Ky fryt i vonshëm i evolucionit të poezisë

¹ Filozof dhe studiues letërsie i shquar italian.

² Poet, dramaturg dhe romancier dekadent i njohur italian. "Pishtari nën shinik" është titulli i një tragjedie të tij.

Rreth vëllimit me poezi të zgjedhura "Nata një kryq i bardhë dashurie."

Individualiteti krijues i një poeti filozof, Nuri Plakut

Prof. Dr. Klara Kodra

(rima në fakt u shfaq pas vargut të bardhë të përdorur në lashtësi) vazhdon ende të shijohet nga lexuesit, duke ia shtuar shijen vargut aktual, qoftë ai edhe i lirë.

Lirikat e Nuri Plakut dallohen për një mbyllje shpërthyesë që transmeton thelbin e mesazhit të autorit, një mesazh njerëzor dhe plot vlera. Sepse poeti në këtë atmosferë krize të vlerave, beson në qenien e këtyre vlerave, dashurinë për njerëzit, gruan, familjen, natyrën.

Pjesë integruese e poezisë së tij është malli për fëmijërinë, një fëmijëri më tepër e ëndërruar se e jetuar, fëmijësh të pjekur para kohe, të ngjashëm me kukulla "pa fëmijëri".

.....
E ne lodheshim
Duke vrapuar nëpër ëndrra
Derisa lodhja na bëhej djersë
E djersa na bëhej kollë
E nga kolla
Pështynim varfëri.

Një ditë
E pamë veten se ishim
Kukulla të rritura
Pa fëmijëri.

Nuri Plaku ka një poezi erotike të vetën që i këndon vajzës dhe gruas në bukurinë e saj fizike dhe shpirtërore, më të simbolizuar se të vizatuar, më të sintetizuar se sa të analizuar. Është një poezi që u shmanget teprimeve erotike, shumë të përhapura në poezinë shqiptare bashkëkohëse, të lidhura me thyerjen e tabuve tradicionale, po edhe që synojnë ta tërheqin vëmendjen e lexuesve. Poezia e Nuri Plakut është një poezi e një spiritualiteti fisnik.

Mund të shtohet se poeti u takon autorëve të rrallë që i këndojnë dashurisë bashkëshortore. Ai vizaton në një nga poezitë më të mira të këtij vëllimi (kafë turke në mesnatë) një figurë gruaje që është shoqe besnike dhe ndan me poetin çdo të fshehtë, që, midis aromës së kafes dhe pagjumësisë së ndarë me burrin e jetës së saj, e bukur edhe me flokët e saj të thinjur, ëndërron tok me bashkëshortin të ardhmen që ndrit në sytë e fëmijëve të tyre.

.....
Teksa avujt e kafes e thinjin mesnatën tonë të përbashkët
Dhe thinjat e saj bëhen simotra të flokëve tanë të zbardhur.

Ani grua
Ne jemi pjesë e një bote në fluturim dhe s'duam asgjë tjetër



Veç të jemi gurë sinoresh në udhën e gjatë të brezave,

Shkruar me gjakun dhe qumështin e të parëve tanë.

Ndoshta vjen një zog pylli të qëndrojnë një çast mbi ne,

Të shkrifërojë me sqep pëndët e lodhura në stuhitë e qiellit

E të cicërijë një këngë të thjeshtë zogjsh

Kjo është pamje e bukur grua, për një gur - njeri

Dhe ne do ta shijojmë atë në të nesërmen tonë,

Nëpërmjet syve të përmalluar të fëmijëve tanë.

Ani, grua!
Dora jote në supin tim
Ma shenj tërë këto natë të pagjumë.

Poezia e Nuri Plakut dallohet për dramaticitet por, megjithatë nuk derdhet në pesimizëm ekzistencial. Kjo poezi me frymëmarrje të gjerë ka edhe një ngjyresë shqiptare që shfaqet në peizazhet karakteristike dhe përmes zakoneve (dasma dhe varrime).

Mund ta përmendim vjershën ku shpërthen mallkimi i një nuseje "dasma e thyer" me shprehjen; "o të vraftë orizi i dasmës sime!" apo vjershën tjetër, "vau i Jagodinës" që u kushtohet shtatë nuseve (vetë numri i tyre është fatidik) që mbyten tragjikisht gjatë ritualit të vajtjes për ujë.

Mund të përmendim edhe vjershat që i kushtohen "arixhiut" me "llautë" ose "shtriganes së fshatit" figurë njerëzore dhe njëkohësisht mitike ose "arixheshkës që këndonte formulat e fatit".

Në poezinë e Plakut ndeshim atë model organizimi semantik të fjalës poetike që është përkufizuar si simbol objektiv dhe Bartesi e quan si "përmbysje në njohjen e natyrës që thekson jo-vazhdimësinë e saj", në kontrast me harmoninë të ëndërruar nga romantikët.

Zoti që do të mund të vinte rregull në këtë jo-vazhdimësi dhe fragmentarizëm s'është aq mungues sa i largët. Poeti dëshiron ekzistencën e tij, po s'është i sigurt për të. Nganjëherë Nuri Plaku i referohet Krishtit dhe simbolit të tij, Kryqit, shpreh dhimbjen e vet për kryqëzimin e përditshëm të njerëzve dhe krijon një "bibël" të vetën njerëzore dhe të shkrirë me natyrën.

Poezia e Nuri Plakut është vizive, në peizazhet e tij lule, pemë dhe zogj kanë emrin e tyre të veçantë dhe të saktë: trëndafila, lulekuqe, pisha, plepa, qiparisa, ullinj, lejlekë, guguftu, pulëbardha, gjela, harabela; janë të pranishëm edhe "vëllezërit e vegjël" të



njeriut; kuaj, lepuj, flutura, milingona, një mace vetmitare. Këto peizazhe kanë ngjyrat e veta: e kuqe, e verdhë, e gjelbër, e kaltër, bardhë, ngjyra reale dhe simbolike.

Disa lirika mbajnë erë det: Plaku u takon poetëve të rrallë shqiptarë që i këndojnë detit, po i këndon në mënyrën e vet, ndryshe nga poetë si Fatos Arapi dhe Agim Mato.

Mund të thuhet edhe se kjo poezi është auditive, meqenëse, edhe nëse është strukturuar në vargje të lira, ka një muzikalitet të çuditshëm të vetin. Lirika e Plakut është një lirikë mendimi që mund të përkufizohet si "e gurtë", po të mos përmbante një "zjarr" potencial dhe të mos ishte përherë gati të shkrepente shkëndija.

Jo rastësisht, një nga fjalët çelësa të kësaj poezie është zjarr dhe përsëritet si titull në poezi të ndryshme.

Ky autor dallohet edhe për një pasuri të veçantë figurash që e befasojnë gjithnjë lexuesin: metafora, simbole dhe krahasime që ofrojnë me njëra tjetrën dukuri nga më të ndryshmet, konkrete dhe abstrakte. Në shumicën e rasteve, poeti godet në shenjë në këto figura të reja dhe të guximshme: "hëna e holluar" e "pirë nga nata", "bohçja e nënës", "mbushur me hapat" e poetit, selvia që është "një shatërvan i blertë shpirtrash", "lidhësat e këpucëve" të thurura me "këngën e gjelave të parë", "kryqi i zi" prej "mjegulle", "shegët e gjakut", vathët "milingona të argjendta", prilli "i gëlltitur".

Simbolet e kalit dhe të fluturës janë polivalente. Metafora më e habitshme është "trëndafili i kuq" te poezia "brinja e mbjellë" që duhet të shënonte vdekjen e poetit. Kjo metaforë ia kalon, për mendimin tonë "shkëmbit të bardhë" të Karduçit³.

Kërkoj një adresë të kaltër ikjesh
Fshehur nën krahët e zogjve
Të më çojë
Në një shtrat të zjarrtë vetëtimash.

Do të shqejb brinjën time nga trupi
Ta mbjell atje
Të mbijë prej saj
Një bisk i bukur gruaje.

E do të pres
I përgjruar mbi të
Derisa të çelë
Trëndafili i kuq
I vdekjes sime.

Mbase këto afrime të guximshme dëshmojnë për dëshirën e poetit për të rivendosur një harmoni dhe koherencë të natyrës përmes jo - vazhdimësisë që shndërrohet në vazhdimësi.

Në mungesë të një perëndie metafizike kjo detyrë i takon poetit demiurg. Pasuria e shumëngjyrshme e figurave i jep një shije të veçantë poezisë së Plakut, po në disa raste rrezikon të krijojë një ndjenjë ngopjeje te lexuesi si mbingarkesa e gjellëve me kripë.

Ky shndërrim i një cilësie në një të metë takohet në shumë nga poetët e sotëm shqiptarë, sidomos hermetikë dhe shkaktohet nga një pasion i papërmbajtur për figurat.

Poezia e Plakut është, në thelbin e vet, moderne dhe elitare, megjithatë ka disa pika kontakti me poezinë popullore kryesisht përmes figurave (që s'janë megjithatë të thjeshta dhe të qarta si në folklor) dhe ndonjë element etnografik. Kjo dëshmon një herë e më tepër për rrënjët e tij shqiptare ndaj të cilave poeti me gjithë frymën kozmike të tij, është i lidhur fort.

³ Aludohet për një sonet të poetit nobelist italian Karduçi ku vdekja emërtohet "shkëmb i bardhë".

Poezia e Aleksandër Cipës është ajo e mprehtësisë filozofike dhe e melankolisë fine. Autori pikturon tablonë e një ekzistence që nuk përcaktohet nga ajo çka fiton, por nga ajo çka humbet.

Tema e tij qendrore është mungesa, e cila, larg të qenit një boshllëk i thjeshtë, shndërrohet në një qenie të prekshme që strukturon vetë ekzistencën. Në një nga poezitë e tij, ai flet për “mungesën brenda meje si një gur”, e cila është një barrë e rëndë që individi duhet ta mbart, një peshë metafizike. Mungesa është një hapësirë dhe një kohësi ku identiteti zbulohet përmes përpjekjes, sepse bota perceptohet si një forcë gërryese. Deti, përroi dhe ujërat janë metafora të rrjedhës së jetës që ikën pafundësisht në të gjitha drejtimet, duke bartur me vete zgjyrat e ekzistencës. Në e shohim simbolikisht jetën, sipas Aleksandrit ajo e përbëhet nga variacione, përsëriten pareshtur me gjeeste dhe fjalë, me pasazhe që kap syri njerëzor por duke lënë gjithmonë diçka të papërfunduar.

“Se një rrjedhë ujërash / Nuk rrit pemë, por shton zhavorr”. Përvoja e jetës që Cipa përfaqëson përmes rrjedhës së përroit, nuk shihet si një forcë krijuese, por si një forcë erozioni që ndryshon peizazhin. Dherat që ikin për tu rivendosur, për të ndryshuar pamjen e tokës përreth fshatit, qytetit krahinës. Përvoja këtu shihet si një humbje e energjisë jetësore dhe si një peshë që të rëndon, për tu kthyer në një lloj tjetër energjie. Mirëpo, ky vizion që në dukje pesimist, ka brenda vetes një forcë e fuqishme tejkalmi boshtit të kohës dhe shndërrimi të qenies dhe natyrës përreth qenies. Ta zëmë në humbjen e njerëzve të dashur, ndodh një lloj përtëritjeje, një transformim: i larguari shndërrohet dhe mbijeton poetikisht në elementet jetësore si drita, uji, orteku, ylberi apo një qiri që ndriçon dhe sjell një të vërtetë të brendshme. Kjo është poezia e pastër filozofike.

Jeta është një lëkundje midis të dukshmes dhe të padukshmes, midis dhimbjes së rëndë si guri dhe dritës që buron nga përpjekja për vetë-tejkalmim. Kjo kërkesë e thellë është filli udhëheqës i veprës së Cipës. Jeta këtu nuk trajtohet si një krenim lirik, por si një gjendje ekzistenciale dhe tragjike, e rrënjësuar fort në kohë dhe në përvojën e humbjes. Nuk bëhet fjalë për një meditim mbi natyrën apo një krenim të jetës brenda saj—as për një qenie gazmore apo kozmike të llojit të Walt Whitman-it—por për një shpërfaqje të brishtësisë, mungesës dhe dhimbjes përballë ligjeve universale të ndarjes, fundshmërisë dhe humbjes.

Humbja e transcendencës çon në një boshllëk shpirtëror ku përsëritja e riteve, e gjeesteve mekanike dhe e fjalëve të kota tjetëron shpirtin. “Nuk ka këngë dhe pa besim te Zoti”, sepse “në frutin e hedhur dhe të kalbur pa Zot grumbullohet myku”. Cipa e përpunon lirizmin në favor të një zgjuarsie stoike që i jep kuptim ekzistencës. Universaliteti i jetës qëndron te brishtësia e saj e përbashkët dhe te ballafaqimi—me guxim dhe kthjelltësi—me gjëmën dhe pafuqinë përballë tragjediëve, siç mund të jetë një vdekje apo një pandemi. Jeta është një proces mësimi për të pranuar peshën e saj dhe për ta shpërfytyruar përmes vullnetit, si një Sizif modern i shtypur nga kujtesa, por që përtërin vazhdimisht atë që duket si fati i tij. Nocioni i erozionit, si një formë ikje është pra kudo i pranishëm në veprën e tij; koha gërryen qeniet dhe gjërat.

Sidoqoftë, te Cipa, jeta është një paradoks i “erozionit krijues”. Ajo i detyron individët të përballen me brishtësinë, dhimbjen, dështimin e sistemeve politike, sociale e fetare, me depresionin dhe humbjen e kuptimit. Këtë boshllëk ekzistencial, poeti duhet ta pranojë dhe të gjejë në të një formë të vërtete dhe dinjiteti stoik. Ai duhet të këmbëngulë në kërkimin e tij për kuptim dhe të tejkalojë dhimbjet e

Rreth poezisë filozofike të Aleksandër Cipës

ERA E DETIT ZGJON KUJTESËN

Nga Philippe Preux

Filolog Belg, – Skenarist,
ish-drejtor i Festivalit të filmit Mesdhetar!

mungesës. Cipa arrin të na bëjë t'i ndiejmë në mënyrë konkrete dhe të prekshme ndjenjat e tij personale falë aftësisë për të përdorur figura stili si metafora, paradoksi, personifikimet e natyrës dhe oksimoroni, i cili zbulon tensionet dhe kontradiktat në mënyrë që t'i ndiejmë ato fizikisht.

Këto nuk janë efekte dekorative apo mjete artificiale, por materializime të asaj që ndien autori: mungesa është e rëndë, minerale, e gurëzuar; koha është një hapësirë e mbyllur, shtypëse, një zgavër e errët; fytyra e jetës duket e ndryshkur si një metal i gërryer që pëson një dekompozim të ngadaltë dhe të pashmangshëm; kujtesa është një hapësirë e lëngshme, e turbullt, që pasqyron dhe tjetëron njëkohësisht si sipërfaqja e një pellgu të trazuar nga era; pagja është “grindavece”, trishtimi ndriçues. Ati si figurë e kudogjendur, shndërrohet në dritë, ylber, engjell, i fragmentuar dhe i shpërndarë në elementet panteiste. Gjithashtu ai është i pranishëm si një vend prehjeje, ai që ka “një brengë të madhe për qiejt”. Si në legjendat dhe mitet e lashtësisë, në ato vende ku fryn guximi i Akilit dhe dhelpëria e Odisesë që nga koha homerike. Po, po ati mbetet i dukshëm “nën lëkurën e lodhur, të fytyrës së tij kalimtarëve”.

Te Cipa ekzistojnë korrespondenca mes fenomeneve të natyrës dhe emocioneve të poetit! Madje kjo duket si imazhet e mbetura në memorien e një të verbuari, që jeton mes kujtimeve të vendit të humbur dhe qeshjet e njerëzve të dashur. Retë, shiu, mjegulla, dëbora, drita, madje dhe deti që ndonjëherë është “i qetë si një foshnjë në gjumë” përpara se “valët dhe stuhitë të zgjohen nga thellësitë” shfaqen si pjesë e përjetimeve sublime. Të gjitha këto elemente, ashtu si e shkuara dhe e tashmja, zbulojnë dhe lartësojnë dashurinë, praninë e saj, dëshirën për ti bërë të padukshme të dukshme. Drita shpërthen nga çdo anë, madje edhe nga një qiri i thjeshtë. Kjo dritë

është shpresë, madje edhe trishtimi dhe nostalgjia ndriçon aq bukur. Dimri, krifa e ngrirë, i ftohti fshehin të padukshmen... Pemët flenë nën akull... drita e diellit ngrohet dhe djeg njëkohësisht. Ndonjëherë ekzistenca duket e pamundur në teprimet e saj! E vërteta shpesh fshihet në kujtimet e hidhura përballë “dominimit të injorancës dhe ligësisë që shpalos e keqja”. Në një vend Poeti Cipa na thotë se “nostalgjia është si një brengë ferri” në rrugën e vetmisë dhe në dhimbjen e mërgimit.

Aleksandër Cipa nuk shikon në mënyrë filozofike vetëm nga e kaluara dhe nostalgjinë - që vjen nga ajo; Ai lëvtron poezinë e kohës dhe tokës amtare. Ai nuk ushqen asnjë iluzion për epokën tonë, për pasivitetin dhe mungesën tonë të empatisë: “në detin Mesdhe, na nevojitet një arkivol për ndjeshmërinë tonë. . . Popujt e ngjashëm, por tashmë të pabarabartë shkërmoqen nën bomba në kohën e dronëve . Mjerisht, vetëm hëna na mbetet paqësore”.

Në një stil të zhveshur, herë-herë të ashpër, Aleksandër Cipa shkon te thelbësorja me pak fjalë; ai na rrëfen atë që ndien, ankthin e tij ekzistencial dhe përpjekjet për ta zbutur e eleminuar atë. Drita zë vendin e errësirës, rrjedha e jetës dëbon amullinë, degradimin dhe konsumimin që gërryen shpirtin. Cipa është gjithashtu një njeri i miqësisë dhe i besnikërisë: homazhet e tij për regjisorin Dhimitër Anagnosti dhe këngëtarin Hyso Xhaferaj dëshmojnë për këtë. Ai na thotë: “Nuk jam gjahtar i dobësisë”, dhe e di se “njeriu është triumfues”. Ai na këshillon të mos vajtojmë kohën e humbur, sepse fati na tërheq pas vetes. “Është tepër herët që ti të bëhesh kujtim”. Ndonjëherë mjafton të presësh, sepse uji e lan tokën dhe dashuria është e padukshme, për sa kohë që “pema nuk i ka shteruar rrathët e saj” brenda tringut të jetës..



CV PHILIPPE PREUX

Philippe Preux ka lindur në vitin 1952 në Belgjikë.

Pas studimeve të shkollës së mesme greko-latine, ai ka kryer studimet master në filologji romane, në Universitetin e Brukselit, kualifikimin për mësimdhënie në arsimin e mesëm të lartë, më pas një Akademi në sektorin e Komunikim social dhe të gazetarisë. Gjithashtu ai ka poseduar edhe një licencë në tregti të jashtme dhe marrëdhënie ndërkombëtare.

Pas disa viteve si pedagog i gjuhës frënge fillimisht në arsimin e mesëm dhe më pas në atë të lartë, ai u emërua si përgjegjës për Kulturën në Rajonin e Brukselit. Ai është një nga themeluesit e Festivalit “Kinemaja Mesdhetare në Bruksel” në vitin 1989 dhe një nga organizatorët e evenimentit deri në vitin 2015.

Gjithashtu ai ka qëndruar në SHBA (me bursë nga qeveria e SHBA-së): Universiteti i “South Western of Louisiana” në Lafayette. Ai gjithashtu ka kryes studime eksploruese në Egjipt (me bursë nga Administrata e Marrëdhënieve Kulturore Ndërkombëtare): Universiteti i Kajros nga 1/1/1982 deri më 21/3/1982.

Ai ka qenë organizator udhëtimesh të karakterit kulturor nga viti 1985 deri në 1995 për agjencitë e udhëtimit në Egjipt, Siri, Turqi, Greqi, Meksikë, SHBA, Peru, Ekuador, Salvador, Panama, Guatemalë, Honduras, etj.

Publikime dhe realizime

“La langue des Cajuns” (Gjuha e Cajunëve) botuar në revistën “L’Ethnie française”, prill 1981 nr. 2, Bruksel;

“Regards alternés. Reportage en hôpital” (Vështrime të alternuara. Reportazh në spital), 78 faqe, “Les Cahiers de la Télévision”, nr. 14 dhjetor 1986, Bruksel;

Bashkautor i serialit televiziv “La vie quotidienne à Bruxelles pendant la période 40-45” (Jeta e përditshme në Bruksel gjatë periudhës 40-45) (8 episode nga 12’) 1987;

Ai gjithashtu është realizuesi i dokumentarit mbi surrealizmin në Belgjikë: “Autour de Correspondances” (Rreth Korrespondencave) 1990;

Gjithashtu ai ka botuar me qindra artikuj të ndryshëm të botuar në gazeta dhe revista.



Në përmbledhjen me tregime gjermane të titulluar "Vdekja e Lohengrinit" vendin e fundit e mban tregimi i Aleksander Kluges, i titulluar "Eksperiment dashurie", me përkthim të Afrim Koçit. Është një tregim i shkurtër, i ngjeshur. Autori ka zgjedhur si rrëfyes zërin e njërit prej oficerëve, a ushtarakëve nazist. Është zëri i dikujt që i ka parë së afërmi ngjarjet, pra ka qenë i pranishëm. Rrëfyesi, fillimisht jep informacionin se për çfarë do të rrëfejë. Që në hyrje tregohet se në vitin 1943, mjekët e kampeve duke përdorur rrezet röntgen po tentonin të realizonin kryerjen e shterpëzimeve masive. Dhe fill pas kësaj hyrjeje, ai nxiton të theksojë se: "Zhvilluam pra, për këtë qëllim, një eksperiment me një të burgosur mashkull e një femër." ("Vdekja e Lohengrinit", Sh.B "Naim Frashëri", Tiranë, 1991.)

Jo pa qëllim tregimi mban titullin "Eksperiment dashurie", titulli është ironik, pasi në kushtet kur liria e ndjenjat e tjera shtypeshin mizorisht nuk kishte vend për dashuri. Është një zgjedhje e goditur e autorit.

Për të testuar efikasitetin e eksperimentit, siç dhe e përmendëm ishte e domosdoshme që një çift njerëzish të bënin dashuri, në mos dashuri, të kryenin marrëdhënie seksuale. Ndaj dhe në mes të të burgosurve u përzgjedh një çift që më parë ishin njohur, kishin patur marrëdhënie, dhe rezultoni të ishin kavit perfekte. Përzgjedhja, natyrisht u bë duke pasur informacion paraprak për dy të burgosurit.

"Vetë të eksperimentuarit ishin zgjedhur me kujdes. Sipas dokumenteve të dy personat e eksperimentuar duhej të kishin një interes erotik të lartë për njëri - tjetrin. Nga dilte kjo? J-ja, vajzë e një këshilltari qeveritar, e datëlindjes 1915, pra 28 vjeçe, me burrë arian, me arsim të mesëm, studime për histori arti njëhej për marrëdhëniet tepër të ngushta me të eksperimentuarin e gjinisë mashkullore, njëfarë P, i datëlindjes 1900, pa profesion.

Për hir të P-së, J-ja braktisi dhe të shoqin arian, shpëtimin e saj. Ajo i vajti pas të dashurit të saj në fillim në Pragë, më vonë në Paris. Në 1938 P-ja u arrestua në territorin e Rajhut. Disa ditë më vonë u duk në këto territore në kërkim të P-së edhe J-ja, që gjithashtu u arrestua. Në burg e më vonë në kamp, të dy u përpoqën disa herë të takoheshin."

Hapi fillestar, ai i përzgjedhjes së kavieve ishte bërë.

Gjithashtu ishte bërë e mundur që personat e përgjedhur që më parë të ishin



(mbi tregimin "Eksperiment dashurie" të Aleksandër Kluges)

Një eksperiment dashurie në kampet e përqendrimit

Nga Xheni Shehaj



të mirëushqyer. Hapi pasardhës, (duhet thënë se ecuria e hapave në tregim nuk është kronologjike, rrëfyesi rrëfen çfarë ka parë, çfarë ai di për rastin në fjalë) ishte krijimi i një ambjenti sa më të rehatshëm e të volitshëm, dhe duhet thënë që ky ishte hap mjaft i rëndësishëm pasi lidhej drejtpërsëdrejti me reagimin e çiftit e për pasojë ardhjen e rezultatit pozitiv të eksperimentit.

"Dhoma e caktuar ishte më e madhe se shumica e qelive të kampit dhe e shtruar me qilima nga të drejtorisë."

Kontrasti që autori përdor për ambjentin ku është vendosur çifti është drastik. Nga ambjentet e ftohta, të errëta, që qelbeshin erë djerse, urine, erë trupash të palarë, ai i vendos ata në një dhomë të pastër, të madhe, të shtruar. Natyrisht, ky do të ishte një sinjal për burrin dhe gruan e mbyllur aty. Shto këtu dhe ushqyerjen e mirë që kishin marrë prej disa kohësh.

Vrojtimi i lëvizjeve të çiftit bëhej i mundur nëpërmjet një vrime të fshehtë, e hapur posaçërisht për vëzhgim. Një

shpurë e tërë mjekësh, oficerësh, të ftuarish "speciale" prisnin çiftimin e dy njerëzve. Kishte shumë gjasa që dy të burgosurit ta ndjenin se po vëzhgoheshin, e kjo ndjesi i bënte ata të mos reagonin ndaj njëri - tjetrit.

Mosreagimi i burrit dhe i gruas ishte zhgënjyes. Mbetej të bëheshin disa përçapje, të cilat rezultuan negativisht. Gjithsesi mendojmë se ia vlen t'i përmendim, për të shuar disi kuriozitetin e lexuesit por edhe për të mos e ndërprerë në këtë formë pasi mund të shtoheshin dyshimet për paaftësi të personelit mjekësor e më gjerë. Ata nuk është se nuk u munduan, i provuan të gjitha, siç e thekson edhe vetë rrëfyesi "Mund t'ju garantoj se u provua gjithçka. Kishim në mes tonë një obersharfyhrer që diç merre vesh nga këto punë. Dhe një nga një ai provoi gjithçka që zakonisht vepronte dorë me një."

Fillimisht të burgosurve iu kërkua të zhvisheshin. Ashtu u bë. Por sërish ata nuk u afruan të kërkonin trupat e njëri - tjetrit. I vunë muzikë, e cila i shkundi



paksa, ua tërhoqi vëmendjen por aq. Asnjë reagim më tej. P- ja dhe J-ja vijonin të qëndronin të topitur. U dhanë për të pirë të bardhë veze, i lagën me ujë në mënyrë që të afroheshin për t'u ngrohur, i dhanë mish, shampanjë, verë, i fërkuan me alkool, ndryshuan ndriçimin e dhomës. Asgjë. Burri dhe gruaja vijonin të qëndronin në heshtje, pa folur, pa u prekur. Asgjë nuk i ngacmonte ata. E pra, eksperimenti në këtë rast dështoi, megjithëse do të provohej edhe herë të tjera me të tjerë të burgosur. Fati i të dyve ishte i pashmangshëm. Ata i priste pushkatimi.

Natyrshtëm lind pyetja: Përse burri dhe gruaja nuk u afruan, në mos për të bërë dashuri, të paktën t'i jepnin të njohur njëri - tjetrit, të kishin një komunikim qoftë edhe të thatë. Reagimi i çiftit sjell një mori pyetjesh të cilat i shtron si lexuesi ashtu dhe rrëfyesi:

Kishin dijeni ata për shterpëzimin e bërë?

U turpëruan nga njëri - tjetri të eksperimentuarit?

Mos u mungonte të eksperimentuarve gatishmëria?

A ishin ushqyer mirë të burgosurit?

Mos kishin frikë se mos i quanin të shturur?

Mos pandehnin se ky ishte një provim për të provuar moralin e tyre?

Mos hija e rëndë e kampit ngrihej mes tyre si një mur i lartë?

A e dinin ata vallë se në rast mbarsjeje të dy trupat do të hapeshin për t'u studiuar?

Rrëfyesi nuk nguron t'i përgjigjet secilës pyetje. Dhe sdo mend që ai do besuar pasi ka qenë atje dhe di çfarë flet. Në këtë mënyrë rrëfyesi shfaqëson personelin e të pranishmit. Madje ai pasi thotë se janë ezauruar të gjitha mënyrat mbetet vetëm një e tillë, të cilën po ai e vetë e përjashton kategorikisht: "Mbeti veç të shkonim vetë për ta provuar fatin, por kjo s'mund të bëhej, sepse ishte turp racor."

Tregimi mbyllet me një pyetje e cila tenton ta drejtojë lexuesin në një përgjigje që do të fikte shpresat për ekzistencën e dashurisë.

"Mos do të thotë kjo se në një pikë të caktuar të vuajtjes dashuria nuk mund të ekzistojë?"

Në vend të kësaj tentative "dashakeq" ne mund t'i përgjigjemi ndryshe pyetjes. Burri dhe gruaja, pikërisht se dikur kishin patur ndjenja për njëri - tjetrin, për hir të njohjes, dashurisë së dikurshme, nuk reaguesin pasi mund të kenë menduar se mos i bënin dëm tjetrit. E kanë parë situatën si provokim, dhe për të mos rrezikuar as veten, as sho - shoqin zgjedhën heshtjen. Ata nuk e dinin se çfarë i priste, ndaj dhe e logjikuan heshtjen si të vetmen rrugë, që mund t'i shpëtonte.

Në historinë e kulturës shqiptare ekzistojnë vepra që nuk qëndrojnë vetëm si krijime artistike të arrira, por edhe si dëshmi të gjalla të jetës njerëzore. Ato mbartin brenda vetes historinë e dhimbjeve, të plagëve dhe të përvojave që kanë formësuar fatet e njerëzve dhe kujtesën e një kohe.

Këto vepra nuk kanë lindur thjesht nga frymëzimi estetik apo nga loja e imagjinatës krijuese, por më së shumti kanë ardhur në jetë edhe nga përjetimet e thella, nga plagët personale dhe nga episode të dhimbshme të jetës së vetë autorëve të tyre, duke u bërë pasqyrë e ndjeshme e botës që i rrethon dhe një thesar shpirtëror për brezat që vijnë.

Pikërisht për këtë arsye, këto vepra mbartin një ngarkesë të veçantë emocionale dhe njerëzore: njëherazi janë rrëfime individuale dhe pasqyrë e një realiteti më të gjerë shoqëror.

Me kalimin e kohës, përvoja personale që i ka lindur ato shkëputet nga kufijtë e jetës së autorit dhe shndërrohet në një pasuri të përbashkët shpirtërore, duke u bërë pjesë e kujtesës kulturore dhe emocionale të një kombi të tërë.

Një ndër këto raste është romani "Bonjakët" i shkrimtarit Petraq Qafëzezi, një vepër që më pas u shndërrua në një nga filmat më ikonikë të kinematografisë shqiptare, "Lulëkuqet mbi mure", i ekranizuar me mjeshtëri të rrallë nga regjisori i paharruar Dhimitër Anagnosti.

Ky film mbetet edhe sot ndër majat e realizimeve kinematografike, si një margaritar i artë i kinemasë sonë. Vlera e tij nuk qëndron vetëm te mjeshtëria artistike e realizimit në të gjithë komponentët e produksionit, por edhe te thellësia njerëzore dhe mesazhet universale që mbart kjo vepër filmike.

Në thelbin e këtij filmi nuk gjendet thjesht një narrativë artistike e ndërtuar mbi imagjinatën krijuese, por një histori e vërtetë njerëzore, e lindur nga kujtesa dhe përvoja e jetuar nga vetë autori i kësaj vepre.

Pikërisht kjo lidhje e drejtpërdrejtë me jetën reale i jep filmat një ndjeshmëri të veçantë dhe një autenticitet që e bën atë të mbetet i gjallë dhe domethënës për të gjithë artdashësit dhe brezat e sotëm të shikuesve.

Petra Qafëzezi lindi më 11 mars 1935 në qytetin e Korçës, një nga qytetet më të rëndësishme të kulturës shqiptare.

Por jeta e tij nuk nisi me lehtësinë dhe ngrohtësinë e një familjeje të zakonshme, pasi prindërit i humbi në luftë dhe ai u rrit jetim në "Strehën Vorfnore" gjatë viteve të pushtimit italian, në një kohë kur Shqipëria përjetonte varfëri dhe trazira historike.

Në këtë mjedis të ashpër, mes mureve të ftohta të një institucioni për jetimë, ai njohu nga afër ndjenjat më të vështira që mund të përjetojë një fëmijë bonjak: mungesën e prindërve, vetminë dhe mallin për një përqaftim që nuk i erdhi kurrë.

Pikërisht në këtë përvojë të dhimbshme u formua edhe ndjeshmëria e tij e thellë njerëzore, ajo që më vonë do të shndërrohej në letërsi.

Jeta e tij, megjithatë, do të merrte shumë kthesa të tjera interesante dhe shpesh të rrezikshme, që do të formësonin karakterin dhe botën e tij të brendshme.

I mbetur jetim kur ishte vetëm dy muajsh, nga mosha tre deri në trembëdhjetë vjeç u rrit në jetimoret e Korçës, Shkodrës dhe Tiranës, në një periudhë që përkon me zhvillimin e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Në Korçë përjetoi ditët e luftës italo-greke, ndërsa në Tiranë atmosferën e tensionuar të

Dy fjalë për autorin e romanit "Bonjakët", skenaristin e filmit artistik shqiptar "Lulëkuqet mbi mure", mikun tim Petraq Qafëzezi

JETA KA GJITHMONË NJË MËNYRË PËR TË LULËZUAR...!

Nga Ilir Çumani



betejës për çlirimin e qytetit nga nazistët më 17 nëntor 1944.

Pas tre vitesh studimesh për inxhinieri ndërtimi në Teknikumin e Ndërtimit në Tiranë, në vitin 1958 nisi kursin e aviacionit ushtarak, fillimisht në Tiranë dhe më pas në Qytetin Stalin.

Në verën e vitit 1960 përjetoi disa aksidente me avionë; njëri prej tyre, në gusht të atij viti, mbeti një nga momentet më dramatike të jetës së tij.

Gjatë një fluturimi stërvitor, avionit të tij MiG-15 iu bllokuan krahët në një lartësi prej rreth 4000 metrash dhe nisi të bjerë me shpejtësi drejt tokës. Në ato çaste vendimtare ai u hodh nga avioni me katapultë dhe shpëtoi falë parashutës.

Më pas vazhdoi për një vit studimet e aviacionit në Bashkimin Sovjetik. Por rruga e tij si aviator nuk do të vazhdonte më tej. Pas rebelimit të një grupi studentësh shqiptarë kundër mënyrës së trajtimit nga shkolla, ai ndërpreu studimet dhe u kthye në Shqipëri.

Kthimi në atdhe shënoi edhe një kthesë tjetër të rëndësishme në jetën e tij. Ai përfundoi studimet për inxhinieri ndërtimi dhe nisi punë si arkitekt në

Ministrinë e Ndërtimit në Tiranë. Në vitin 1966 u vendos me banim në qytetin e Durrësit, ku punoi në zyrën shtetërore të projekteve të ndërtimit.

Në këtë qytet ai la edhe gjurmët e punës së tij si arkitekt: ishte bashkarkitekt në projektimin e Pallatit të Sportit dhe të kinoteatrit të qytetit, si edhe në konvertimin e xhamisë së qytetit në një objekt kulturor laik.

Megjithatë, paralelisht me profesionin e inxhinierit, ai kultivoi një botë të brendshme artistike shumë të pasur.

Letërsia për të ishte një mënyrë për të rrëfyer historitë e heshtura të jetës, për ta kthyer kujtesën personale në një formë arti që mund të kuptohej nga të gjithë.

Romani "Bonjakët", i cili fitoi Çmimin e Republikës në vitin 1972 dhe në konkursin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve fitoi çmimin e parë, është një nga veprat më të ndjera të letërsisë shqiptare të shekullit XX.

Në këtë roman Petraq Qafëzezi nuk krijon një histori të trilluar. Ai rrëfen jetën e tij, jetën e një fëmije jetim që rritet në një institucion, mes fëmijëve të tjerë që ndajnë të njëjtin fat.

Në këtë univers të vogël, të kufizuar nga muret e një strehe jetimësh, zhvillohen drama të mëdha njerëzore: malli për prindërit e humbur, kërkimi i dashurisë dhe përkujdesjes, rebelimi i heshtur kundër padrejtësisë dhe ndaj autoriteteve fashiste që administrojnë strehëzën e jetimëve.

Fëmijët e këtij romani janë të plagosur nga jeta, por nuk janë të thyer prej saj. Ata mbajnë brenda vetes një energji të çuditshme për të jetuar dhe për të ëndërruar.

Nga ky roman lindi më pas filmi "Lulëkuqet mbi mure", një nga veprat më të dashura për publikun shqiptar.

Në duart e regjisorit Dhimitër Anagnosti, historia e fëmijëve jetimë u shndërrua në një poemë filmike për fëmijërinë dhe lirinë e fëmijëve që jetojnë mes plagësh të mëdha shpirtërore dhe emocionale, mungesës së fëmijërisë dhe të familjes.

Për të kuptuar thellësisht romanin "Bonjakët" dhe filmin "Lulëkuqet mbi mure", duhet të kuptojmë edhe dimensionin psikologjik të jetës së fëmijëve jetimë.

Fëmijëria është periudha kur krijohet ndjenja e parë e sigurisë në botë. Kur kjo siguri mungon, fëmija mëson shumë herët një gjë të vështirë: të mbijetojë emocionalisht.

Fëmijët e rritur në institucione shpesh zhvillojnë një lloj solidariteti dhe besnikërie të veçantë mes tyre.

Ata krijojnë një familje të re, një vëllazëri të heshtur, ku shoku i dhomës bëhet vëlla, ndërsa kujtimi i prindërve mbetet një plagë e heshtur dhe e përherëshme.

Në këtë kuptim, romani i Petraq Qafëzezit nuk është vetëm një histori personale, por një studim i thellë i shpirtit të fëmijës jetim, i aftësisë së tij për të ndërtuar një botë të brendshme edhe kur jeta i ka marrë shumë gjëra.


Institucionet për fëmijët jetimë krijojnë një realitet të veçantë social. Ato janë një lloj mikroshoqërie, me rregullat, hierarkitë dhe rritoret e veta.

Brenda këtyre mureve krijohet një kulturë e veçantë: mënyra se si ndahet ushqimi, mënyra se si krijohen miqësitë, mënyra si lind rebelimi ndaj autoritetit.

Romani "Bonjakët" dhe filmi "Lulëkuqet mbi mure" e përshkruajnë këtë mikrokozmos me një vërtetësi të rrallë.

Në këtë roman rrëfëhet se edhe në një institucion të rreptë jeta gjen mënyra për të qenë e gjallë përmes lojërave, shpresës, guximit, rebelimit dhe ëndrrave të fëmijëve.

Titulli i filmit është një metaforë e



Shkrimtari Petraq Qafëzezi, ushtarak në Aviacionin Shqiptar - vitet 60

bukur dhe e dhimbshme njëkohësisht: lulëkuqet janë lule të brishta, por njëkohësisht të forta. Ato rriten mbi mure dhe simbolizojnë jetën që lulëzon edhe në vendet më të papritura e të papërshtatshme.

Ashtu si këto lule të kuqe që çelin mbi gurë, edhe fëmijët e këtij filmi rriten mes vështirësive, por ruajnë brenda vetes një shpirt të gjallë, të bukur dhe vital.

Muret përfaqësojnë kufizimin, disiplinën dhe izolimin, ndërsa lulëkuqet përfaqësojnë jetën, imagjinatën dhe lirinë. Prandaj filmi është në thelb një histori për jetën që arrin të lulëzojë edhe mbi muret më të forta të fatit.

Përveç romanit “Bonjakët”, Petraq Qafëzezi ka shkruar edhe romane të tjera me elementë autobiografikë: “Moshatarët” (1976) dhe “Ruga e fluturimeve” (1981), si edhe vëllime të tjera me tregime.

Ai është gjithashtu autor i shumë teksteve të njohura të këngëve në disa Festivale të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar, deri në festivalin e 13-të, në vitin 1974. Mes tyre: “Si mimoza që çelën”, “Sot jam njëzet vjeç” dhe “Nënave shqiptare”, të interpretuara nga virtuoza e papërsëritshme e muzikës së lehtë shqiptare, këngëtarja e madhe Vaçe Zela.

Këto krijime tregojnë se ai ishte një autor me një ndjeshmëri të rrallë poetike.

Për mua kjo histori nuk është vetëm histori letërsie apo kinemaje, por një histori miqësie njerëzore, e lindur nga një përvojë e përbashkët jetësore.

Kam pasur fatin ta njoh nga afër Petraq Qafëzezin dhe së bashku kemi ndërtuar një miqësi prej vitesh. Pavarësisht distancës së madhe që na ndan me vitet, mes nesh ka ekzistuar gjithmonë një lidhje e veçantë, një mirëkuptim i heshtur që nuk kishte nevojë për shumë shpjegime, sepse bashkë na lidhi i njëjti fat i ngjashëm i fëmijërisë.

Ai ishte rritur jetim në “Strehën Vorfnore” gjatë viteve të pushtimit italian, ndërsa unë në Shtëpitë e Fëmijëve gjatë viteve të sistemit socialist.

Dy kohë të ndryshme historike, dy sisteme të ndryshme shoqërore, por e njëjta mungesë, e njëjta plagë e heshtur që mbart çdo fëmijë që rritet në vetmi.

Kur flisnim për romanin “Bonjakët”, shpesh nuk ishte thjesht një bisedë për letërsinë, por një rikthim në kujtesën tonë të përbashkët, në atë botë të mbyllur mes mureve të institucioneve ku fëmijët mësojnë shumë herët të rriten.

Ndoshta për këtë arsye, për mua “Lulëkuqet mbi mure” nuk ishte vetëm një film, por një pjesë e qenësishme e jetës sonë.


Historia e Petraq Qafëzezit është një dëshmi se si dhimbja mund të shndërrohet në art dhe se si kujtesa personale mund të bëhet kujtesë kolektive.

Nga muret e një strehe jetimësh lindi një roman. Nga ai roman lindi një film. Dhe nga ai film lindi një nga kujtimet dhe veprat më të bukura të kulturës shqiptare.

Prandaj, kur kujtojmë Petraq Qafëzezin, edhe sot që i ka kaluar të nëntëdhjetat dhe përjeton një situatë shëndetësore jo edhe aq të lehtë në Torino, Itali, nuk kujtojmë vetëm një shkrimtar apo një skenarist, por një njeri model, një shembull që arriti ta kthejë dhimbjen e fëmijërisë në lulëkuqe arti, nga ato lulëkuqe që vazhdojnë të çelin mbi muret e kujtesës sonë kulturore.

Kjo është edhe metafora më e bukur e jetës së tij dhe e jetëve tona: se edhe mbi muret më të ftohta të fatit, jeta gjen gjithmonë një mënyrë për të lulëzuar.

Tiranë, e mërkurë – 11 mars 2026



Arti është politikë dhe politika është art

Nga Dr. Bledar Kurti

Ekziston një dëshirë e vazhdueshme për ta konceptuar artin si një hapësirë të pastër, të çliruar nga pesha e politikës, një territor ku estetika mbizotëron mbi ideologjinë dhe ku krijimtaria jeton e paprekur nga konfliktet e pushtetit. Por kjo është më shumë një fantazi romantike sesa një realitet historik.

Arti nuk lind në vakum; ai është produkt i kohës së vet, i tensioneve shoqërore dhe i strukturave të pushtetit që e rrethojnë. Në këtë kuptim, arti dhe politika nuk janë thjesht të lidhura por të ndërthurura në mënyrë organike.

Që nga antikiteti, arti ka shërbyer si një formë reflektimi dhe interpretimi të realitetit politik. Tragjeditë e Greqisë së lashtë nuk ishin vetëm rrëfime estetike, por analiza të thella mbi drejtësinë, fatin dhe pushtetin. Arti, pra, nuk është vetëm pasqyrë; ai është një instrument që ndërton kuptim.

Kjo ndërthurje bëhet edhe më e dukshme në artin pamor, veçanërisht në pikturë. “Guernika” e Pablo Picasso mbetet një nga dëshmitë më të fuqishme të kësaj marrëdhënieje. E krijuar në kontekstin e Luftës Civile Spanjolle, kjo vepër nuk është thjesht një reagim artistik, por një akt akuze ndaj dhunës dhe barbarisë. Fragmentimi i figurave, ankthi i përhapur dhe mungesa e një rendi të qartë vizual krijojnë një gjuhë që tejkalon propagandën dhe depërton në ndërgjegjen kolektive. Këtu arti nuk pasqyron politikën, ai e sfidon atë.

Në të kundërt, piktura “Napoleoni duke kaluar Alpet” e Jacques-Louis David ilustron se si arti mund të instrumentalizohet nga pushteti. Napoleoni paraqitet si figurë heroike, pothuajse mitologjike, i hipur mbi një kalë madhështor dhe realiteti historik transformohet në një narrative glorifikuese ndërkohë që e vërteta është që ai i kaloi Alpet mbi një gomar. Kjo është estetika në shërbim të politikës, një formë e sofistikuar propagande që synon të ndërtojë legjitimitet përmes imazhit.

Në të njëjtën linjë, “Liria Drejton Popullin” e Eugène Delacroix nuk është

vetëm një përshkrim i Revolucionit Francez, por një mitizim i saj. Figura alegorike e Lirisë nuk dokumenton historinë; ajo e transformon atë në një simbol mobilizues. Arti, në këtë rast, bëhet një gjuhë politike që frymëzon dhe orienton ndërgjegjen kolektive.

Një dimension tjetër i kësaj marrëdhënieje shfaqet në veprën “Tre Maji 1808” të Francisco Goya. Kjo pikturë nuk glorifikon luftën, por e çmonton atë. Viktima anonime përballë një makinerie të ftohtë ushtarake shndërrohet në simbol të individit të shtypur nga pushteti. Këtu arti nuk është propagandë; ai është rezistent.

Në shekullin XX, arti merr një dimension edhe më të vetëdijshëm politik. Shkrimtarë si George Orwell e përdorën krijimtarinë si një mjet për të sfiduar totalitarizmin. “Në kohë mashtrimi universal, të thuash të vërtetën është një akt revolucionar,” shprehej ai, një thënie që e vendos artin në qendër të betejës për të vërtetën. Në të njëjtën frymë, Bertolt Brecht e përkufizonte artin jo si pasqyrë, por si një çekiç për të formësuar realitetin.

Por arti nuk është vetëm i drejtuar nga jashtë; ai është edhe një eksplorim i brendshëm që shpesh rezulton politik. Veprat e Frida Kahlo janë një shembull i qartë: identiteti, trupi dhe dhimbja personale ndërthuren me kontekstin shoqëror dhe ideologjik. Intimja bëhet politike.

Megjithatë, ndoshta aspekti më i ndërlikuar i kësaj marrëdhënieje është ideja e neutralitetit. A mund të ekzistojë arti apolitik? Edhe kur një vepër përpiqet të shmangë çdo angazhim, ajo në fakt bën një zgjedhje, zgjedhjen për të mos reaguar. Dhe kjo, në vetvete, është një pozicion politik.

Në realitetin bashkëkohor, ku imazhi ka marrë një rol dominues në komunikim, arti vazhdon të jetë një fushë beteje për narrativat. Nga piktura klasike te format digjitale, artistët vazhdojnë të sfidojnë pushtetin, të ekspozojnë padrejtësitë dhe të krijojnë hapësira për reflektim kritik.

Në fund, ndarja mes artit dhe politikës

nuk është vetëm e pamundur, ajo është edhe e padëshirueshme. Pikërisht në tensionin mes tyre lind arti që ka peshë, që sfidon, që trondit dhe që mbetet. Sepse arti nuk është thjesht një mënyrë për të parë botën; ai është një mënyrë për ta ndryshuar atë. Përmes artit edhe Luledielli të vdekura të Van Gogh përcjellin një mesazh epokal.

Nga ana tjetër, Politika është art, sepse nuk është thjesht një proces mekanik i marrjes së vendimeve, por një aftësi e ndërlikuar që kërkon zgjuarsin, intuitë dhe kreativitet. Ashtu si një artist që përdor ngjyrat për të krijuar një tablo harmonike, politikuani përdor fjalën, strategjinë dhe kompromisin për të ndërtuar marrëdhënie dhe për të arritur qëllime në një shoqëri të larmishme.

Në politikë nuk ekziston gjithmonë një përgjigje e saktë apo një rrugë e vetme për zgjidhjen e problemeve. Kjo kërkon aftësi për të kuptuar njerëzit, për të lexuar situatat dhe për të përshtatur veprimet sipas rrethanave. Një politikan i suksesshëm duhet të dijë të balancojë interesat e ndryshme, shpeshherë të kundërta, duke krijuar një “kompozim” që i shërben të mirës së përbashkët, qeverisjes apo kohëzgjatjes së pushtetit.

Gjithashtu, politika është art sepse lidhet ngushtë me komunikimin. Fjalimet, debatet dhe mënyra se si paraqiten idetë janë thelbësore për të fituar besimin e publikut. Një mesazh i formuluar mirë mund të frymëzojë, ndërsa një gabim i vogël mund të dëmtojë besueshmërinë. Një fjalim e prezantim i mirë tregon besueshmëri ndërsa paaftësia në komunikim shpallot publikisht mungesë karakteri e aftësi drejtuese.

Në fund, politika si art qëndron në aftësinë për të krijuar harmoni në mes të kaosit, për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe për të formësuar një të ardhme më të mirë për shoqërinë si edhe për të kapërcyer horizontet zhvillimore.

Arti është politikë dhe politika është art, cilido që i ndan nuk është as artist i mirë e as politikan i zotë.

KJO ËNDËRR E ZOTIT

Zoti, para se ta krijonte botën, e ndezi dritën. Kjo do të thotë që ai ishte në gjumë, dhe para se ta krijojë, e ëndërroi atë. Ja pse kjo botë na duket si një ëndërr, brenda së cilës kemi ëndrrat tona të vogla, derisa në fund të biom në gjumin e madh dhe ta lëmë ëndrën e realizuar të Zotit pa arritur t'i realizojmë ëndrrat tona.

E, tashmë që Zoti ka vdekur dhe ne, gjithashtu, do të vdesim, kush do ta fikë dritën?

ÇKA ËSHTË DASHURIA?

Vonë, pas mesnate, djali sillej herë në njërin krah, herë në tjetrin. Kur e pa që s'po mund të flinte, u çua, doli në ballkon. Vuri bërrylat mbi parmakë, shikoi hënën lart dhe trëndafilat poshtë që zbkuronin kopshtin nën dritën e saj.

Duke ndenjur ashtu, u ndërmend dhe shkoi e trokiti te dhoma e babait, i cili u vonua pak derisa ndezi llambën, vuri syzet dhe gjeti pantoflat. Kur babai e hapi derën, djali ia priti:

- Çka është dashuria?

Babai, që kishte qenë duke bërë dashuri me gruan, shikoi në të dy anët e korridorit se mos shihte përgjigjen ndokund.

- Është ora dy e natës, bir, dhe ti s'ke fjetur?

- S'mund të fle pa e gjetur përgjigjen.

- S'mund të flesh? E, pra, tashmë e paske gjetur, - i tha babai, ia ktheu shpinën dhe e mbylli derën.

PEGASI

Ajo ishte mbështetur në supin e tij dhe po shikonte perëndimin e diellit. Ai mbante hapur librin dhe po i lexonte poezi, vargjet e së cilës ia kishin ndezur imagjinatën, aq sa i dukej sikur po shihte kalin e bardhë me një bri në ballë duke u ngjitur drejt qiellit. Ndjesia që përjetonin dy të dashuruarit ishte e ëmbël, dhe pamja poetike ishte aq e bukur sa të linte pa fjalë, sikur të mos prishej nga një incident banal. Pak metra më tutje një kalë tjetër i bardhë po çiftohej me një gomaricë.

S'di se cili çift po kënaqej më shumë, por e merrja me mend që e ardhmja e të dy çifteve ishte mushkë.

LEKSION ETIK NGA NJË NJERI CULLAK

Një antropolog evropian vizitoi një ditë një 'fis të egër' që hynte në fushën e tij të studimit. Përpara i doli një burrë cullak, sapo e pa që dikush hyri në fushën e tij të studimit.

U përshëndetën. I zhveshuri e kuptonte gjuhën e të veshurit, kurse ky s'e kuptonte gjuhën e tjetrit.

Studiuesi i Njeriut, i veshur, i hekurosor, i lyer dhe i ngjyer, si një njeri që xhunglën e sheh me gjyzykë, e pyeti Njeriun:

- Pse nuk visheni?

- Sepse është nxehtë.

- Por, pjesërisht së paku.

- Është nxehtë për të gjitha pjesët.

- Po së paku, pjesët e turpshme.

- Të turpshme? Cilat pjesë, çka është e turpshme?

Atëherë, ai që kishte shkuar ta ndriçonte atë fis, e ndjeu veten në terr. E hoqi shaminë që mbante supeve si pionierët, dhe ia zgjati.

- Merre këtë shami dhe vendose aty ku mendon se duhet të vendoset!

AG APOLLONI

Blloku i Bostonit

Tregime



Njeriu i zhveshur e shikoi dhe nuk diti se ku ta vendoste, por duke ndjekur shembullin e mysafirit, e vendosi supeve, dhe ia nguli sytë vizitorit të veshur. Atëherë, ky, duke u përpjekur t'ia shpjegonte pa e ofenduar, i tha:

- Mbuloje atë pjesë që, ti e di, futet gjithkund!

Atëherë i zhveshuri e kuptoi, e bëri dyfish shaminë, e çoi te fytyra dhe e lidhi pas veshëve.

I veshuri i tha:

- Ti e mbulove hundën. Ajo s'është organ i turpshëm.

- Është hunda ajo që ju evropianët e fusni gjithkund.

Pas pak, ndërsa dielli po ulej pas malit, në dy anë të kundërta po largoheshin njeriu i zhveshur me hundën mbuluar, dhe njeriu i veshur me organin e turpshëm zbuluar.

DEKALOGU I RI

1. Mos iu bind Zotit, njeriut, as djallit! Kush të thotë përkulu, jepja plumb ballit!

2. Ndërroje Hyjin, se ke lindur i lirë! Adhuro statujat, se arti na bën më të mirë!

3. Përdore emrin e Zotit kur i ke punët ngushtë. Kështu i zgjidh do raste që nuk zgjidhen me grusht.

4. E shtuna është e shenjtë, është thënë ngahera. Ti, sa punon kot, shenjtëroi dhe ditët e tjera!

5. Mos i ndero prindërit, se s'kanë asnjë meritë. Ishe i lumtur kur s'ishe, të sollën këtu ku nuk sheh dritë.

6. Vrit, se ndryshe të vrasin! Sa njerëz të kotë ka kjo botë, vriti se ta plasin!

7. Tradheto dhe ngutu sa ke takat! Bëhu i pari, që pastaj kush të tradhton, le të akuzohet për plagjiat.

8. Vidh, se punë është edhe ajo! Dhe punë djerse, jo dosido.

9. Rrej sa të mundesh, me rrenat më të bukura e më të tmerrshme, se krejt ta kanë thënë që kjo dynja është e rrejshme.

10. Duaje gjënë e tjetrit dhe mos u çudit pse livadhi i tjetrit është më i jeshiltë! Kështu kishte shkruar dikush në anën e prapme të pllakës që Mojsiu e hodhi tutje me dëshpërim.

Urdhëresat e tjera ju i dini, s'kam çka me ju thanë. Veç mos harroni që pllaka ka dy anë!

DY MIQ DHE NJË MUZË

Na ishin njëherë dy miq të ngushtë. Muzikantë të dy. Fatmirësisht, kishin një muzë. Fatkeqësisht, muza që frymëzonte të dy, ishte e martuar me njërin prej tyre. Edhe tjetri e donte për vete, por e donte edhe mikun. Dhe ia tha asaj. Ajo e donte burrin, por edhe mikun e tij, tek i cili iku një ditë.

Kur u kthye, vendosi t'i tregojë burrit se kishte nisur lidhjen e re. Ia tha dhe brenda atyre pesë sekondave sa vonoi përgjigja, truri i saj krijoi pesë skena:

ai e pështyu në surrat;

ai bërtiti si i luajtur mendsh;

ai iu afrua dhe e goditi me shuplakë;

ai e kapi për flokësh dhe me një inat prej Akili, e tërhoqi zvarrë dhjetë herë rreth shtëpisë;

ai nuk u çua fare, vetëm hapi sirtarin, nxori revolen dhe shtiu në të.

Pas pesë sekondash, ai pyeti qetë:

- Me kë?

Ajo ia tha. Ai s'vonoi as një sekondë dhe ia ktheu:

- Më mirë me të, se me ndonjë narkoman tjetër.

Muza vazhdoi nga njëri muzikant te tjetri, duke u ndjerë krenare për këngët që ia kushtuan të dy burrat, i riu dhe 'i vjetri'.

MAN IN MAKING

S'ishin Sartri dhe Simona, por ashtu dukeshin dhe ashtu quheshin. Pasi kishin folur për *world in making*, Sartri po lexonte një artikull gazete dhe po pinte një vodka, ndërsa Simona po pinte një gotë verë të kuqe dhe po mendonte për seksin e dytë. Pasi mbaroi leximin, ai ia kaloi gazetën asaj, duke e shënjuar artikullin me gisht. Ajo e mori dhe e lexoi.

Ajo ishte e re dhe e bukur, ai i ri dhe trim. Dhe ishin lidhur para tre vjetësh. Edhe pse kishin ende kujdesin e ndërsjellë dhe intimitetin emocional, mendonin se 'kimia', ose 'poezia' e pasionit mes tyre ishte harxhuar. Artikulli u jepte të drejtë. Për tre vjet (dhe ky ishte maksimumi) harxhohen adrenalina, dopamina dhe oksitocina, domethënë: harxhohet dashuria.

Pas tre vjetësh, ja ku ishin në të njëjtin *pub* ku ishin njoftuar.

Në anën tjetër të banakut, një djalë po e shikonte Simonën me interesim. Sartri e pa, bëri sikur kishte punë, vuri kapelën dhe duke dalë, i tha djalit: nuk është e imja, është e dënuar të jetë e lirë. Dhe doli. Djali iu afrua Simonës, me të cilën pas pak nisën t'i shkëmbejnë lëngjet.

Kur ditën tjetër, Sartri dhe Simona u takuan në një kafe, ajo e pyeti se pse e bëri atë, a mos ishte lodhur nga lidhja, mos nuk e donte më, mos përpiquej ta hiqte qafesh. Pra, pse? Ai ia dha një 'sepse' të çuditshme: sepse e kam lexuar "Confined love". Dhe ia e vuri në tavolinë një libër të trashë me kopertinë të forta.

Ajo nisi ta lexojë, ndërsa ai ia pohonte vetes: ekzistencializmi është humanizëm, dhe humanizmi përsoset nëpërmjet animalizmit.

TEORIA E NGJYRAVE

Filozofi ishte adhurues i madh i Poetit, dhe kur mori ftesën nga idhulli i tij për të bashkëpunuar mbi teorinë e ngjyrave, s'e mendoi dy herë. Sapo arriti në Weimar, shprehu admirimin e tij:

- Është kënaqësi të takoj shkrimtarin më të madh gjerman.

- Më i madhi ndoshta jam, por gjerman sigurisht nuk jam.

Filozofi u habit, dhe habia ishte zanati i tij.

Poeti, që po mbante në dorë një libër pikturë, ia tregoi portretin e Mona Lizës, dhe e pyeti:

- Me cilën ngjyrë është bërë kjo pikturë?

- Me të gjitha, mendoj, - tha Filozofi duke e marrë librin në duar.

- Nëse kjo nuk është vetëm e bardhë, vetëm e zezë, vetëm e kuqe, vetëm e verdhë, apo vetëm blu, si mund të mendosh për mua ashtu?

Me t'i thënë këto fjalë, Poeti kapi brushën, përzejë ngjyrat mbi tavolinë, dhe foli:

- Kombinacioni si akt e zbeh nacionin si fakt.

Në çast, të dyve u qeshën fytyrat dhe së bashku nisën t'i përziejnë ngjyrat.

Shtatëmbëdhjetë vjeçarit Haxhi Allajbogo S iu drodh trupi si shkurre thane në shtrëngatë. Sikur i shkullën zemrën nga vendi. Në krah të djathtë rrinte sup' i varur i zysh Gjylyzarit. Ndjeu një shtrëngim gryke. Njëpër damarë, gjaku i pasionit i erdh' si kryengritje. Nuk e kishte njohur më parë këtë ndjesi. Me kuriozitet prekës, verbuar nga bardhësi e gushës së saj, në moskuptim e ngërç ndjenjash, pyeti veten: mos jam në ëndërr?

Zysh Gjylyzari e kishte thirrur vetë për vallëzim.

Xhoi ..., gati?

Ajo nuk e thërriste Xhike, si gjithë klasa dhe mësuesit e tjerë. «Duhet ta ndërrosh emrin, - i tha njëherë, - unë do të thërras Xhoi, mirë?» Atij i pëlqeu kjo gjë. Emrin Haxhi, Haxhi nuk e kishte honepsur asnjëherë. Emri ishte dhe një nga meritë e tij të mëdha, ndaj të atit. Ky emër i dukej si trashëgimi bastarde që i merrte frymën. Emri i mëkatarit Haxhi. Haxhi Qamili. Dumbabisti i vitit të mbrapshtë. Emri i tij Haxhi bërtiste fort mospajtimin me botën revolucionare, që jetonte. Ishte si në revoltë kundër atij emri që nuk e kishte zgjedhur vetë. Haxhi, Haxhi me atë urë zjarri në dorë, ndihej si i lidhur me Haxhi Qamilin, inkuzitorin e vonuar otoman. Dhe për më tepër që zysh Gjylyzari e shqiptonte me aq embëlsi emrin e pagëzuar: Xhoi.

Ishte mbremja e 7 marsit dhe vitet e treta e të katërta të pedagogjikes bënin mbrëmje vallzimi me mësuesit. Zysh Gjylyzari se si ishte, krejt e veçantë. Jepte letërsi, pasionin e saj dhe në orën e mësimit kërkonte me ngulm pjesëmarrjen direkte të nxënësve. Ajo i ndante në role personazhesh dhe niste leximin, pastaj interpretimin, idetë dhe përjetimet individuale. Njëherë duke spjeguar "Këngët e Milosao" të De Radës, ajo u tha nxënësve, «De Rada e pësoi tek vetja, nuk mundi të lidhej dot me një vajzë bariu fshati. Ky me sa duket u bë dhe shkasi intim i poemës» dhe sytë i hodhi menjëherë nga Xhoi.

E pyeti: - Xhoi si nis kënga e parë?

Haxhi Allajbogo ngeci.

Hap sytë e ruaju, - i tërhoqi vëmendjen.

Pastaj i bëri shenjë Mirjanës, shoqes së bangës. Ajo u ngrit triumfatore dhe çuqurisi fillimin e këngës së parë: Bota kish ndërruar lisa, uji i ri në det...!

Xhoi, - iu drejtua ashpër Xhikes, djaloshit hundëkërrabë, trup e fytyrë gjatovine, veshë lllapush, - Mëso letërsi! Boll bëre shakara. Letërsia do të mbrojë nga ujqërit që të presin përjashta!

Xhoi tundi kokën.

Po a e besoni ju se ky qortim i bëri mirë vërtet? Nisi të lexonte letërsi. Pas çdo leximi shihej në pasqyrë. Nuk e pëlqente veten. Gjylyzari i binte herë pas here libra të rilindjes italiane, të neorealizmit, në konvikt, në orët e studimit mbasditë. Kjo gjë u bë sekret i tyre.

Gjylyzari ishte grua e pamartuar, me bukuri të pjekur, pa shkuar ende tek të pesëdhjetat, me trup lastar. Kishte studiuar letërsi në Romë dhe ishte kthyer pas luftës së dytë botërore në Shqipëri. Jetonte vetëm me nënën e saj plakë. Njëherë në klasë, xhindosur e mërzhitur nga mospërgatitja, ajo shpërtheu: - nëse do të më mendoni një ditë kur të dilni në jetë, kujtoni se unë kam vuajtur e sakrifikuar tepër për të mësuar letërsi në Romë! Ja kështu!

Ishte mars i vitit 1966. Zysh Gjylyzari që vishej thjesht, gjithnjë pantallona dhe pulover me komça, iu afrua më afër Xhoit, aq sa ai ndjeu prekje me trupin e saj. Dy - tri sekonda më pas, Xhoi hodhi padashur një hap të gabuar, që se si u gjend, u ngjesh, midis këmbëve të saj. Ndjesia e lehtë e pritjes dhe pendesës nisi ta torturojë. Ndërkaq tinës, si krejt padashur, pa u parë nga askush, zyshja i vuri dorën midis këmbëve. E preku. Një gjë e madhe, e gjatë, e drejtë, ishte tendosur. Xhoi u kap aq gafil

ODISE KOTE

Gjylyzari

tregim



nga veprimi, prekje e gishtave të saj, sa nuk mundi të bënte dot asgjë. Ishte zënë në kurth, befasisht, nga një akt që aty për aty e perceptoi shpirtshthurje, dhe iu duk se do të përmbysje bota, e rrugëdalje tjetër nuk do të kishte.

E di këngën e kallogresë? - i pëshpërit ajo tek veshi, dhe ai në vend të fjalëve ndjeu aromë të hollë lisi e manxurane. Ajo e di se gjithmonë duhet shpikur diçka, pasi dështimi të tremb. Pa prituri përgjigjen e tij: ncuk, ajo pëshpëriti sërish: "Nga m'erdh te kurmi gjith' ky gëzim? Si e pafaj unë zhvishem te shtrati ..."

Ende nuk kuptohej mirë ku e kishte fjalën zysh Gjylyzari dhe çfarë kuptonte Xhoi nga veprimet e saj? Kishte mbetur pagojë. Memec. Padurimi iu paraprin gjithnjë pandehmave. Çdo të bëhej pas kësaj?

Zysh Gjylyzari pëshpërit: «nesër të pres të më vish në shtëpi. Më sill Dekamereonin. E di shtëpinë apo jo? Në katër e gjysëm».

E kapi një vorbull dehjeje. Fjalët që ajo ia tha shpejt e qartë, Xhoit i ngjanë me një bombë lumturie. E nesërmja, e diela, erdhi si me përtesë. Xhoi shkoi në sheshin e ishkinemasë së vjetër, në sokakun që ngjitej për tek shtëpia e saj, qysh në orën tre. Pritja ka kodet e veta të durimit. Shkonte, vinte pa e ditur se çdo të ndodhte në atë drejtë shtëpie. Siç tha me vonë Gjylyzari, edhe ajo rrinte në përgjim, në penxheren e mbipatit, skajit të mesores, nga ku dukej sokaku hollak përposh, si gjarpër. Shteti por dhe qyteti i gurtë, ndonëse i hutuar nga rrjedha e kohës, kishin pak vite që kishin dalë nga lufta dhe furia revolucionare, bashkë me dënimet, ndëshkimet, fletë - rrufetë, dridhej nga spionët që ishin bërë si milingonat e gëlonin në çdo cep. Ajo e pikasi Xhoin diku në orën 4 e 10 minuta dhe doli shpejt të blinte diçka në dyqanin e lagjes. Në kthim i ra nga sheshi i ishkinemasë së vjetër, duke i bërë shenjë atij ta ndiqte pas. U ngjit në një rrugicë të ngushtë e të pjerrët, veshur me bimë kacavjerrëse e sarmaçe nga të dy anët, dhe mu afër majës, befas u shfaq një portë e vjetër guri. Ajo priti sa hyri dhe Xhoi, pastaj i vuri llozin. Shtëpia qe e lartë, madhështore, me obror e bashkina rreth e rrotull. Ata u ngjitën shpejt nëpër shkallët hyrëse dhe Gjylyzari e mbylli sërish portën e brendshme me lloz e çelës. Mori frymë lirisht. Shkimi i saj ato çaste ishte kombinim i frikës dhe shpresës për siguri e privatësi. Në nëndivan, ajo futi kokën në kthinën majtas dhe i foli nënës që dergjej e sëmure në shtrat: mama, erdhi Xhoi dhe do të ngjitemi lart. Do të merremi me zbërthimin e disa tezave të provimit.

Nëna që s'ngrihej dot, tundi kokën e kënaqur, kur vuri që edhe mangalli ishte mbushur me prushe te rinj.

Ngjitemi, - tha ajo, e sigurt që askush nuk i kishte parë dhe Xhoi do ta ndiqte pas i bindur. Ashtu ndodhi. Nxituan të dy dhe shumë shpejt u gjendën të ulur në minderet e patit të sipërm, kat i tretë, apo qiellzana siç e quan Gjylyzari. Xhoi vuri zemërdridhur këmbën mbi këmbë, kryqëzoi duart midis gjunjëve dhe priti, ndërsa Gjylyzari e paduruar, solli shpejt tabakanë me dy gota rakie, arra të qëruara dhe gliko ftoi, të ruajtur freskët në sterë. E qerasi. Xhoi mori i turpëruar diçka.

Gjylyzari ngrihet, se nga futet në një ndarëse, dhe vjen si erë, veshur me një robdishamër të gjatë ngjyrë vishnje. Ngjante me zonjë të madhe, princeshë. Trupi i saj ishte një ftesë. Ai robdishamër nuk ishte as liri e tepruar, as shturje, por një lakuriqësi e lakuriqtë, e fisme, e pastër, nga ato që shitojnë një burrë.

Afrohu pak, - e ftoi ajo tek dritarja.

Ai u afrua drojtur.

I shikon ato dy pemë të mëdha kurorëbardha? - dhe i afroi kokën.

Ato atje përposh?

Xixellonjat mblidhen aty, - mermëriti ajo. Quhen pemët e çiftezim. Xixellonjat femra lëshojnë tetë dritësime dredhore të shkurtëra. Është thirrja për maskullin. Xixellonjat meshkuj lëshojnë dritësime të gjata deri në aktin final të çiftezim, pa kushte e pa paragjykime.

Jo oooo ...

Nuk mendon se ka ardhur koha?

Xhoi uli sytë me turp.

Ajo e rrëmbëu, pa prituri përgjigje, brenda robdishamërit të saj. Nuk i erdhi ndërmend asgjë që mund ta ndalonte. Puthjet mbuluan fytyrën, gushën, qafën. Ato përputhnin ritmin e dihatjes të tokës së zhuritur nga thatësira me ujin e akullit të kataraktit, ujë dëbore mali që binte e shponte parreshtur mbi sipërfaqen e thatë. Egër.

E zhveshi me shpejtësi dhe duart e saj zbritën poshtë. E kapi atë që një ditë më parë, vetëm sa e kishte prekur dhe që ajo i vuri nofkën «trimi». Ishte i madh, i bëshëm, i fortë, i tillë që nderonte çdo burrë namuzli. Trupi i saj i ngjeshur, plot energji, e kërkonte. Lëshonte si erë suferine rënkime e dënesje të forta.

E priste.

Gjylyzari e futi me duart e saj aty, tek vulva, brenda asaj luleshtrydheje që njerëzimi i ka kënduar këngë e ode për mijëra vjet, në atë tunel përmes të cilit kanë

kaluar jo vetëm gjeneratat, por dhe politika, ekonomia e luftërat.

Xhoi ndjeu lagështirën e uritur epshore të vulvës dhe penetroi. Si të ishte dem i ri.

E godiste papushim. Vazhdoi disa herë penetrimin, atë dialog dhe lojë, sikur dëshironte të zbulonte të gjitha skutat e mistershme të saj, ulje - ngritjet, deri tek shpërthimet e fshehta e të zhurmshme.

Dhe me pas ra përmbys, në një pushim delikat.

Gjylyzari u ngrit e para. Shkoi me hapa të shpejtë në sergjen të enëve dhe solli një tabaka me embëlsirë dhe ujë të ftohtë pusi.

Ah, se harrova, - ajo ka pamje të d'lire si një zanë dhe i tunden leshrat e lëshuara prej afsheve, - kam bërë kek me mollë e stafidhe rrushi.

Ai tund kokën.

Ajo e ushqen dhe ai ha diçka.

Por Xhoi ka uri për tjetër gjë. Djega e epshës i bëhet e padurueshme.

E puth në gushë, e mbështjell me krahët e tij të njomë, i shtrëngon të pasmet e saj, dhe ato ndihen sikur duan të ngjiten në qiell. Bashkë me trupin.

Gjylyzarit i kujtohet si në ëndërr Gijom Apolinieri, poeti e shkrimtari francez i lindur në Itali. Poema e tij për nëntë portat e trupit të gruas, shkruar në maj të 1915 - tës, ishte dhuratë e çmuar për dy të dashurat e tij, ndërsa ai luftonte në llogore, nën qiellin e gjyleve.

Duart e Xhoit nuk ndaleshin së fërkuari të pasmet e Gjylyzarit dhe ajo solli sërish ndërmend portën më intime, siç e quante Apolinieri.

Po sikur...?

Zgjati duart pas, e kapi fort krenarinë maskullore të djaloshit, «trimin», dhe nisi ta lëvizë vrullshëm midis të pasmeve. Pastaj e ndali lart, tek porta e sipërme, ajo më intimia, duke i thirrur me zë ulkonje: - tani jepi. Fute brenda!

Këtu?

Po aty.

Dhe Xhoi e depërtoi ngadalë. Pastaj më fort. Thellë. Deri në pafundësi.

Gjylyzari mbylli sytë, solli ndërmend kurorat e bardha të luleve të pemëve, duke shijuar hareshëm këtë urtësi Apolinieriane, e gatshme t'i bindej çdo teke të Xhoit. Ai shtynte fort përpara dhe ajo gulçonte si ulkonjë, duke ndërë shpirtin t'i ngjitej në qiellin e shtatë.

Sa kohë kishte duruar e prituri këtë çast?

Për herë të parë, që nga koha e kthimit absurd në Shqipëri, pas luftës, ajo ishte ashtu siç donte të ishte vetë dhe jo ashtu siç i thoshin se duhej të bëhej. Të gjithë, në shkollë, në lagje, rreth e rrotull, çuditshëm, jetonin me dëshirë brenda gënjeshtrës. Ç'ishte ajo flamë?

Ajo nuk dëshironte të ishte njeriu i ri, njeriu pezull. Nuk donte të ishte asgjë. Numër. Turmë. Donte të ishte e ndryshme.

Vetvetja.

Ajo e ndjente që kontrolli absolut mbi këdo e gjithçka ishte metafora e rregjimit të ri. Rregjimi komunist nxiste asgjënë, humbjen, uniformitetin karakterial, këtë shkatërrim që po bëhej trashëgimia, simbolika e tyre.

Ata nuk e kuptonin se ai ishte rrënimi.

Rrënimi që rrefente rënien e më të shtrenjtës gjë, lirisë në besimin e njeriut, më të qënësishmen e të gjithë vlerave.

Xhoi bëri dhe një sforcim të fundit dhe pastaj u shkreh. Kushedi sa lëng të trashë jetëdhënës i dhuroi asaj porte apolinieriane.

Ajo e ndjeu se si "trimi" u tërhoq me kujdes prej saj. Xhoi e ktheu Gjylyzarin me fytyrën përballë. E puthi fort në buzë. Sytë e saj ishin të tejdukshëm, të embël.

Duke buzëqeshur i thotë: sa u lodh "trimi"? Bëri një orë brenda meje.

Dhe qeshi e lumtur. Njeriu ka shumë dashuri të para në jetë. Ato të gjitha ashtu mbeten. Natyra dhe seksi janë të pakohë.

Qenia dhe dhimbja universale e të jetuarit, toka e vrazhdët e njeriut dhe shpirti si trishtim i përhershëm, janë fushat poetike të Fernando Pessa-as. Është një lëndë e jargavantë plot mistere poetike. E fshehur thellë e tutje në muzgje labirinthesh, ku lexuesi herë humbet nëpër hane e herë del në pllaja me diell.

POEZIA KLITHMË EKZISTENCIALE

Gjithmonë i zymtë qe poeti. Si monument i dëshpërimit. Neveri dhe maska, hipokrizi dhe boshllëk shikonte gjithandej. "E ndiej se si kjo botë e pandreqshme/është thjesht një vis ku lehin qentë." Dhe mbledhje në vetvete krejtësisht i trishtuar. Përqafuar me një demon të zi që herë e çonte te qenia që po shkatërrohej si një tokë me erozion të njerëzor, aq sa të krijohet përshtypja se ky poet nuk mund të qenia dhe shpirti, kujtimet dhe ëndrrat, netët dhe dëshirat, sendet dhe hijet, objektet dhe imazhet, realitetet dhe përfytyrimet në një dramë të përhershme – tek secila e tek të gjitha, poeti rri varur skajesh, apo midis duke kërkuar me dhimbje një vetvete ose një të vërtetë. "Larg meje brenda vetes gjalloj/veçmas atij që jam." Pessa-a krijoi një poezi të çuditshme, mbushur me mister e terr të zi; ai lëroi fushën e pamatë të natës së tij si në natën e njerzimit, ku mbillte kufomën e vet vdekatare, ku shpirti i tij si shpend i zi plagosur, çoroditur e humbur nëpër mjegulla, gjen vetëm gjurmë, hije e shenja e, befas, bije në hon duke lënë pas një klithmë të thiktë ekzistenciale...


I tillë është ai në çdo hap të jetës s tij. Dh e në dashuri që: "e përfytyroj dhe bëhem fortë si pemë e larta./ Por nëse e shoh dridhem/ Nuk di se çfarë është ajo/ që ndiej në mungesën e saj. /Vetja ime e çdo forcë më braktis/ Gjithë realiteti më vështron si një ledielli / me fytyrën e saj në mes!"

Ai, poeti që vizaton vetveten e padukshme, sepse me të bardhë mbi të bardhë, të lbyr sytë e nuk e shikon dot sy më sy; ai është një shpirt i padeshifrueshëm "që përhumb brenda shpirtit tënd", ndiesi e zbrastë, uri pa endje për të ngrënë, pakënaqësi e përhershme e një shpirti vulosur që në lindje me dëshpërim.

E seç ka përbrenda tij diçka nga perënditë, seç ka një dhimbje universale që të mbërthen në kryq. Pessa-a nuk e ndien por e analizon dhimbjen, më tepër se zemra i këndon truri, e kështu dashur padashur poeti alternohet me filozofin paksa, për t'ia lënë vendin përsëri poetit. "Ndjenjat e mia janë gjurmë /tek unë vetëm mendimi ndien." Kështu intelektual i ngrihet mbi shkruante dot pa qenë i trishtuar. "Përveç mërzi- thoshte –çdo gjë më mërzi". Ai, një gjendje e trazuar shpirtërore që nuk u bindej rregullave, etikës e shkakpasojave të zakonshme. Ai thërriste një re të terrët t'i qasej nga jashtë, priste zhgënjimin e bukur melankolik, muzikën e trishtë të shpirtit... Dhe urat rrethrotull kështjellës së shpirtit të tij, gjithmonë i kish të përmbytura. përditshëm e " herë te kalbësimi i shpirtit, ankth i asaj që pandehja se isha..." Tek Pessa-a ndahen, alternohen, njësohen vazhdimisht intensitetin e ndjenjave duke preferuar të krijojë një emocion abstrakt që duhet ta perceptosh e ta zbulosh kur, " prej yjeve nata zë e ftohet", si një gjerdan i varur në qiell me rrëzëllime rubinësh të akullt që pikojnë lot. Ai është një organizëm poetik, mbujtur me zëra të brendshëm, klithmë e çuditshme që mbetet përherë në ajër si një gjurmë shpendi që sapo u zhduk. "Ma ka ënda të ulërij brenda kokës sime", e atje brenda kokës regjistruar në një disk planetar i dukej se kish të gjitha ulërimat e botës por...ai donte ta ndalonte atë disk ulëritës, por shpirti i tij kumbonte më tepër, trishtueshëm; ai donte ta ndalonte shpirtin të udhëtonte me të por..., pse qenia dhe shpirti të jenë bashkë por ...,ai kërkonte shtigje ku të mos kishin fluturuar zogj të tjerë por..., por kudo e kurdoherë përplasej me pamundësinë. Dhe pamundësisë i këndonte. "Unë jam notat e shkërmoqura

Fernando Pessoa diamanti me shkëlqim të fshehtë

Nga Pirro Loli (Mjeshtër i madh)



në kumbime të pafundme, në atë pianon e ndyrë të kujtesës vetiake." Poet misterioz. Ç'organizëm je ti? Ç' e shkuar a e ardhme je? Ç' natë të përhershme ke në sy? Ç' e ke atë erë të mynxyrshme që të than e të përzhit lulet e zemrës së venitur?...Nuk pres përgjigje " Ashtu si Kafka ai vuan vetminë pikëllimtare, lodhjen dhe sflitjen metafizike të një ekzistence damkosur me vulën e dëshpërimit"(Lemaire)...

Ai, i heshturi si varri, i padukshmi si ajri, që erdhi si një UFO, që dikush e pa nga larg por...kur u duk diku në një ceremonial madhor në varrezat kombëtare të Portugalisë, në krah të Vasko de Gamës e Camoes, ai Françesko Pessa-as, shpejt u ngrit si fantazmë e krahëhapur qëndron në qiellin poetik të Evropës. E qaset si një bashkëkohës i përhershëm modern, si një e vërtetë poetike e pa eksploruar, një e vërtetë brenda tij, si mekanizëm që dyshon dhe beson; vetëm tek ai subjekti poetik, që prodhon realitete "made in Pessa-a" Të ecësh më tej drejt të vërtetës së tij poetike futesh në labirinte. Duhet të vdiste që të njihej. Mijëra vargje të tij që po botohen pas vdekjes, me ese, libra kritike e estetike(rreth 20 vëllime deri tani) janë kryevepra bashkëkohore, por siç shprehet vetë ai dhe kritika, asnjë nuk e çoi në zbulimin e së vërtetës së qenies së tij. Cila është vetvetja e poetit? Ç' masë, e formë, ç' lëndë a shpirt e përbën atë? Është një e vërtetë që nuk dihet, ku ta kërkosh brenda qenies apo jashtë saj? Është tek unë apo te Hyjnia? Askush nuk të përgjigjet. As ai vetë. Por, ama, Pessa-a, nuk e fsheh këtë /dështim ekzistencial/ ku "kundroj i patrazuar kufomëzimin e qenies sime"...ku, "zemra m'u thërrmua/porsi copë qelqi/deshi të jetonte /por u mashtrua..... E gjithë krijimtaria e tij ka lënë pas një mesazh që duhet lexuar e kuptuar me kujdes në pamundësi për të dalë nga këto enigma, pra nga labirinthet e vetvetes, atëherë qëndro atje, eksploro vetveten, gërmo atje! Me barominë dhe me gjilpërë. Kokëposhtë. Në terr. Dhe mos kërk

t'i ikësh vetvetes, ajo, matanë shtigjeve, ka një hapësirë diellore të pafund, ka një thellësi deti të pacak, ka një lartësi të kaltër qiellore, hapësirën e ëndrrave. Kjo është poezia e tij, fillim e fund. Dhe si në çdo gjë të pafund e ireale, mos prit stacione festash e fitoresh. Pessa-a deshi të ishte magji e ligjërimit, por fjetet e ëndjes i kish në dorë Krijuesi i Madh, "Unë jam i dështuar në gjithçka", deshi të ishte i ploti, pagan e kristian, intelektual e fshatar, banor i kullës së fildishtë e veprimtar por...e çuditshme (!) as përkon me vetveten, as të bëhet tjetër, ai, mbeti një heshtje e varur midis...E kështu në përpjekje të dal nga labirinthi që më ngrë poezia e tij, qetësohem kur më thotë se e vërteta poetike nuk është as bota e brendshme, as ajo e jashtme, por një përbrendësi e pafund, që, gjithashtu është një e përtejme e paskaj. Si pafundësia. Si e pamundura. Si e panjohura. Dhe unë e besoj. Bashkohem me të. Doktrina e poetit nuk është "Alaska", pika e mbërritjes, por ajo pika e vogël e startit kur nisët, udhëtimi metafizik drejt dramës së përhershme, gjetjes së asaj forme ku nocioni poetik i pafundësisë kthehet në një udhëtim dramatik drejt parajsës...

Nuk dihet se ç'kanë brenda humbellat e Pessa-as, ëngjell ndriçus apo një djall të zi. Veçse, sa herë niste për të vëzhguar përbrenda, ëngjellin apo djallin, aq më e zymtë i dukej vetvetja. Ky pozicion mesi, kë të shoh, ëngjellin apo djallin, është një dhimbje e qenies ontologjike që poeti e lëndëzon në poezi, në një poezi të paimitueshme, trishtuese natyrisht, por larg pasionit romantik, larg mërzi-së bodleriane, depresionit kafkian a dekadencës valeriane. Ndoshta pak nga të gjitha dhimbjet e poetëve, ngrihet monumenti i dhimbjes universale ku çdo njeri nuk mund të largohet pa e nderur qiririn e vetvetes. dhe ajo drama e përhershme e tij,- ëndrrës, pemës dhe vegimit

për pemën,... ashtu midis asaj çka jam e asaj çka ëndërroj, ashtu, as natyrë e pastër, as metafizikë njerëzore, ashtu tek vëzhgon nga dritarja e tij "Duhantoren" përballë, e përfytyron që nga sendet e rëndomtë në rrugë deri te punët e shpirtit, planetit e të galaktikave, kotësinë e reklamave të duhantores të njëjtë me kotësinë e vargjeve të tij... dhe "gjithçka është ëndërr si një gjë reale e parë nga brenda" ...gjithsesi një realitet që buron nga koka ... e ai poetizon për një ndërgjegje të ngrirë, për një ngecje në marrëdhënie me të tjerët, gjithmonë "nga një hon i zymtë i një muzgu të brendshëm "tek i cili e ndiej se po ëndërroj/ çka ma do zemra se jam

POEZIA MISTER

Por poezia e Pessa-s, ndërsa gjithmonë ka diçka misterioze, nuk ka sekret se si ngjizet, si lind e si sajohet. Si çdo embrion. Vetë autori dhe kritika i kanë zbardhur të gjitha kolonat e procesit të tij krijues. Ja direkt poeti : Ai ecte në një rrugë dhe nuk e dinte se ajo rrugë ekzistonte.. Shikonte suprinën e një liqeni ku fryn era dhe përfytyron një ballë poeti ku drithërohen rrudhat... Shkon të marrë bukën në furrën e lagjes e me sy sheh furrën e fëmijërisë, një bukë të dikurshme, një dritë të çuditshme përrallash, me zana e shtojzavalle...Ai dëgjon një muzikë e kjo "e trishta e bukur", i kujton fëmijërinë, një top llastiku te muri i kopshtit, një qen të gjelbërt a një kalë të kaltërt... Dhe një dëshpërim në zemër, një vajtim universal se gjithçka e bukur po tretet, po harrohet , po jep shpirt dhe natyra dhe miqësia...e një fatalitetet i egër, njëlloj, sendet e duhantores dhe vargjet e mia.. një kot universal.. E prandaj realiteti i pamundësia për të jetuar ndjenjën njerëzore, gurgullimën emocionale të njeriut.. Dhe ashtu midis gjumit dhe tij poetik është ëndrra, tjetërsimi. Vetëdija e tij mjegullore shquan shenjat por nuk i përgjigjet dot asgjëje të



dukshme. Ai nuk sheh atë që shkruan, jo atë që do ti, por fëmininë, dhe përrallat, dhe virgjërinë dhe pemën dhe përfytyrimet e tij. Ai bashkon të kundërtat (figura stilistike oksimora), konkretën me abstrakten, majën dhe humnerën, virtytin dhe vesin, qenien dhe shpirtin, Krishtin dhe satananë. Mjeshtëria e tij: "Një sistem figurash që kanë për funksion të shpalojnë kuptimin e fshehur të gjithçkaje" (Brecht) Deviza e tij: (që mund t'u shërbejnë dhe poetëve të tjerë që duan të bëjnë poezi), në jetën e përditshme, poeti është një kalimtar anonim i pavlerë, ... ai jeton "me ankthet e ëndrrave të tij, pa pikë gjumi në sy". Dhe ata, të lindurit gjenij si Rembo apo Pessoa-s, bëhen viktime të ndjenjave të një realiteti total të vetvetes dhe të botës – një farë neuroze poetike kjo, që lind nga një vetë ndijësim i pazakontë e që, jo rrallë u merr jetën të zotëve, sepse e kanë kryer para kohe misionin e tyre hyjnor. Ata vdesin para dite, pa pritur orën 12 të kumbojë kambana... Dhe lënë ca zëra në ajër si urti për krijuesit: Hiq dorë nga realiteti i gjërave dhe vrapo pas vetëdijes së misterit... E mijëra poetë, kritikë e estetë kanë qenë të detyruar ta dëgjojnë këtë zë që ka ngjizur kryevepra në letërsinë moderne.. dhe që sot nuk habitet njeri me urtësinë agresive që na la pas: "Arti na çliron në mënyrë mashtruese nga ajo gjë e ndyrë që është fakti i të ekzistuarit...

POETI NË NUMRIN SHUMËS

Pessoa është një rast i pa precedentë dhe për diçka tjetër. Ai është poet në numrin shumë. Disa poetë brenda kafkës së tij, flasin me gojën e tij duke qenë të ndryshëm. Me këtë shpikje të heteronimëve, ai ndërtoi një univers të çuditshëm letrar. Nuk është fjala në pseudonimet që i përdorin të gjithë, ai përbën një shumësi poetësh tek vetvetja, të gjithë të talentuar e të ndryshëm, "por në sytë e tij më të vërtetë se ai" (E. Lurencio). Katër poetë bashkë brenda një lëkure, por të katër ndahen nga njeri tjetri pambarimisht, për t'u bashkuar përsëri tek emri më i panjohur se secili prej tyre në gjallje: "Fernando Pessoa-a". Sepse kulla poetike e tij, shumë kate padyshim, i mbante të gjitha dritaret hapur, të gjitha korentet e poezisë, hareshin, grindeshin e kryqëzoheshin. Ëndrra e metafizika moderne, tjetërsimi i gjendjeve njerëzore, këtu kritika e së vërtetës, atje ndijimi ku thelbi përkon me dukjen, ku përhumbet nëvetëdija, më tej një e vërtetë kozmike e, e..., të gjitha në mjegull. Në ballin e tij poetik lëvizin të gjithë poetët modernë si erë e shqetësuar kalimtare, por që secili lë një të thelluar në ballin e poezisë. Ai i njuh të gjithë, i prek, i përqafon, dhe nuk do të jetë asnjë prej tyre... Ndoshta nisi nga udha e Bodlerit drejt surrelizmit, bashkohet udhës me një grup korifejsh botërorë me vetëdije kritike e dyshuese për një estetikë të re si Poe, Malarme, Valery, Pound, Prust, Borges... Hidhet te poetët rebelë ose "zjarr vjedhës" si Halderlin, Niçe, Rimbaud, Uitman, Rilke... provon dëshitim e gjetjes të së vërtetës absolute si Gilbert e përfundimisht fshihet nën pelerinën misterioze të F.Kafkës për të mbetur tek vetvetja me emrin "Fernando Pessoa-a". Ai, diamant i poezisë, që e fshehu ndriçimin e vet mbollit një fushë me gjerdanë i shpërndau andej këndeve dhe i mbuloi me baltë, i hodhi dhe lart si fishek zjarre dhe iu shndërruan në re të ndezura... I bindur se lavdia në kuptimin antik nuk do t'i jepej në gjallje, i bindur se "një mediokër e fiton lavdinë, një gjeni i madh mbetet i panjohur, tjetrin e mbyl dëshpërimi, një Krisht gozhdohet në kryq"... Të tjerët, pas vdekjes së tij, gjatë plugimit në qiellin e poezisë diçka zbulojnë. (Është një rast i rrallë ndër poetët që para se të vdiste F. Pessoa në një baule të mbyllur la me mijëra faqe dorëshkrime si një thesar që nuk po mbaron së eksploruari) ..Dhe mundohen të gjithë ta zbardhin atë qiell të mbjellë me yje. Të ndritshëm e misteriozë. Që pas vetes duket sikur fshehin rubinë diamantesh me ndriçime të pazbuluara.

ENVER KUSHI

Rrëfime në kohë pa kohë



I

Në netët pa drita të kryeqytetit shqiptar, Nivecanërisht ata që vinë për herë të parë këtu dhe që nuk njohin rrugët, u ndodh shpesh ta shohin veten befas në ndonjë parcelë varrezë, që rëndom i gjen jo vetëm në qendër, por thuajse edhe në çdo lagje.

II

Endërsa binte muzgu, vura re se si ata Emblodhën veglat e punës dhe litarët e përbaltur, pastaj se si u futën në kthinën e tyre të vogël dhe se si më pas, njëri prej tyre doli duke ecur me hapa të gjatë nëpër parcelën e përbaltur, sikur kërkonte diçka të humbur. I ulur në një nga tavolinat e papastruara të qebabtores, ku të mbyste tymi i qofteve që piqeshin në prush dhe duhma e rëndë e rakisë, vështroja me ankth se si matanë xhamave, lëviznin si në jerm hijet e tyre. Mos e dhëntë Zoti, thashë me vete. Mos e dhëntë Zoti të vinë këtu. Dhe në ato çaste, ndërsa zhurmat e qebabtores, u përzien me fjalët në arabisht të hoxhës, që vinin nga minareja e xhamisë së madhe, mallkova kryeredaktorin që kishte ngulur këmbë për ardhjen time këtu e që priste me padurim reportazhin për një nga kryeqytetet më të çuditshëm të Ballkanit. Kur zëri i hoxhës nuk u dëgjua më, atëherë më pushtoi diçka përtej frikës: ata, varrëmihësit e përbaltur, do të hynin në qebabtoresh me tym dhe do të urdhëronin që unë të dilja jashtë. Dhe kur unë të dilja jashtë, ata do të më kapnin nga këmbët dhe koka dhe qetë-qetë, pasi të më fusnin në gropën e thellë që quhet varr, do të më mbulonin me dheun e kuq, përzier me gurralecë.

... Këto që po dëshmoj në këto shënime, larg çdo fantazie letrare, më kanë ndodhur në Ballkan ose më saktë në Tiranë, që është kryeqyteti më i ri i Europës, atje ku jetën dhe vdekjen i pashë të bashkëjetonin.

III

Kryeqyteti shqiptar të befason me Kmalin e Dajtit, kopshtet e shumta me

hurma e fiq, qetësinë si dhe varrezat. Këto të fundit shfaqen befasisht jo vetëm në qendër, por edhe mes lagjeve të banuara. Vura re se vendasve kjo gjë nuk u bënte asnjë përshtypje, ndërsa mua më dukej sikur hijet e të vdekurve shëtisnin qetësisht me të gjallët dhe kur këta të fundit uleshin nëpër kafenetë e zhurmshme, ftonin në tavolina për të pirë kafe e për të biseduar për jetën e përtëjvartit, miqtë e tyre: të vdekurit...

IV

Ju bëj me dije, në vazhdim të raportit që i ju përcolla dy javë më parë, se Kryetari i Shtetit Shqiptar më priti me nderime të veçanta dhe pas përshëndetjeve të rastit, më pyeti se ç'përshtypje kisha për kryeqytetin e vendit të tij. I thashë se këtu mali, fusha, erërat që vinin nga deti si dhe mikpritja, Perëndia e kishte dhënë me bollëk. Pastaj pata guximin t'i sugjeroja Kryetarit të Shtetit se do të ishte në nderin e Shkëlqesisë së Tij, që në një kohë sa më të shpejtë, të largonte vdekjen nga kryeqyteti.

Ai pasi buzëqeshi me xhentilencë, u ngrit në këmbë dhe hapi perden e dritares së madhe të rezidencës qeveritare. U ngrita edhe unë dhe Ju raportoj se pamja matanë xhamave ishte tronditëse: në parcelën e varrezës që ndodhej jo më shumë se pesëdhjetë metra larg, pashë të ulur dhjetëra njerëz me pëllëmbët e shtrira përpara, ndërsa një hoxhë i gjatë këndonte lutjet arabisht. Duke larguar vështrimin nga ajo ceremoni varrimi, ju luta Shkëlqesisë së Tij të ulte menjëherë perden, sepse pamje të tilla më shqetësonin. Dhe kur ne u ulëm përballë njëri-tjetrit dhe Ai vuri re siç duket fytyrën time të verdhë, më tha se pija që kisha përpara quhej raki e se një gotë prej saj do të më qetësonte menjëherë. E ktheva menjëherë gotën e vogël dhe lëngu çudibërës, pas disa çastesh, më krijoi një gjendje turbullire, shoqëruar me eufori.

Në fund të këtij raporti të shkurtër, ju bëj me dije se Kryetari i Shtetit Shqiptar shprehur jo vetëm kënaqësinë për takimin tonë të parë, respektin për popullin tonë dhe Shkëlqesinë Tuaj, por edhe mirëkuptim të

plotë për propozimin e bërë nga ana ime.

Duke përfunduar, bashkë me konsideratën time të lartë për Ju, shpreh bindjen se shumë shpejt kryeqyteti shqiptar do t'i zhvendosë varrezat e shumta që shtrihen kudo si ankth, në një vend të përshtatshëm diku në periferi të tij.

V

Në vazhdim të informacioneve të dërguara më parë, për shtimin e pacientëve në pavionin e psikiatrisë të spitalit 5, ju bëjmë me dije se mosha mesatare e tyre është nga 25 deri 40 vjeç. Ditët e fundit kemi patur edhe dy raste të moshës 17 vjeçare. Të gjithë pacientët janë banorë të pallateve parafabrikat, ndërtuar në vendin e quajtur "Varri i Bamit". Nënvizojmë se 80 % e pacientëve banojnë në katet e parë të pallateve. Komisioni i përbërë nga mjekët më të mirë psikiatër të këtij spitali, thuajse të gjithë pacientët ka konstatuar siptoma të theksuara të pagjumësisë; maktheve, halucinacioneve auditive, si zëra që u flasin atyre në emër, kërcënime urdhëra, trokitje në dritare e dyer etj. Dy gra të moshës 35 vjeçare u shtruan menjëherë. Ato janë të mbyllura në dhomat e sigurisë së lartë. Në fund ju bëjmë me dije edhe konkluzionin e organizatës – bazë të Partisë së Spitalit 5: armiku i klasës ka përhapur psikozën e frikës tek banorët e lagjes "Varri i Bamit".

VI

- A do pllaka varri zotni?
- Pllaka varri?!
- Po zotni. Pllaka varri.
- Ju shisni pllaka varri?
- Nuk i shes zotni. Janë falas. Nuk e keni dëgjuar njoftimin në televizor?

VII

Në periferi të kryeqytetit shqiptar, në kodrat në perëndim të tij, u zbulua nga një fshatar një varr masiv. Mendohet se atje janë varrosur të pushkatuarit e vitit 1951.

Në orët e para të ditës së sotme, nga Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, u hoqën eshtrat e diktatorit Enver Hoxha dhe të bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë.

Familjarët prej ditësh janë duke kërkuar në kodrat e buta rrëzë malit të Dajtit eshtrat e ish-gjeneralëve.

Ceremoni madhështore në Shkodër, Korçë dhe Tiranë për rivarrosjen e eshtrave të nacionalistëve të shquar.

Gjendet varri i ish-Kryeministrit Mehmet Shehu.

VIII

Kudo në kryeqytet janë hapur shërbime funerale. Ato u garantojnë qytetarëve të Tiranës të gjitha shërbimet për në banesën e fundit: arkivolë bashkëkohorë me ftohje, kurora me lule të freskëta, autobuzë komodë, kaseta me muzikë funebre si dhe kaseta me vaje popullore të Jugut dhe Veriut të Shqipërisë. Paraqitimi në çdo kohë pranë shërbimeve funerale "Dea", "Shpresa", "Mani", "Sokoli", "Duda", "Perla", "Tibos", "Arba", "Agimi", Ne ju shërbejmë "Non Stop" dhe me kulturë.

IX

Dalin pronarët e tokës në varrezat e Sharrës. Kryeqytetasit kërcënohen të mbeten pavarrosur.

Shesim tokë për varreza private...

Vetat e dramës:

Guido Bardi, një princ fiorentinas

Simone, një tregtar

Bianca, gruaja e tregtarit Simone

Ngjarjet zhvillohen në Firence, në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë.

(Dera hapet, ata ndahen si në faj. I pari hyn burri.)

SIMONE: Grua e dashur, ti vjen ngadalë; S'do të ishte më mirë t'vrapoje, T'i dilje përpara të zotit tënd? Merre mantelin tim. Merr dhe trastën. Është e rëndë. S'kam shitur asgjë. Veç një robe djalit t'kardinalit, Që shpreson ta veshë kur ky t'vdesë, Dhe që kjo të ndodhë sa më shpejtë.

Po ky kush është? Na paske sjellë këtu ndonjë mik, Apo ndonjë të afërm padyshim, T'porsakthyer nga vise t'largëta, E të rënë mbi n'shtëpi pa pritës? Ndjesë o farefis. Pasi shtëpia pa mikpritësin, Nuk është veçse një gjë e zbrazët, Posi një kupë pa verën e saj, Një këllëf pa çelik në ta mbaj' drejt, Një kopsht pa lule, ve nga dielli. Edhe një herë të kërkoj ndjesë, O kushuriri im kaq i ëmbël.

BIANCA: Nuk është as kushuri, as farefis.

SIMONE: As farefisni e as kushuri! Ti më çudit. Kush është atëherë ky njeri, I cili me kaq hir t'largëta fisnik, Zgjedh të pranohet mikpritjet tona?

GUIDO: Emri im është Guido Bardi.

SIMONE: Çfarë! Djali i Lordit të madh t'Fiances, Kullat e errëta të së cilit, Si hije veshur me argjend' hënor, Un' shoh prej dritareve çdo mbrëmje! O lordi ynë Guido Bardi, Ju jeni i mirëpritur këtu, Dyfish i mirëpritur. Pasi ja kam besën gruas sime, Mëse të sinqertë, Ndonëse e pakëndshme për syrin, Mos ju lodhë me biseda t'kota, Siç është dhe zakoni i grave.

GUIDO: Zonja juaj e hijshme, Bukuria e së cilës zbeh yjet, Dhe arrin të rrëmbetë dritën prej, Gjithë shigjetave të Dianës, Më ka pritur me aq mirësjellje, Sa në do t'u kënaqte ju të dy, Do të vija më shpesh n'shtëpinë tuaj. Dhe kur puna t'u bëj t'largoheni, Do të vi të zbeh vetminë e saj, Që ajo mos shqet'sohet shumë për ju. Si thua, o Simone i mbarë?

SIMONE: Imzot, ti më sjell një nder aq t'largëta, Sa gjuha ime, lidhur si skllavi, Nuk mund ta shprehë dot atë që do. Megjithatë, mos t'falenderoja, Do t'ishte shumë e paedukatë. Prandaj, nga zemra të falenderoj. Janë pikërisht gjëra si këto, Ardhet e një princi aq të fisëm, Dhe me një sjellje aq fort të hijshme, Sa e bën t'harrojë padrejtësitë, E t'vijë n'shtëpinë e borgjezit, Ashtu si do t'bente një mik i vërtetë, Të cilat e thurin një shtet së bashku.

E megjithatë, Imzot, Druhem se do të flas tepër hapur. Një natë tjetër ne do t'besojmë, Se ke për të ardhur këtu si mik; Ndërsa sot, duhet t'kesh ardhur të blesh. A nuk është kështu? Mëndafshe, kadife, ç'të duash ti. Nuk dyshoj se kam ca veshje t'hijshme, Të cilat mund t'ju tërheqin. Vërtetë ka vajtur shumë vonë, Por ne tregtarët punojm' dit'e-nat', Të arrijmë ato pak fitime. Tarifat janë tepër të larta, Dhe çdo qytet ka tarifata e tij, Ndërsa praktikantët s'janë për gjë, E grave t'tyre u mungojn' dredhit'. Ndërkohë që Bianca ime k'tu, Më ka sjellë një klient të pasur. A nuk është kështu, o Bianca? Por jam duke humbur kohë. Ku është trasta ime? Ku është trasta ime po të them. Hape, gruaja ime e dashur. Liroi kordat. Ulu në gjuhë. E ke më të lehtë ashtu. Jo atë, atë tjetrën. Hapu, hapu! Blerësve mund t'u sosit durimi, Nuk guxojmë ti lëmë të presin. Po! Ajo është. Ma jep me kujdes. Është mëse e shtrenjtë. Preke me kujdes.

Edhe tani, Imzot - Jo ndjesë. Kam këtu një damask Luke¹, Me rrjet' argjendi e trëndafila, Të cilave u mungon aroma, Vetëm e vetëm për të mashtruar, Shqisën e shfrenimit. Prekeni, Imzot. A nuk është e

¹ "Luke" (nga Lucca). Lucca është një qytet në Itali.

OSCAR WILDE

Tragjedi fiorentinase

Përkthyer nga: Orin Maxhari

butë si ujë, A nuk është e fortë si çelik? Dhe më pas trëndafilat! A nuk janë të endura imët? As shpatet që duan trëndafilin, Në Bellosguardo e Fiesol, S'çelin lule të tilla n'pranverë. Ose, nëse ato vërtet' çelin, Lulet e tyre bien e vyshken. I tillë është fati i të brishtëve, Që kërcejn' nëpër erë e ujë. Natyra shpall luftë ndaj vetvetes, Duke vrar' fëmijët si Medea. Shiheni dhe më nga afër Imzot. Se në këtë damask, Është gjithnjë verë, dhe asnjë dimër, Nuk ka për ta vyshkur kurrë atë. Për çdo gjashtë pëllëmbë dhash' një cop' ar. Ar t'kuq madje, Fryt i kursimit tim të kujdesshëm.

GUIDO: Simone i sinqertë, Mjaft, Të lutem. Jam mëse i kënaqur. Nesër do t'dërgoj shërbyesin tim, I cili do t'paguajë dyfish.

SIMONE: Princi im bujar! Të uth duart. Tani m'kujtohet një tjetër thesar, I fshehur diku n'shtëpinë time, Të cilin ti duhet që ta shohësh. Është një mantel ceremonial: Endur nga një venecian: Punuar me kadife: Me motive shegësh: Çdo farë e punuar me perla: Gjithë jaka me perla po ashtu: Dendur aq sa molet nëpër rrugë, Gjat' netëve të stinës verore, Dhe më të shndritshme se ato hëna, Që shohin t'lajthiturit nga burgjet. Rubini digjet brenda kapësës. Ashtu si digjet edhe qymyri. As Ati shenjtë, as indianët, Nuk kanë parë një gur të tillë. Vet'spila është prej artit më t'bukur, Cellini nuk bëri gjë më t'bukur, Të kënaqte Lorenzo-n e mirë. Ti duhet ta veshësh. Nuk ka në këtë qytet më të denjë, Dhe madje ty do të shkonte shumë. Në njërin krah, Një satir² i hollë kërcen në ar, Të kapë ca nimfa prej argjendi. Në tjetrin qëndron heshtja me një kristal, Jo më t'madh se një misër i plotë, Që përshëndet kalimin e zogjve, Madje thurur aq mirë sa mund t'them, Se ajo merr, ose e mban frymën.

Bianca e ndershme, Nuk do ti shkonte kjo rrobë atij?

Mbushja mendjen, Nuk do të refuzonte gjë tënden, Megjithëse çmimi është i majmë. Fitimi jot do t'ishte sa imi.

BIANCA: A jam gjë unë vartësja jote? Përse duhet të bëj pazar për ty?

GUIDO: Jo, Bianca e ndershme, Unë kam për ta blerë at'rrobë, Dhe çdogjë tjetër që ky tregtar shet. Princat duhen plaçkitur, Dhe me shumë fat qëllonjë ata, Të rënë në duar kaq të drejta.

SIMONE: Paskam gabuar. Do t'i blije veshjet? A s'ke më qejf? Me pesëdhjetë mijë kurora, Zor se mund të më shpërblenit për to. Por ju, Imzot, Mundet ti bëni ato tuajat, Për vetëm dyzet' mijë të tilla. A është ky çmim shumë i lartë? Caktojeni vetë çmimin tuaj. Do doja të t'shijja me to veshur, Rrethuar nga gratë e oborrit, Si një lule mes lulesh të tjera.

Thonë se këto dama të hijshme, Vijnë nga pas shkëlqësisë suaj, Dhe kudo që shkon ato t'rrethojnë, Secila n'kërkim të favorit tënd.

Kam dëgjuar gjithashtu për burra, Të cilët mbajnë trimërisht brirë, Kjo një modë shumë fantastike.

GUIDO: Gjuha jote duhet prerë Simon'. Ti je duke harruar se mes nesh, Nodohet një grua, vesh' e së cilës, S'janë mësuar me një melodi, Aq t'ashpër sa e jotja tani.

² "Satirët" janë pjesë e një klase perëndish pylli, ephorë dhe të dehur. Në mitologjinë greke ata shfaqen si burra me veshë dhe bisht kali, ndërsa në atë romak, si burra me veshë, bisht, këmbë dhe brirë dhie.

SIMONE: E vërtetë. Kisha harruar. Nuk u ofendoj më. Do t'i blinim veshjet? A s'keni qejf? Dyzet mij' kurora s'janë asgjë, Për atë që është pasardhësi, I fronit të Giovanni Bardi-t.

GUIDO: Sqarohuni ditën e nesërme, Me përgjegj'sin Antonio Costa, I cili do t'vijë, E do t'japë njëqind' mijë kurora, Nëse aq do t'mjaftonin për punën.

SIMONE: Njëqind mijë kurora! A thatë njëqind mijë? Me aq do t'bëhesha përherë, Dhe n'çdogjë t'mundshme borxhli ndaj teje. Po! Që nga ky çast e tutje, Shtëpia ime, me gjithëqinda brenda, Do t'bëhej vetëm e juaja.

Njëqind mijë! Mahnitëm. Me aq do t'bëhesha më i pasur, Se të gjithë tregtarët e tjerë. Do t'blija vreshta, toka e kopshte. Çdo tezgjah nga Milano n'Sicili, Bashkë me gjith' perlat e Arabisë, T'fshehura thellë nëpër kaverna³, Do të bëheshin pronat e mia.

Princ bujar, Le t'jetë kjo mbrëmje lajmëtare, I dashurisë sime aq të madhe, Sa nuk do t'refuzonte ty asgjë.

GUIDO: Po sikur t'kërkoja Bianca-n k'tu?

SIMONE: Ju talleni, Imzot. Ajo nuk është e denjë për ju. Ajo s'është bërë për gjë tjetër, Veçse të tjerë e mbajë shtëpin'. A s'është kështu, grua e mbarë? Po kështu është. Shih! Distafi ty po të thërrret⁴. Ulu dhe rrotullo. Gratë s'duhet të rrijnë duarkryq, Sidomos nëpër sh'pitë e tyre. Gishtat papun' lënë zemrën pa mend.

BIANCA: Ç'të rrotulloj?

SIMONE: Oh! Rrotullo ndonjë rrobë të purpurt, Nga ato që trishtimi mund t'vëshë, Për të ngushëlluar veten e tij. O ndonjë pëllurë thekash t'gjata, N'të cilën një foshnje padëshiruar, Mund të vajtojë pa u dëgjuar. Ose ndonjë çarçaf të hollë që, I parfumosur me delikates', Edhe me disa barëra t'ëmblla, Mund të shërbejë për të mbështjellë, Trupin e shkretë të një të vdekuri. Rrotulloni ç'të doni. Nuk më intereson.

BIANCA: Fija e brishtë është këputur. Dhe rrota vet' është dobësuar, Së bashku me distafin e lodhur, Nga puna e tyre pandërprerë.

SIMONE: Nuk ka rëndësi. Nesër e çdo dit' tjetër do t'jerrësh, E do të gjendesh pranë distafit. Si Lucretia e gjet' prej Tarquin. Apo ndoshta po e priste atë⁵? Ku i duhet? Kam dëgjuar gjëra të çuditshme. Dhe tash, Imzot. Ç'lajme vijnë nga jashtë? Kam dëgjuar sot në Pisa diçka, Në lidhje me tregtarët anglezë, Që shisnin me çmime më të ulëta, Se ato që lejon ligji drejtë. Madje i janë lutur parisë, Që ajo ti dëgjojë vëmendshëm.

A është mirë kjo? Duhet t'bëhen tregtarët si ujqër? Dhe a duhet që njeriu i huaj, I cili jeton në tokën tonë, T'kërkojë me privilegj' a zanat, Të vjedhë prej fitimeve tona?

GUIDO: Ç'të bëj unë me ata tregtarë, Apo me fitimet që ata kanë? Të grindem me parinë veç për ty? Të vesh mantelin me t'cilin blihet, Ose u shitet budallenjëve? I ndershmi Simone, Shit-blerja e leshit është për ju. Zgjuarsia ime prehet në vende të tjera.

³ "...kaverna", në këtë kontekst ato janë shpella nënujore.

⁴ "Distafi" është një shkop prej druri që përdoret në tjerren me dorë për të mbajtur fibra të papërpunuara (lesh ose pambuk).

⁵ I referohet legjendës së lashtë romake të përdhunimit të Lucretia-s nga Sextus Tarquinius (Tarquin), një pikë kyçe në historinë romake që rezultoi në përmbyshjen e monarkisë dhe themelimin e Republikës.

BIANCA: Lord fisnik, Do t'ju lutesha t'falnit burrin tim, Pasi shpirti s'i largohet tregut, Dhe zemra i rreh sa çmimi leshit. Gjithësesi, ai është i sinqertë. [Drejtuar Simone-s] Edhe ty, a nuk t'vjen turp nga vetja? Një princ i sjellshëm vjen n'shtëpinë tonë, Dhe ti duhet që ta lodhësh atë, Me besimet më t'gabuar t'mundshme? Kërkoj falje.

SIMONE: E kërkoj me përlulesi. Le të flasim për gjëra të tjera. Kam dëgjuar se Ati i shenjtë, I ka shkruar një letër mbretit t'Francës, Duke e ftuar t'kalojë Alpet, Për të bërë një paqe n'Itali, E cila do t'ishte më e keqe, Se gjith' luftërat vëllazërore, Dhe më e përgjakshme se të gjitha, Shpronësimet dhe luftat civile.

GUIDO: Oh! Na ka lodhur ai mbret i Francës, Që flet se do t'vijë por s'vjen kurrë. Çfar' janë këto gjëra për mua? Ka gjëra të tjera më t'afërta, Edhe më të rëndësishme për ne, Simone i mbarë.

BIANCA: [Simone-s] Mendoj se ti je duke e lodhur, Mysafirin tonë kaq të hijshëm. Ç'është për ne ai mbret i Francës? Sa tregtarët anglez dhe leshi tyre.

SIMONE: Kështu është, atëherë? A është tkurrur gjithë kjo botë, Në vetëm kufijt' e kësaj dhome, Me tre shpirtrat e saj për banorë? Po! Vijn' dhe kohë kur universi i madh, Si pëlhura nduar e t'paafit, Tkurret sa një pëllëmbë e dorës. Me shumë mundësi kjo koh' ka ardhur! Epo. Le të jetë tani ajo kohë. Le të bëhet kjo dhomë e ligë, Si ajo sken' ku mbretërit vdesin, Dhe jetët tona loja e Zotit.

Nuk e di pse, Po flas kështu. Rrugëtimi më ka lodhur shumë. Kali im u pengua tre herë, Ky do t'ishte fat i keq për këdo.

Gjithësesi, Imzot. Sa pazar i keq është kjo jetë, Dhe në ç'treg të ligë që shitemi! Kur lindim mamatë qajnë për ne, Ndërsa kur vdesim s'gjendet kush t'qajë. Jo, askush. [Kalon në prapaskenë.]

BIANCA: Sa n'mënyrë t'pahijshme që flet ai! E urrej atë, me trup e me shpirt. Frika ka lënë vullën e saj mbi të. Duart e tij, më t'bardha se gjethet, E plepit gjat' pranverës rrëmby'shme, Dridhen me njëfarë paralize. Kurse goja e tij belbëzon kot, Ashtu si uji prej një kanali.

GUIDO: Bianca e ëmbël, Ai s'është i denj' për ne të dy, Pasi nuk është veçse një kopuk, I ndershëm me plot fjalë t'mira, Për të gjitha mallërat e jetës, Duke shitur sa më shtrenjtë at' gjë, Që duhet të shiste sa më lirë. Si një fjalaman i nervozuar, Në botën e bërë prej fjalëve. Unë s'kam hasur kurrë më parë, Një budalla kaq shumë elokuent.

BIANCA: Ah sikur vdekja ta merrte që aty.

SIMONE: [Duke u kthyer] Kush përmendi vdekjen? Le të mos flasë askush për atë. Ç'do t'donte vdekja në këtë shtëpi, Me vetëm një grua, burrë dhe mik, Për ta përshëndetur dhe pranuar? Ajo le të shkojë në ato shtëpi, Ku ndodhin gjëra t'ndyra, dhe ka gra, Të cilat, duke u lodh' nga burrat, Dhe n'çarçafët ndotur dhe çnderuar, Ushqejn' ephsin e tyre t'paligjshëm. Po! Është çuditërisht e vërtetë. TI nuk e njeh ende këtë botë, TI je shumë i ndershëm dhe vetmuar. Këtë unë e di shumë mirë. Edhe sikur të mos ishte kështu, Pjekuria vjen vetë me dimrat. Flokët e mi po marrin ngjyrën gri, Dhe kam lënë pas vitem e rinis'. Mjaft me kaq. Kjo mbrëmje e sotme po më duket, Vërtet e pjekur për kënaqësi, Dhe n'fakt duhet të jem i gëzuar, Siç i takon dhe një mikpritësi, Që gjen një mysafir kaq të sjellshëm, Dhe i duhet që ta përshëndesë. [Merr një lahutë] Po kjo ç'është imzot? Ju na paskeni sjellë lahutën, Për t'luajtur para ne të dyve. Oh! Luani, Princ i ëmbël. Në tregohem tepër i drejtpërdrejt', Më falni, por gjithësesi, luani.

GUIDO: Nuk do t'luaj sonte. Një her' tjetër Simon'.

[Kthyer Bianca-s] Ti dhe unë bashkë,

Pa dëgjues t'jerë, Veç yjeve n'qiell, O hënës xheloze.

SIMONE: Ju lutem shumë o Imzot. Kam dëgjuar se me një lëvizje, Aq të thjeshtë të telave të saj, Ose me një frymë delikate, Përmes kallamishsteve t'zbrazëta, Apo mes gojëve prej bronzi dinak, Ata që njohin mirë këtë art, Munden ti nxjerrin shpirtrat e gjerë, Nga shtëpi-burgjet që ata kanë.

Gjithashtu kam dëgjuar për magjin', Që fshihet pas tyre guackave, E cila me një kërkesë t'tyre, Bën dritaret të hapen plotësisht, Pafajsinë t'vendos gjethe hardhie, Dhe t'shfhrenohet si një maenad-ë⁶. Le të shkojë. Lahuta jote, jam bindur, Se duhet t'jetë e pastër. Prandaj luaj. Rrëmbemë veshët me një melodi, Sepse shpirti im ndodhet gjithashtu, Në një prej tyre shtëpi-burgjeve, Dhe duhet muzika për t'kurrar, Atë çmenduri që ruan brenda. Bianca e mirë, Mbushja mendjen mysafirrit tonë.

BIANCA: Mos ki frikë. Mysafiri do ta zgjedhë vetë, Vendin dhe momenti kur do t'luajë. Ai vend e moment nuk janë tani. Ti e lodh at' duke këmbëngulur.

GUIDO: Simone i mbarë, Ndonjë mbrëmje tjetër. Sot jam i kënaqur, Thjesht me zërin e zonjës, Që kur flet magjeps ajrin dashuror, Dhe bën tokën rrotulluese t'ndal, O të rregulloj orbitën drejt saj.

SIMONE: Ti lëvdon atë më shumë se duhet. Ka vlera si shumica e grave, Por bukurinë nuk mund ta veshë, Si një xhevahir rreth qafës së saj. Ndoshta kështu është për më mirë.

Epo, Imzot, Nëse nuk do të luash lahutën, Për t'magjepsur shpirtin tim t'trazuar, A do të pish me mua të paktën?

[Duke i bërë shenjë Guido-s të vijë aty ku ndodhet ai.]

Shtuar e ke. Bjermë n'stol Bianca. Mbyll grilat dhe vendos shufrën atje. S'do t'doja që bota kurioze, Mendjengushtë e me sy të vegjël, Të shihte kënaqësinë tonë.

Tani, Imzot, Na ngri ndonjë dolli nga kupa plot. [Stepet.] Ç'është kjo njollë mbi këtë copë? E cila duket aq e purpurt sa, Një plagë në brinjët e Jezusit. Thjeshtë verë? Kam dëgjuar të thonë. Se kur derdhet vera, derdhet gjaku, Por kjo nuk është veçse një trillim.

Imzot, Shpresoj që rrushi i verës sime, T'jetë sipas shijeve tuaja. Vera e Napolit është e zjarrtë, Ashtu siç janë dhe vetë malet. Ndërsa vreshtat tanë prej Toskane, Japin një lëng edhe më t'shëndetshëm.

GUIDO: Më pëlqen shumë Simon' i mbarë, Dhe me lejen tuaj do ngre dolli, Pasi buzët e Bianca-s bukur, Si gjethet e një trëndafili t'kuq, T'kenë lundëruar e lënë pas, Në këtë kupë shijen e ëmbël. Shijoje, Bianca. [Bianca pi.]

Oh, gjith' mjalti i bletëve Hibleane⁷, I krahasuar me këtë gllënjë, Do të quhej plotësisht i hidhur! Simone i mbarë përse nuk ndan, Bashk' me mua këtë kënaqësi.

SIMONE: Më duket mjaft e çuditshme, Imzot, Por nuk mund të ha e pi me ju sot. Ndonjë humor ose ethe në gjak, Gjatë stinëve t'tjera i butë, Ose ndonjë mendim si nëpërkë, Që zvarritet nga vendi në vend, Si i çmenduri nga një qeli n'tjetrën, Më helmon qiellzën dhe heq urinë, Duke kthyer në neveri, jo mall.

[Shkon mënjandë.]
GUIDO: Bianca e ëmbël, ai më lodh. Më duhet të largohem që këtej. Do t'vi nesër. Veç orën më thuaj.

BIANCA: Ejani këtu me agimin më t'ri! Jeta ime do t'jetë e kotë, Derisa t'ju shoh edhe një herë.

GUIDO: Ah! Lësho mesnatën e rënë mbi flokë, Dhe në ato sy më lejo të shoh, Pamjen time si n'pasqyra. E dashur Bianca, Dhe sikur t'jetë thjesht ime hije, Të lutem, mos shkëput sytë prej saj, Dhe as mos shih gjëra



që s'tregojnë, Ndonjë simbol të qenies sime. Unë jam xheloz, Ndaj asaj që t'shohin sytë.

BIANCA: Oh! Të jesh i sigurt se pamja jote, Do të jetë gjithmonë me mua. Dashuria e ëmbël mund t'përkthejë, Edhe gjënë më t'ligë n'kujtesa. Por eja para se kënga zogthit, T'ketë zgjuar nj'botë ëndërrimtarsh'. Unë do të pres për ty në ballkon.

GUIDO: Dhe me n'shkallë t'bërë nga mëndafshi, Do t'zbresësh poshtë e të më takosh, Me këmbët e bardha njëra pas tjetrës, Si bora mbi nj'pemë trëndafili.

BIANCA: Si ta doni. Ju e dini që jam e juaja, Si në jetë, ashtu dhe në vdekje.

GUIDO: Do më duhet t'largohem Simone.

SIMONE: Kaq herët? M'thoni përse? Kambana Duomos, Ende nuk ka rënë për mesnatë. Rojet që me bori tallin hënën, Dergjen të përgjumur nëpër kulla. Qëndroni pak. Druhem se nuk do të shihemi më, Dhe kjo trishton zemrën time t'thjeshtë.

GUIDO: Mos u shqetëso Simone. Do të qëndroj, I palëkundur n'miqësi, Ndërsa sonte, Do t'kthehem menjëherë në shtëpi. Nesër, Bianca e ëmbël.

SIMONE: Epo kështu qoftë. Do kisha dashur nj'bisedë më t'plot, Miku dhe mysafiri im, Tepër i ri dhe i ndershëm, Por shoh që s'është e mundur.

Nuk dyshoj se babai po ju pret, N'lodhje për zëra e hapa. Ti më duket, Je i vetmi fëmij? Ai nuk ka fëmijë tjetër. Ti je kolona hijshme e shtëpis', Lulja e kopshtit me barëra t'këqij. Nipërit s'e duan shumë atë, Kështu përflitet n'Firence. Kët' desh t'thoja. Shumë thonë se janë xhelozë, Ndaj trashëgimisë që ti do t'kesh, Dhe ti shohin vreshtat me sy t'zjarrtë, Si Ahab-i të Naboth-it⁸. Por këto nuk janë veçse fjalët, E nj'vendi ku gratë flasin.

Natën e mir' imzot. Sillmë një pishtar Bianca. Shkallt' e vjetra, Jan' plot me gropa, dhe hëna ndyrë, Rritet si një koprrac me dritën e saj, Dhe fsheh fytyrën pas nj'maske t'hollë, Si laviret kur duan t'zënë n'kurth, Ndonjë shpirt t'mjerë mëkatar. Tash' do t'ju sjell, Mantel e shpat'. Jo, shumë ndjesë o Imzot, S'është veçse e drejt' që t'ju shërbej, Ju që keni nderuar aq shumë, Shtëpin' time qytetse t'përlulur, Ku keni pir' verë e ngrën' bukë, Dhe që jeni rehatuar. Shumë shpesh unë, Me gruan do t'flas për këtë natë, Dhe problemet e saj.

Pa shih se ç'shpatë është kjo. Kalibër i Ferrara-s i cili, Ashtu si një gjarpër mund

t'përthyer, Padyshim më vdekjeprurës. Me këtë çelik, S'ke pse ti trembesh gjëje në jetë. Kurrë s'kam prekur nj'teh kaq delikat. Edhe unë kam nj'shpatë gjithashtu, E cila mund t'jetë ndryshkur disi. Ne që jemi njerëz paqësorë, Ne na mësohet përlulesia, Dhe të mbajmë pesha të rënda mbi kurriz, Pa ankesa ndaj botës padrejtë, Duke duruar gjith' poshtërsitë. Ashtu si çifuti i duruar, Gjejm' fitimin n'dhimbe.

Ende mbaj mend, Si një herë rrugës për Padua, Një hajdut desh të më merrte kalin, Dhe i preva fytin. Mund ti bëj ball, Çnderimit, fyerjeve, turpeve, Përbuzjeve t'mprehta, përçmimeve, Por ai që vjedh çka m'perket mua, Oh! Dhe si t'ishte pjata m'ordinere, Nga e cila unë jam ushqyer, Oh! Ai do të rrezikonte shpirt e trup, E do t'vdiste për at' mëkat. Prej ç'balte t'çuditshme, Formohet njeriu!

GUIDO: Përse po flet kaq çuditshëm?
SIMONE: Pyes veten nëse shpata ime, Është punuar më mirë se jotja. Ta testojmë? Apo kam status tepër të ulët, Për ty t'kryqëzosh shpatë me timen, N'tallje o sinqerisht?

GUIDO: Asgjë s'do m'kënaqte m'shumë, Se t'qëndroja ballë teje me teh, N'tallje o sinqerisht. Bjermja shpatën time tani. Ti merr tëndën. Sot do t'zgjidhim dilemën e madhe, Në çeliku princit a tregtarit, Është punuar më mirë. A nuk e the ti këtë gjë? Shko dhe merre shpatën tënde. Përse vonohesh zotëri?

SIMONE: Nga të gjithë nderimet e larta, Që keni bër' ndaj shtëpisë sime, Ky do t'ishte më i madhi.

Ma sill shpatën o Bianca. Lëviz at' stol dhe tavolin. Duhet t'kemi, Një zonë t'hapur për ndeshjen tonë, Dhe Bianca do t'mbajë pishtarin, Që t'mos bëhet ndeshja serioze.

BIANCA: [Drejtuar Guido-s] Oh! Vrite! Vrite!

SIMONE: Mbaj pishtarin grua. [Ata nisin të dyluftojnë]

SIMONE: Merre këtë! Ah! Ha! Kështu pra-

[Ai plagoset nga Guido]

SIMONE: Gërvishtje, jo më shumë, Pishtari m'pengonte pamjen. Mos u shqetëso Bianca. S'është asgjë. Burri yt vërtet po rrjedh gjak, Por dhe kjo nuk është asgjë. Merr një rreckë, Dhe ma lidh atë rreth krahut. Jo aq ngushtë. Më lehtë, grua e mirë. Mos u trishto, Lutem që mos të trishtohesh. Më mir' ma hiq. Çfarë u bë se rrodha gjak?

[E heq "fashën"]

Sërish! Sërish!

[Simone çarmatos Guidon]

E sheh që kam pasur t'drejtë imzot, Shpata ime ish' çelik më i mir'. Por tani le t'masim kamat.

BIANCA: [Drejtuar Guido-s] Vrite! Vrite!

SIMONE: Fike pishtarin Bianca.

[Bianca shuan pishtarin]

SIMONE: Tani o zotëri, Deri në vdekje t'njërit, o t'dyve, O t'treve le t'jetë.

[Ata dyluftojnë]

SIMONE: Atje, Atje. Ah dreq! Mos vall' tani të kam ndorë?

[Simone mposht Guido-n dhe e hedh mbi tavolinë]

GUIDO: Mi hiq duart nga fyti, idiot! Jam djali i vetëm i babet tim. Shteti s'ka veçse një trashëgimtar, Dhe armiku francez veç këtë pret, Që të godasë qytetin.

SIMONE: Hesht! Yt at' pa fëmi' do t'lumturohej. Sa për shtetin tonë të Firences, Mendoj se ai nuk ka nevojë, Për helmin e njëdrejtuesi imoral. Jeta jote do t'njolloste, gjith' zambakët e saj.

GUIDO: Hiqi ato duar, Hiqi ato duar t'mallkuara. Lëshomë po të them!

SIMONE: Jo, se je kapur aq keq prej meje, Sa asgjë nuk mund të t'shpëtojë dot. Mbledhur në një pikë t'vetme turpi, Që merr fund me at' turp, dhe sa t'turpshëm.

GUIDO: Oh! Lërmë të shoh një prift para se t'vdes!

SIMONE: Përse të duhet të takosh një prift? Tregoja mëkatet, Zotit që do t'shohësh këtë natë, Edhe asnjëherë tjetër. Tregoja mëkatet, Atij i cili është më i drejti, Edhe më i pamëshirshmi. Sa për mua...

GUIDO: Oh më ndihmo Bianca e ëmbël! Ti e di që unë nuk jam në faj.

SIMONE: Paskan ende jetë ato buzë? Vdis si një qen me gjuhën përjashta! Vdis! Vdis! Dhe lumi heshtur do t'presë trupin, Që ta dërgojë ndet pa vëmendje.

GUIDO: Krisht pranoje shpirtin tim të mjerë!

SIMONE: Amin për at'. Tani tjetrën.

[Guido vdes. Simone ngrihet dhe shikon Biankën. Ajo vjen drejt tij e habitur dhe me krahë të hapur.]

BIANCA: Pse s'më the që ishe kaq i fortë?

SIMONE: Pse s'më the që ishe kaq e bukur?

[Ai e puth në buzë.]

⁶ Një ndjekëse femër e zotit grek Dionis.

⁷ "Hibleane" (nga Hiblea). Një varg malor në Sicilinë juglindore.

⁸ Referohet një historie biblike (1 Mbretërve 21).

Çfarë do të bëje nëse gruaja jote do të përfundonte në krahët e Salvador Dalí-së? Përgjigjja e Paul Éluard-it ishte të zhdukej, pa i thënë askujt asgjë. Një ditë të marsit 1924, Éluard u zhduk. As familja dhe as bashkëkohësit nuk e dinin se ku ndodhej. Në Paris nisën të qarkullonin lajme se kish vdekur. I rraskapitur dhe thellësisht i zhgënjyer, ai donte t'i ikte vetes, të harronte gjithçka. U nis në një udhëtim të gjatë: nga Marseja drejt Tahitit, Indonezisë dhe Ceilonit. Pas shtatë muajsh, sikur një endacak, i hipi një anije mallrash holandeze në Singapor dhe u kthye sërish në Marsejë.

Po Dalí? Ai dhe ish-gruaja e Éluard-it, Gala, jetuan të lumtur përgjithmonë. (Orwell e quajti Dalínë "një qenie njerëzore të neveritshme".)

Paul Éluard (Eugène Émile Paul Grindel, 1895–1952) qe një nga themeluesit e surrealistit. Në Francë njihet si një nga poetët më të mëdhenj të dashurisë të shekullit XX, ndërsa në botën anglishtfolëse mbetet çuditërisht më pak i njohur, por kjo jo për mungesë vlerash. Megjithatë kjo është vetëm një anë e figurës së tij. Éluard qe edhe një shpirt politik i zjarrtë, me prirje të majta, që pa nga afër se si demokracia, fashizmi dhe komunizmi premtuan çlirimim e njeriut, ndërkohë që, shpesh në mënyrë të padukshme, synonin kontrollin dhe nënshtrimin e tij. Ai ishte gjithashtu përkrahës i vendosur i praktikës surrealistike, duke kërkuar në nënvetëdije burime të reja për krijimtarinë artistike. Me mbi 70 vjet nga vdekja e tij, tani është koha për ta rishikuar rëndësinë, trashëgiminë dhe aktualitetin e Eluard-it, në një kohë kur populizmi kërcënon të zbehë zërat e disidencës kulturore.

A mund të jetë poezia forcë politike? Apo, siç sugjeron Auden, ajo "nuk bën që të ndodhë gjë"? A janë dashuria dhe surrealizmi në kundërshtim me veprimin dhe angazhimin politik? Jeta dhe vepra e Éluard-it tregojnë me finesë se dashuria dhe bindja politike janë thellësisht të lidhura, dhe se poezia mund të jetë një forcë e fuqishme, një burim nga i cili mund të ushqehemi për t'u përballur me botën ashtu siç është, për të forcuar shpirtin dhe për të luftuar padrejtësitë. Si ta pajtojmë Éluard-in e ndjeshëm, poetin e dashurisë, me subversivin e nënvetëdijes, me militantin e luftës së klasave? Si mundet që poeti që shkroi "Rrëmbimi shtrihet lehtë mbi shqisat tona së bashku/ si agimi i ëndrrës sonë", të shkruajë gjithashtu "toka është blu, si një portokall"?


Për avangardën e fillimshkullit XX, ndryshimi shoqëror dhe metoda artistike ishin të lidhura fort bashkë. Sot, shumë lehtë i shohim të dyja si figura të tërhequra në skaje, që lëvizin me ndrojtje, gjersa, si të shtyra nga një shpërthim i papritur vetëbesimi, futen për vetëm pak çaste në skenën e kulturës mbizotëruese. Do të ishte e lehtë të kuptohej se pse edukatorët modernë do të zbusnin politikën e Éluard-it në favor të temave më të kapshme dhe më të pranueshme të dashurisë. Idealizmi dhe naiviteti i tij e çuan atë, si shumë të tjerë, të besonte se Stalini ishte një forcë për të mirën. Ngas ana tjetër, ai ishte edhe autor i disa poezive kundër nazizmit që qarkulluan fshehurazi, por që e bënë të njohur në mbarë botën si Poeti i Lirisë. Ndoshta pikërisht këto kompleksitete e bëjnë dashurinë më të qëndrueshme si temë: ajo është më e lehtë për t'u pranuar.

Po surrealizmi, a mund të jetë një mjet politik? Në pamje të parë, ai duket si një arratisje nga realiteti, si një këndvështrim tjetër, një mënyrë për të parë gjërat

Paul Éluard, poeti i surreales

Nga David Stoker, *The New World*, janar 2023

Përktheu Jola Tasellari



Portrait de Paul Eluard, Salvador Dalí, 1929

ndryshe, për të nxjerrë në pah absurditetin. Shumicës prej nesh na vijnë ndërmend pikturat e Dalí-së: ëndërrimtare, të shtrembëruara, lozonjare por edhe të frikshme, njëkohësisht të kthjellëta dhe të lehta, paksa të çrregullta, ama sot të respektuara nga bota e artit. Arsimit artistik dhe kultura popullore e kanë reduktuar surrealizmin në stil dhe formë. Në kohën e vet, tronditja e surrealizmit lidhej me erotizmin e tij, gjë që bëhet e qartë në ekspozitën *Objects of Desire* të Design Museum, ku sheh një divan në formë buzësh të plota e të kuqe, një filxhan çaji i mbuluar me gëzof kafshësh apo një hekur me gozhdë. Lëvizja Dada dhe më pas surrealizmi shkaktuan jo pak zhurmë në botën e artit të viteve 1920. Nga ana tjetër, Freud-i nxiti gjerësisht interesin për nënvetëdijen dhe nga kjo kuti e Pandorës dolën imazhe që shoqëria "e respektueshme" nuk donte t'i shihte. Nuk është e vështirë të imagjinohet se si nënat e kujdesshme donin t'i largonin fëmijët nga këto pamje.

Megjithatë, i parë në kontekstin e vet, surrealizmi ishte më shumë se thjesht çudi për hir të çudisë. Ai përfaqësonte një kundërvënie ndaj fashizmit. Manifesti i parë surrealist, i shpallur nga André Breton në vitin 1924, deklaronte: "(sur)realizmi nuk është një mënyrë e re, më

e lehtë shprehjeje, por një çlirim i plotë i mendjes... ne jemi tërësisht të përkushtuar që të bëjmë revolucion." Çlirimi i mendjes mund të na sjellë ndër mend *The Doors of Perception* të Aldous Huxley-t apo të rinjtë e shkujdesur të verës së vitit 1968. Një term më në modë sot është *çmësimi*. Por në thelb, dëshira për t'u çliruar nga mendimi racional është një përpjekje për t'u shkëputur nga formula e ngurtë se *kështu bëhen gjërat*. Liria artistike nuk nënkuptonte shmangie nga përgjegjësia; përkundrazi. Vetë Éluard këmbëngulte në "ndjenjen më të thellë të përgjegjësise që përfshihet pas çdo akti krijues". Tensioni i tij prodhues midis realizmit social dhe eksperimentimit surrealist po vijonte të jepte fryte. E megjithatë, prapë se prapë, një farë tensioni mbeti midis politikës së tij dhe këtij impulsi për çlirimim e mendjes. Në vitet '40, Éluard kaloi shumë vera me Picasso-n në jug të Francës. "Ata ndanin një lloj optimizmi për lidhjen e artit me mundësi të ndryshimit shoqëror", shkruan studiuesja Jill Lewis.

Gjithsesi, Éluard-i nuk ishte njeri pa dyshime. Në vitin 1951, në *Pouvoir tout dire*, ai shkruan: "E rëndësishme është të thuash gjithçka, por fjalët më mungojnë / më mungon koha dhe më mungon guximi / ëndërroj dhe rrëfej në imazhe të çrregullta." Megjithatë, ai ishte

i vendosur ta lidhte artin me realitetin. Në një përgjigje ndaj një pyetësi mbi marrëdhënien mes artit dhe politikës, ai theksonte nevojën për të vepruar përtej kufijve, dyshimeve dhe kompromiseve që imponon realiteti.

"Pikërisht sepse është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me atë që e rrethon, artisti gjen forcën për të krijuar [...] nëse arti duhet të jetë i vërtetë, nëse duhet të jetë dëshmi dhe mjet veprimi, ai pranon se asnjë realitet, sado i tmerrshëm, nuk është i pakapërcyeshëm... Cilësia e vetme që mund të kërkojmë nga një artist është të mos i mungojë kurrë dashuria, të mos i mungojë kurrë besimi në potencialin njerëzor."

Shpresa mund të jetë e rrezikshme. Poetja dhe gazetarja turke Ece Temelkuran shkroi: "Nuk besoj te fjala shpresë [...] është shumë e brishtë për këto kohë të këqija."

A është poezia një mjet për të zgjuar masat? Sot mund të tingëllojë disi e dalë mode. Megjithatë, tekste e këngëve kanë qenë prej kohësh të ngarkuara politikisht: nga Gil Scott-Heron te Linton Kwesi Johnson e deri te Stormzy. Njëjtë edhe Éluard, në poezitë e tij politike, nuk përmbahet: "Patjetër që e urrej sundimin e borgjezisë / sundimin e policëve dhe priftërinjve / por urrej edhe më shumë këdo që nuk e urren / si unë / me gjithë fuqinë."

Larg së qeni thjesht zburim, gjuha është hapësira ku ngjan transformimi. "Poezitë e Paul Éluard-it ilustrojnë fuqinë e fjalëve për të ngjyrosur dhe për të formësuar vizionin emocional", shton studiuesja J. Lewis. Por ç'ndodh ndërkohë me dashurinë romantike? Lidhja e poezisë së dashurisë me politikën paraqet një tjetër enigmë. Carol Hanisch thotë për Éluard-in se *personalja për të ishte politike*. Më konkretisht, çifti përbente vërtet një qelizë solidariteti. Në këtë këndvështrim, nuk ka përparim shoqëror, asnjë luftë për barazi, pa dashuri. Në Le Phénix, botuar më 1951, në poezinë që i jep titullin, feniksi bëhet simbol i rigjenerimit, duke vendosur realizmin dhe shpresën si thelbësore për procesin e dashurisë. Përtej thjeshtësimeve romantike, lidhja e zjarrtë dhe besimi intim i japin mundësi vetes të rikompozojë dëshira më të mëdha, t'u japë kuptim projekteve, ku çifti është në lëvizje brenda një bote shoqërore.

Pak prej nesh sot e shohin një çift romantik si një qelizë aktiviste, në kuptimin e plotë të fjalës. Ka prova që njerëzit priren të zgjedhin partnerë që i përkasin të njëjtave bindje politike, çka sugjeron se politika në fakt ka peshë në njohje dhe në martesë. Dhe barazia gjinore ka çelur hapësira për agjenci të reja, veçanërisht (por jo vetëm) për gratë, për të kërkuar role përtej atyre të bashkëshortes dhe të nënës. Megjithatë, nëse diçkaje i është mëshuar më fort, është se institucioni (prototipik heteroseksual) i çiftit, në kulturën perëndimore, përfaqëson një vend ripërtëritjeje dhe strehimi nga bota, më tepër sesa një pikënisje për ta transformuar atë. Kështu, kemi një trekëndësh kompleks e poetik të dashurisë, surrealizmit dhe politikës; një çlirim të mendjes dhe një përqendrim tek marrëdhënia monogame romantike si bërthama themelore, si fara embrionale e një solidariteti më të gjerë politik.

Gjatë jetës së tij, Paul Éluard botoi mbi 70 vëllime me poezi, si edhe shkrime letrare, kritike e politike. Vdiq në Charenton-le-Pont, pranë Parisit, më 1952 dhe, për arsye politike, iu mohua një funeral shtetëror. Për t'i dhënë respektet e fundit, në funeralin e Eluard-it u rreshtuan rrugëve me mijëra njerëz.

Më 9 mars 2026, Galeria "ZENIT" në Tiranë u bë vendi ku publikisht u prezantua për herë të parë cikli i ri i Peter Assmann – 40 punime të realizuara gjatë viteve 2025-2026, në vizatim dhe akuarel. Kjo ekspozitë personale, e kuruar nga Artan Shabani, i fton shikuesit të hyjnë në një dialog të veçantë me dritën, hapësirën, linjën, por edhe me një dimension të ri: temën e të drejtave të njeriut, të cilën artisti e përforcon përmes shkrimeve dhe mesazheve që shoqërojnë çdo vepër.

"Drita nuk është vetëm ajo që sheh syri,..." shprehet Assmann, "...ajo është ajo që ndiejmë brenda, ajo që formon hapësirën e shpirtit dhe ndërton ura mes njerëzve..." Secili vizatim dhe akuarel bëhet kështu një pasqyrë poetike e perceptimeve të tij, duke i dhënë publikut mundësinë të ndiejë, të meditojë dhe të reflektojë mbi temën universale të të drejtave të njeriut. Ekspozita në Tiranë do të qëndrojë e hapur nga 9 deri më 19 mars 2026, ndërsa më pas cikli i vizatimeve të artistit, do të vazhdojë udhëtimin e tij në Vlorë, në Promenade Gallery, të themeluar dhe drejtuar po nga Artan Shabani. Ky itinerar sjell artin e Assmann për publikun shqiptar në dy qytete kryesore, duke e bërë përvojën më të gjerë dhe më të prekshme.

Formimi dhe përvoja ndërkombëtare

Ilindur më 28 gusht 1963 në Zams, Austri, Assmann studioi histori arti, histori dhe gjermanistikë në Universitetin e Innsbruckut, ku mbrojti doktoraturën me një studim mbi afresket historike të manastirit Santa Maria Novella. Karriera e tij ndërkombëtare përfshin periudha studimi në Deutsches Kunsthistorisches Institut në Firence, si dhe aktivitetin në komitetin shkencor të Castello del Buonconsiglio.

Si drejtor i Palazzo Ducale di Mantova, Itali, ai ka ndërthurur traditën me eksperimentin bashkëkohor, duke krijuar ura mes historisë, artit dhe perceptimit modern. Përveç veprimtarisë institucionale, Assmann ka qenë president i Shoqatës Austriake të Muzeve, anëtar i bordit të NEMO dhe aktiv si shkrimtar dhe artist vizual, duke kontribuar në jetën artistike dhe kulturore europiane. Artisti Peter Assmann duke filluar nga viti 2017 - 2026 ka marrë pjesë në mbi 75 ekspozita në grup, ka çelur 6 ekspozita vetjake dhe 5 ekspozita sëbashku me një artist tjetër. Ekspozitat e tij janë çelur në qytete të ndryshme të Austrisë, në Itali, në Gjermani, në Kinë dhe në Shqipëri.

Drita, hapësira dhe dialogu me publikun

Drita tek punimet e Assmann nuk është thjesht një element teknik – ajo është protagonist i veprës, entitet që merr jetë. Në serinë e tij të fundit, drita shpërndahet mbi figura njerëzore të etërta dhe objekte simbolike, duke krijuar ndjesinë e lëvizjes brenda heshtjes. Akuarelet dhe vizatimet e tij shfaqin atmosfera eterike, plane të ndryshme perceptive dhe kontraste mes dritës dhe hijes, duke ndërthurur emocione të brendshme me reflektime mbi botën.

Secila vepër e ciklit të ri shoqërohet nga shkrime personale të Assmann, ku artisti reflekton mbi të drejtat e njeriut, duke i dhënë publikut një përvojë unike: jo vetëm vizuale, por edhe etike dhe intelektuale. Ai shprehet: "Kur shikuesi ndalon dhe mediton, drita bëhet një rrugë drejt vetvetes dhe drejt të drejtave të secilit njeri."

Një dimension i rëndësishëm është raporti mes trupit dhe hapësirës. Në serinë "Figura dhe Hije" (2023-2025), figura njerëzore shfaqet e ndriçuar pjesërisht, duke u përplasur me hapësirën që e rrethon. Linjat dhe tonalitetet nuk janë thjesht mjete teknike; ato janë gjuhë poetike që ftojnë publikun të meditojë mbi ndjeshmërinë, mbi lirinë dhe dinjitetin e individit.

"Zenit Gallery", Tiranë – ekspozita vetjake e artistit austriak Peter Assmann

"Peter Assmann – një parathënie artistike për të drejtat e njeriut"

Një udhëtim vizual dhe poetik në Tiranë dhe Vlorë
Nga Ylli Drishti



Në veprën "Ndërthurja e kohëve" (2024), referenca nga Rilindja dhe ekspresionizmi ndërthuret me tonalitet modern, duke krijuar një urë mes së kaluarës dhe perceptimit bashkëkohor, duke e bërë ciklin një reflektim i gjallë dhe ndërkombëtar mbi të drejtën e jetës dhe lirinë e shprehjes.

Dialog ndërkulturor dhe udhëtimi i ekspozitës

Ekspozita në Tiranë dhe më pas në Vlorë nuk është thjesht një prezantim vizual; është një udhëtim ndërkulturor dhe reflektues. Punimet e Assmann sjellin një dialog të hapur me shikuesin, ku arti, drita dhe hapësira flasin për mesazhe universale mbi të drejtat dhe dinjitetin e njeriut.

Ky cikël i ri i ekspozuar për herë të parë në Shqipëri është gjithashtu një ftesë për publikun që të bëhet pjesë e rrugëtimit të artistit, duke kuptuar se arti mund të jetë udhëzim, reflektim dhe apel për të drejtën, lirinë dhe barazinë.

Peter Assmann është një artist që



ndërthur njohuri historike, ndjeshmëri poetike dhe eksperimente vizuale, duke krijuar një gjuhë të pasur dhe të thellë. Cikli i tij i fundit, i përqendruar mbi të drejtat e njeriut dhe shoqëruar nga mesazhe personale, e vendos atë në qendër të skenës ndërkombëtare bashkëkohore. Ekspozita në Tiranë (9-19 mars 2026) dhe më pas në Vlorë (28 mars – 20 prill 2026) është një mundësi e rrallë për të përjetuar këtë univers, ku arti bëhet udhëtim, reflektim dhe dialog mbi jetën, lirinë dhe ndjeshmërinë njerëzore. Pjesmarrja në dy ekspozita e artistit Peter Assmann në Shqipëri u bë e mundur nga kuratori & artisti Artan Shabani.

Biografia e artistit Peter Assmann

Nga viti 1987 deri në 1991, Assmann punoi në projekte kërkimore në Itali dhe Francë. Nga 1992 deri në 2000 ishte drejtor i Galerisë Shtetërore të Austrisë së Sipërme, dhe nga 2000 deri në 2013, drejtor i Muzeve Shtetërore të Austrisë së Sipërme. Ai gjithashtu shërbeu në bordin e Network

of European Museum Organisations nga 2009 deri në 2014 dhe ishte president i Austrian Museums Association nga 2002 deri në 2012. Nga 2015 deri në 2019, ai ishte drejtor i Kompleksit Muzikal Palazzo Ducale në Mantova, dhe nga 2019 deri në 2022, drejtor i Muzeve Shtetërore të Tirolit. Një bletë dhe një flutur janë emëruar në nder të Assmann, dhe ai është gjithashtu qytetar nderi i qyteteve italiane Casale Monferrato dhe Curtatone, si dhe anëtar nderi i Accademia delle Arti del Disegno në Firence. Për ditëlindjen e tij të 60-të, i është kushtuar një vëllim përkujtimor: "Apollo e le muse. Studi in onore di Peter Assmann", i redaktuar nga Paolo Bertelli, Treviso: Zel Edizione, 2024 (286 faqe).

Që nga viti 1995, Assmann është aktiv në hapësirën publike si artist dhe shkrimtar. Si artist vizual, ai ishte themelues i grupeve artistike c/o: K – Institut für Kunstinitiativen dhe Sinnenbrand. Ai është gjithashtu anëtar artistik i Vienna Künstlerhaus, Wels Artists' Guild, dhe IG Bildende Kunst, dhe si shkrimtar, anëtar i GAV (Association of Visual Artists).

KUNSTOFFIZIN. Linz – themeluar 2023, Studio dhe Galeri, Linz (A), Graben 9; Studio/Kunstkammer: Grazie (I), (Curtatone pranë Mantovas), via della Francesca 50

Ekspozitat e dy viteve të fundit

2026

Linz, Kunststoffizin, "A+N+P", ekspozitë grupore
Tiranë, Galeria Zenit, "Peter Assmann – një parathënie artistike për të drejtat e njeriut", ekspozitë vetjake
Vlorë, Galeria Promenade, "Peter Assmann", ekspozitë vetjake

2025

Vienna, Galerie district4art, "In/Tolerance", ekspozitë grupore, katalog
Linz, Galerie MAERZ, "Fifteen Minutes by Train – Wels/Linz", ekspozitë në grup
Simbach, Showroom K3, "Winterproof 2025", ekspozitë grupore
Linz, Galerie tiger line, "Word in Image", ekspozitë në grup (kurator Gabriele Baumgartner)
Romë, Salla 1 Centro Internazionale d'Arte Contemporanea, "What do you think?", ekspozitë në grup (kurator Mary Angela Schroth dhe Beate Sprenger)
Romë, Austrian Cultural Forum, "What do you think? Declarations on migration and human rights", ekspozitë në grup (kurator Beate Sprenger)
Kulmbach, Historic Bathhouse, "Retrospectives (eu-art Symposium 2022 and 2023)", ekspozitë në grup (kurator Wolfgang Horwath)
Stuttgart, art district, "The Universe Pinches Back", ekspozitë në grup
Gazoldo degli Ippoliti, MAM - Museo d'Arte Moderna, "What do you think? i diritti umani e le nuove generazioni", ekspozitë në grup (kurator Paola Artoni dhe Beate Sprenger)
Simbach, Showroom K3, "INN Conflict", ekspozitë në grup, katalog
Attnang-Puchheim, Galerie Schloss Puchheim, "Easter Drawing 2025", Simpozium artistik dhe ekspozitë në grup
Trieste, Tivarnella Art Gallery / Strobl Deutschvilla / Linz, Kunststoffizin, "Beauty Exists Everywhere", ekspozitë në grup, katalog
Linz, Galerie tiger line, "Flowers", ekspozitë në grup (kurator Gabriele Baumgartner)
Trieste, Porto Vecchio Sala Leonor Fini, "ART AS A RUNWAY BETWEEN WORLDS / ART AS A PEACE-BRINGING RUNWAY BETWEEN WORLDS", ekspozitë në grup, kurator Art Projects Association
Wels, Galerie Forum, "Human Being", ekspozitë bashkë me Anna Schrems
Krems, Galerie Kopriva, "Selection: Paper", ekspozitë në grup, kurator Gabriele Baumgartner
Neuhaus, Tabor Castle, "25 Years of Art in Dialogue", ekspozitë në grup
Soncino, Museo della Stampa, "Ex Libris Libri d'autore", ekspozitë në grup, kurator David Palterer, Marco Tonelli, Norberto Medardi
Wels, Galerie Forum, "Foroom", ekspozitë në grup
Artists' Village Neumarkt an der Raab, "What is the purpose of art?", eu-art-network, Simpozium artistik dhe ekspozitë në grup
Sofia, Sofia Art Fair, Stand of Kunststoffizin Linz
Tiranë, MAG Gallery, "Drawing Room", ekspozitë në grup, kurator Alba Sgarbi dhe Artan Shabani
Simbach Showroom K3, "Winterproof 2026", ekspozitë në grup

(vijon në faqen 21)

Marsel Prusti (Marcel Proust, 1871-1922) është figurë emblematike e literaturës franceze e shekullit XX, që u shqua në peizazhin e letërsisë me veprën e tij monumentale *Në kërkim të kohës së humbur* (*A la recherche du temps perdu*). Romani, një *katedrale* e vërtetë e letërsisë, eksploron përmasën e kujtesës dhe të kohës në shoqërinë franceze. Universi prustian, i pasur dhe kompleks, vazhdon të befasojë lexues dhe kritikë, duke na ofruar një përshkrim marramendës të shpirtit njerëzor dhe të shoqërisë së kohës, ku, përmes stilit unik dhe të ndjeshëm, Prusti ka krijuar një botë sa intime aq dhe universale, në një kontekst historik dhe kulturor veçanërisht të pasur.

Në kërkim të kohës së humbur (*A la recherche du temps perdu*) është gjithashtu edhe një kërkim i bërë nga autori mitik, që kërkon të kapë kuptimin e ekzistencës, *arratisjen* e kohës dhe të kujtesës si admiruese e dashurisë. Përmes pikëtakimeve me të kaluarën, Marceli (autori i narrativës që nuk është krejtësisht Prusti, por që e evokon gjërësisht atë) tenton të rindërtojë ekzistencën e tij, duke ruajtur koherencën dhe duke gjetur një të vërtetë. Vepra pasqyron shumë univere: fisnikërinë në rënie, borgjezinë në ngritje, artin, dashurinë, xhelozinë, por ajo është, para së gjithash, një analizë e thellë e kushteve njerëzore, e kujtimeve dhe e mënyrës se si ata transformohen në imazhe, nganjëherë të idealizuara, nganjëherë shqetësuese.

Fotografia në universin prustian

Fotografia është gjithkund e pranishme në universin prustian, goftë në rolin metaforik, narrativ apo tematik që ajo luan në kërkimin e kohës së humbur, goftë në portretet e autorit, të realizuara në atelietë fotografike parisiane, në rrethanat historike të caktuara, portrete të cilat lejojnë të veçojnë prirjen publicitare të Prustit.

Qasja klasike e dialogut mes arteve pasqyrohet në korrespondencën dhe analogjitë e përdorura paralelisht, ku Prusti vendos mjeshtërisht në bashkëmarrëdhënie *imazhet e leximit* të tekstit romanesk me *imazhet e pikturës* dhe fotografisë.

Vepra e ilustruar *Bota e Prustit parë nga Paul Nadar-i* (*Le monde de Proust vu par Paul Nadar*), me tekst të Anne-Marie Bernard-it, ka sjellë një dritë të plotë mbi raportet mes fotografisë dhe letërsisë, një bashkëbisedim artistiko-psikologjik midis Prustit dhe personazheve të tij kyç, si dhe një retushim të përsosur të modeleve fotografike të Paul Nadar-it (1856-1939). Kjo veprë mund të përshkruhet si një shëtitje sentimentale dhe e gjallë përmes një galerie portretesh të shquara, gjithsej 120 portrete, të frymëzuara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga personazhet e veprës prustiane, si aristokratë, borgjezë, artistë, aktorë, të gjithë familjarë dhe miq të Prustit, të riprodhuara nga pllakat origjinale të arkivës së fotografit Paul Nadar.

Marcel Prusti nën ndikimin e fotografisë (*Marcel Proust sous l'emprise de photographie*) është një kërkim tjetër artistik i legjendës së fotografisë, Brassai-t (1899-1984), mbi autorin e *Në kërkim të kohës së humbur*, që superpozon interesin e Prustit për fotografinë, me të njëjtën magjepsje si për letërsinë. I armatosur me dijen e fotografisë, Brassai do të integrojë Prustin në universin e fotografisë. Me gjurmët e një pasioni militant, eseja e Brassait aplikon në trupin prustian një teknikë që synon të shikojë fotografinë gjithkund, duke ngulmuar të zbulojë në stilin e Prustit figura të frymëzuara nga dispozitivi kronofotografik. Duke zbuluar Prustin "si shpirtin e tij artistik binjak" në artin e fiksimit të imazheve, Brassai nxjerr në pah raportin intim midis fotografisë dhe letërsisë.

Marcel Prusti është fotografuar gjatë gjithë jetës së tij nga një mori fotografësh amatorë, por gjithashtu edhe nga fotografë profesionistë portretesh. Këto portrete krijojnë një relacion me veprën letrare, duke u bërë emblematike në vitet 1895 dhe 1896, vite që shënojnë data të rëndësishme

Imazhi në përmasën kohore të Prustit

Nga Xhyher Cani PhD



në karrierën e Prustit, duke qarkulluar si kartëvizita, kopertina librash, ekspozita, katalogë të ndryshëm dhe riprodhime në gazeta, në harkun kohor të gjysmës së parë të shekullit XX. Këto portrete lejojnë gjithashtu të dallojmë një fytyrë të re që është quajtur "ndjenja publicitare e dukshme" e Prustit, duke krijuar "imazhin e tij në universin mondan dhe letrar të kohës". Kështu, ambicia letrare e Prustit përqafoi drejtime të reja, ku fotografia u bë e aftë të konfirmojë karakterin dimensional të kohës.

Fotografia si kujtesë imazhesh

Marsel Prusti vlerësonte se kujtimet ndërtojnë identitetin e njeriut. *Në kërkim të kohës së humbur* është kështu një shqyrtim i raportit mes së kaluarës dhe së tashmes së një individi, ku kujtesa luan një rol thelbësor në të shtatë romanet. Për Prustin, jo vetëm thelbi apo esenca e individit gjendet te kujtimet, por në to gjendet gjithashtu edhe thelbi apo esenca e gjërave që e rrethojnë. Sipas Prustit, ne mund të njohim të vërtetën, duke u bazuar tek e tashmja, por është e nevojshme të gërmojmë në të kaluarën, për t'u thelluar në njohjen e së vërtetës. Kështu vetëm me ndihmën e kujtesës mund të arrijmë tek e vërtetë. Ekzistojnë dy lloje kujtesë: kujtesa e vullnetshme, që memorizon në mënyrë të vetëdijshme ngjarjet, dhe kujtesa e pavullnetshme, e lidhur në mënyrë intime me sensacionet a ndjesitë, që na lejon të përjetojmë një moment të kaluar të jetës.

Marsel Prusti mund të konsiderohet si shkrimtari i parapëlqyer i Roland Barthes-it (Roland Barthes (1915-1980)). Në fakt, Prusti ka një prani ngulmuese në shkrimet e Barthes-it gjatë gjithë karrierës së tij. Në këtë vështrim, *Dhoma e ndritshme* (*La Chambre claire*) e R. Barthes-it zë një vend të veçantë në raport me tekstet e tjera që Barthes-i ka shkruar për Prustin, për shkak të densitetit magjepsës të referencave dhe aluzioneve të romancierit. *Dhoma e ndritshme* përfaqëson njëherazi një asimilim të veçantë të ideve prustiane dhe vënien në jetë të një *kujtesë qarkulluese* (ku të dhënat e reja të stokuara zëvendësojnë më pas të vjetrat).

Në leximin barthesian të Prustit, në librin mbi fotografinë, paraqitet një formë e veçantë shkrimi, në formën e një kujtesë. Interteksti prustian që gjendet në zemër

të analizës së fotografisë, lejon të shtjellojë çështjet esenciale që pozon, duke krijuar një nyjë lidhëze mes dispozitivit fotografik dhe kujtesës. Për pasojë, *Dhoma e ndritshme* nuk është një studim sistematik i fotografisë dhe i metaforave në veprën e Prustit, por, më saktë, është një përpjekje për të asimiluar idetë prustiane në një kontekst fotografik dhe vënë në lëvizje "kujtesën e tij qarkulluese".

Në leximin barthesian të Prustit mund të thuhet që pjesa e parë e *Dhoma e ndritshme* përfaqëson kohën e "humbur"; dhe pjesa e dytë, "kohën e gjetur". Megjithatë, duhet theksuar se diferenca themelore midis projektit përkujtimit të Barthes-it dhe atij të Prustit qëndron në faktin se, ndërsa te Prusti e kaluara është në dimensionin imagjinar dhe i vjen në ndihmë *kujtesa e pavullnetshme*, përkundrazi, te Barthes-i, kërkimi i kohës së humbur merr formën e një përfaqësimi fotografik dhe artikullohet si një objekt material që tregon të kaluarën dhe, përfundimisht, është qartësisht i shpjegueshëm në një proces perceptimi.

E kaluara te Prusti përftohet në saje të imazheve të pastra mentale që, si të tilla, janë të lidhura me *kujtesën e pavullnetshme*; në të kundërt, te *Dhoma e ndritshme*, nëna e vdekur shihet në saje të një imazhi fotografik. Diferenca midis kërkimit barthesian dhe kërkimit prustian shprehet, për rrjedhojë, nga një opozicion midis imazheve fotografike dhe imazheve mentale.

Edhe pse Barthes-i trupëzon ide prustiane në shkrimet e tij, ai ngulmon në një ndarje midis fotografisë dhe *kujtesës së pavullnetshme*; madje fotografia, nënvizon ai, edhe pse është e aftë të kapë të kaluarën, ajo nuk e sjell atë në integralitetin e saj.

Prusti, në veprën e tij *E burgosura* (*La Prisonniere*), evokon idenë se nuk është vendi ku gjendemi që përcakton ndjenjën, por është mënyra me të cilën syri dhe shpirti përqafojnë dhe interpretojnë botën që na rrethon. Duhet të dish të vëshgozh si me *lente*, për të kapur esencën. Në veprën e Prustit, ky vizion i kujtesës është më shumë se kaq, ai është një urë midis dy botëve, një pasarelë mes përvojës së përjetuar dhe interpretimit të së kaluarës.

Ky "imazh i kujtesës" nuk është kurrë i saktë, ai deformohet dhe transformohet nën peshën e emocioneve, keqardhjeve, gëzimeve dhe përjetimeve. Pikërisht në këtë përcellje

të mesazhit qëndron i gjithë arti i Prustit, i cili ndërton jo thjesht të kaluarën, por edhe e rikrijon dhe e rishpik përmes imagjinatës të së tashmes, duke e transformuar në një imazh të dyfishtë, herë si një kujtim dhe herë si një dështim në kërkim të kohës së humbur. Për Prustin, imazhi shërben si medium për të zbuluar shtresat e së vërtetës, lidhur me perceptimin vizual në thellësinë e brendshme.

Fotografia sintetizon një lidhje të privilegjuar me kohën dhe ajo bart një memorizim të kujtimeve tona, duke përkujtuar momentet kyçe të jetës sonë, që rrezikohen vazhdimisht nga një deformim apo harresë e ngjarjeve të përjetuara. Këto imazhe që ringjallin ndjenja, shërbejnë si dokumente të ekzistencës; fotografia ruan një marrëdhënie të ngushtë me kohën, edhe pse procesi i riaktivizimit të së kaluarës nuk është efektivisht i kënaqshëm. Por, edhe pse fotografia ruan një funksion kujtues, ajo, e vetme, nuk mund të ndërtojë një pakt autobiografik, prandaj fotografitë integrohen në artin e krijimit, që janë të gjinisë autobiografike narrative.

Fotografia-kujtesë pushon atëherë së ekzistuar si dokument identifikimi dhe kthehet pjesë përbërëse e një pazëlli që kërkon unitet. Por duhet shënuar se, kur pranojmë që fotografia të vlerësohet realisht si kujtim autentik, do të duhet të theksojmë se ajo ka vlera njohëse vetëm për një rreth intim, por, sigurisht, jo për një publik.

Për të zbuluar lidhjet që bashkojnë fotografinë, identitetin dhe kujtesën, refleksionet e Roland Barthes-it në *Dhoma e ndritshme* janë një lexim i detyrueshëm. Ato përftohen te ne si një instrument optik përmes të cilit mundemi të reflektojmë mbi tekstin e Prustit.

Diferenca më e rëndësishme mes Prustit dhe Barthes-it në dimensionin e kohës manifestohet në faktin se koha fotografike te Barthes-i është e orientuar drejt *hyjnës*, si shfaqje e të ekzistuarit, ndërsa te Prusti, fotografitë regjistrohen në dimensionin kohor të *brezave gjenealogjikë*.

Vepra e Prustit pasqyron një imazh të përfutur nga e kaluara; ajo ka të pranishme një shumësi ndjenjash; Prusti e përshkruan botën duke e parë në kahje të shumëfishta (vizuale, sonore, shijuese, prekëse) dhe përdor fjalët e përzgjedhura mjeshtërisht për të transmetuar këto imazhe. Në këtë kënd shikimi, shkrimi prustian cilësohet fenomenologjik, ai shpjegon se si realja arrin në vetëdije dhe se si imagjinaria transformon perceptimet tona. Fakti i ekzistencës në botë na krijon një imazh që kujtesa na e kthen më intime. Sipas Prustit, kujtesa është depozituese e asaj çka kemi jetuar: emocione, mendime, ndjesi të përfutur nëpërmjet përvojave tona, të cilat kristalizohen në kujtesë dhe, nga aty, na jepin në frymën e imazheve nga e kaluara. Por *kujtesa e vullnetshme* na mundëson që disa nga këto imazhe të zhdukura të na rishfaqen. Vetëm një *kujtesë e pavullnetshme* afektive, e rilindur, lejon ndërtimin në tërësi të imazheve që kujtesa jonë strehon.

Në zemër të veprës së Prustit, guri themeltar i ndërtimit romanesk është koncepti i *kujtesës së pavullnetshme*. Ky nocion, që dallon nga *kujtesa e vullnetshme* (e ndërjegjësuar dhe intelektuale) është themelor për të kuptuar synimin e përpjekjen e shkrimtarit. *Episodi i madlenës* (një lloj keku), i bërë emblematik në veprën prustiane, ilustron në mënyrë të përsosur mekanizmin e *kujtesës së pavullnetshme*. Autori i narrativës, duke shijuar një *madlenë* me çaj, gjendet papritur i zhvendosur në fëmijërinë e tij në Combray. Ky moment i kujtesës intensive, i lëshuar nga një ndjesi e shijes së të ushqyerit, hap rrugën e një serie kujtimesh. Kjo përvojë e ndjeshme bëhet pikënisja e një eksplorimi të së kaluarës, ku kujtimet vijnë jo në mënyrë kronologjike dhe të rregullta, por me shoqërim dhe me rezonancë. *Madlena e Prustit* është bërë, gjithashtu, arketipi i pikëtakimeve të ndjeshmërisë, duke simbolizuar kapacitetin

e së kaluarës për t'u ringritur në të tashmen.

Mëngjezi i princeshës të Guermantes mund të interpretohet si tregimi themelues i një arti të ri të kujtesës dhe të romanit prustian, si një sistem vendesh dhe imazhesh që regjistrohet në kujtesën e lexuesit.

Koncepti prustian i kohës frymëzohet nga filozofia e Henri Bergson-it (1859-1941), ku koha nuk është një vazhdim linear i çasteve, por një përvojë e jetuar, subjektive dhe e rrjedhme. Ky perceptim i kohës shfaqet plotësisht në vëllimin e fundit të *Në kërkim të kohës së humbur*.

Imazhi artistik si vizion i reales

Prusti, adhures i arteve vizuale dhe literaturës, i kushton një vend qendror imazhit artistik në veprën e tij. Arti tek ai është një filtër përmes të cilit rrokët realiteti. Kështu, *Në kërkim të kohës së humbur* nuk është vetëm një arrati nga realiteti aktual, por një mjet për të interpretuar botën, për ta parë me një vështrim të ri, nganjëherë deformues nga projektimet mentale. Kjo tregon rolin specifik të imazhit në sensin estetik, në mënyrën se si personazhet e Prustit perceptojnë botën. Arti, në shkëlqimin e tij, nuk kënaqet nga transformimi i banales, por zbulon dobësitë dhe diferencën tragjike mes një bote të tillë dhe imazhit që ëndërrojmë. Në këtë kuptim, arti transformon realitetin dhe e sublimon.

Historiani dhe kritiku i fotografisë franceze dhe asaj europiane, Jean-François Chevrier (1954), në librin e tij *Prousti dhe fotografia (Proust et la photographie)* propozon një analogji krijimi mes kujtesës së pavullnetshme dhe origjinës së vokacionit letrar të autorit. Në thelb të analogjisë së operacionit fotografik konkretizohen tri kohë: e tashmja, e ardhmja dhe zbulimi i së kaluarës efektive të përjetuar.

Në zemër të teksteve të shkruara nga Jean-François Chevrier-i takohet një projekt sa i thjeshtë, aq dhe radikal, që tregon që fotografia është një nga modelet strukturore të veprës prustiane. Një fotografi është për Prustin gjithmonë një imazh i realizuar, dhe jo një imazh për t'u realizuar.

Në veprën madhore të Prustit, imazhi merr gjerësisht një përmasë sociale. Personazhet evoluojnë në botën mondane, ku prezenca e jashtme çmohet më shumë se realiteti i brendshëm. Sallonet, darkat, ceremonitë bëhen skena ku individët luajnë role, ku imazhi që prezantohet në botë është fabrikuar me kujdes. Prusti tregon në çfarë pike këto imazhe sociale janë ndërtime artificiale dhe maska prapa të cilave fshihen të vërtetat. Kështu, dukësja Guermantes fillimisht duket si një figurë hyjnore, një ikonë e shoqërisë aristokratike, por, më pas, duke ndjekur rrjedhën e subjektit, lexuesi zbulon imazhin e saj të thyer dhe realitetin zhgënjyes - ajo është veçse një grua vulgare. Ky refleksion mbi imazhin social përcakton distancën mes asaj që duhet të tregojmë dhe asaj që jemi. Për Prustin, imazhi shërben si medium për të zbuluar shtresat e së vërtetës, lidhur me perceptimin vizual në thellësinë e brendshme.

Megjithatë "objekti" i Barthes-it dhe ai i Prustit mbeten identikë në përmasën ku të dy autorët kërkojnë të vërtetën (Barthes-i) ose realitetin (Prusti) "të kohës së shkuar", duke risjellë nocionin e kohës. Por as Barthes-i dhe as Prusti nuk tentojnë të gjejnë një realitet historik apo objektiv; përkundrazi, ata kërkojnë një realitet real ndryshe, një të vërtetë subjektive të perceptimeve dhe kujtimeve të tyre. Përgjigjja është e lidhur padyshim me konceptin prustian të kujtesës së pavullnetshme. Kështu, pikërisht kodi artistik fotografik barthesian "kjo ka qenë" rilevon në unitetin paradoksal të kohës, duke krijuar një amalgamë të së kaluarës, të së tashmes dhe të së ardhmes.

Diferenca vendimtare midis "kohës së humbur" të Barthes-it dhe të Prustit është se, te Prusti, e kaluara gjendet në imazhet mentale, ndërsa te Barthes-i, te imazhet fotografike. Ky dallim i qartë midis dy

imazheve është fryt i pikëvështrimit dhe procesit të leximit. Në mënyrë të ngjashme, kujtesa e pavullnetshme e Prustit lidhet me një moment të së kaluarës dhe një moment të së tashmes, ku momenti i së kaluarës është i memorizuar. Edhe pse aspekti i së ardhmes nuk është evident, Prusti nuk lë asnjë dyshim në *Koha e rigjetur (Le temps retrouvé)* mbi efektin e kujtesës së pavullnetshme, e lidhur me zhvillimin e ardhshëm intelektual të "autorit të narrativës".

Por për të rigjetur kohën, është i nevojshëm shfletimi i një albumi imazhesh që në kujtesën tonë ruhen jo si një tablo uniforme dhe që, me procesin e harresës, evoluojnë. Koha që ndryshon qëniet njerëzore, nuk modifikon imazhin që kemi ruajtur për ta, dhe, në këtë kuptim, imazhi fotografik është plotësues dhe i palidhur me emra të veçantë.

Përshkrimet e Prustit janë aq të gjalla dhe me detaje, sa që imazhi tekstori bëhet një imazh fotografik, madje ngjan me një tablo piktore poetike. Prusti zgjedh analogjitë, duke i krahasuar me imazhet e veprave pikturale. Nëse subjekti është i shumëfishtë dhe nuk mund të përshkruhet si një imazh i ngulitur, përdorimi i objekteve piktorese formon një imazh mental përmes një shumice çastesh të dhëna (Albertina, personazh kryesor në veprën e Prustit, krahasohet me një figurë të Mikelanxhelos).

Prusti nuk i ka njohur rregullat e fabrikimit të imazheve dhe të vendeve të rekomanduara nga autorët mediavalë, por ai është frymëzuar nga disa vepra që i respektojnë këto rregulla, të cilat synojnë një relacion historik mes traditës të artit të kujtesës dhe veprës së tij. Ndikimi i këtyre veprave shpjegon rëndësinë e vendeve dhe imazheve në romanin prustian dhe ndikimin që ata kanë mbi kujtesën e lexuesit.

Përvoja subjektive, si dukuri që nxit ndjeshmërinë, luan një rol kryesor në stilin prustian, duke krijuar imazhe të pasura dhe komplekse, ku ndjenjat, ngjyrat, nuhatja e parfumeve përzihen për të formuar kujtime të gjalla. Këto reminishenca të ndjeshme janë në zemër të procesit krijues dhe mundësojnë krijimin e atmosferës së përshtatshme dhe ringjallin momente të së kaluarës me një intensitet të spikatur. Stili prustian bëhet kështu një zbulim i ndjenjave, ku çdo detaj mund të kthehet në një stimul në thellësitë e kujtesës.


Forca e stilit të Prustit konsiston në rinovimin dhe në analizën e dukurive të tilla, si kujtesa, lidhja mes personazhit dhe peizazhit, referencat pikturale, emrat e vendeve, etimologjitë ose titujt e vëllimeve, të cilat përbëjnë prurjen kryesore dhe, ndoshta, zbulimin e "ars memoria" në tekstin prustian.

Në kërkim të kohës së humbur provon se imazhet mund të prodhohen nga fjalët. Prusti shpjegon, së pari, që kujtesa është roja e imazheve të formuara nga një linjë me shumë ndjeshmëri, në të njëjtën kohë që gdhendet te ne dhe rishfaqet me stimulim. Prusti evokon, kështu, lëvizjen e pandërprerë të subjektit me një shumicë imazhesh që shkrimi i atribuon, duke u bërë subjekt scriptural dhe, më vonë, piktural në sytë e lexuesit.

Bibliografi e konsultuar

Bergstein, Mary, *In Looking Back One Learns to See : Marcel Proust and Photography*, Amsterdam, Rodopi, 2013.
 Brassai, *Proust sous l'emprise de la photographie*, Paris, Gallimard, 1997.
 Barthes, Roland, *La Chambre claire*, Cahiers du cinéma, Gallimard, Le Seuil, 1980.
 Barthes Roland *Le Plaisir du texte*, dans *Œuvres complètes*, t. IV, sous la dir. d'Éric Marty, Paris, Éditions du Seuil, 2002.
 Chevrier, Jean François, *Proust et la photographie*, Éditions de l'Étoile (*Cahiers du cinéma*), Paris, 1982.
 Ortel, Philippe, *La Littérature à l'ère de la photographie*, Nîmes, Jacqueline Chambon, 2002.
 Proust Marcel, *À la recherche du temps perdu*, Editions Gallimard, Paris, 1999.

PETER ASSMANN



Hartsdale, New York, 15 mars 2026 - Federata Pan-Shqiptare të Amerikës "VATRA" në bashkëpunim me Shtëpinë Botuese "Onufri" dhe Qendrën Kulturore "Nënë Tereza" pranë Kishës "Zoja e Shkodrës", promovuan romanin "Brenga" të autorit Dr. Pashko R. Camaj. Përveç se një vepër e shkëlqyer letrare, "Brenga", me parathënie nga Visar Zhiti, në vetvete është një dëshmi e krimeve e torturave të regjimit komunist mbi shqiptarët e pafajshëm dhe një homazh për qëndresën, guximin, dinjitetin njerëzor, moralin dhe shpirtin e pathyeshëm shqiptar. Me pjesëmarrjen a aktorëve kryesorë të komunitetit shqiptar, veprimtarëve, studiuesve e atdhetarëve të mërgatës shqiptare në New York e më gjerë, u promovua një letërsi si dëshmi e vërtetësi historike, përgjegjësi kombëtare, kulturore e atdhetare.

Famullitari i Kishës Zoja e Shkodrës Dom Pjetër Popaj në fjalën e tij përmendi kontributin komunitar e vlerat atdhetare të Tonin Mirakajt, qëndresën e shqiptarëve në regjimin diktatorial, vuajtjet e paimagjinueshme të shqiptarëve gjatë regjimit komunist dhe rolin e dëshmitë historike për të pasuruar kujtesën njerëzore e kombëtare.

Kryetari i Federatës Vatra Dr. Elmi Berisha theksoi se personazhi kryesor, i ndërhuar nga ngjarje reale të familjes se Tonin Mirakajt, mbart një "brengë" të përhershme, që është simbol i dhimbjes kolektive të shqiptarëve që u detyruan të braktisnin atdheun nën sistemin komunist. Vlera morale dhe historike e romanit është ruajtja e kujtesës historike në një kohë kur e vërteta rrezikon të zbehet. Kur autori flet për "kujtesën historike", ai e sheh romanin si një mjet për të dokumentuar atë që tekstet zyrtare të historisë shpesh e anashkalojnë: përjetimin njerëzor, dhimbjen dhe të vërtetën e pathëna. Në një kohë kur propaganda ose kalimi i viteve mund ta "zbehin" të vërtetën, romani shndërrohet në një arkiv të gjallë që mbron identitetin e një populli apo të një epoke, theksoi Dr. Berisha.

Poetja Luljeta Lleshanaku në fjalën e saj tha se romani "Brenga" i zotit Camaj, është një provë për qëndrueshmëri dhe fiton një ngjarje historike përmes rrëfimit letrar. Autori ia ka dalë që të shndërrojë përvojën historike në histori njerëzore, duke i mundësuar audiencës të përjetojë ngjarjet në vend që thjesht të mësojë rreth tyre. Autori ia del të menaxhojë mjeshtërisht dramacitetin nga njëri kapitull në tjetrin, duke e lënë për në fund shkarkimin, klimaksin: ritakimin e dy shokëve Tonini e Marku, si përballje e dy epokave! Ky është një nga episodet më emocionues, që gati të lë pa frymë. Ky roman, nuk është thjesht një roman mbi komunizmin në përgjithësi, por mbi një aspekt shumë specifik, që është: përndjekja e bazuar në linjën e gjakut, klasës dhe lidhjeve shoqërore në regjimet komuniste. "Brenga" na ndihmon për të kuptuar brengën e madhe të gjyshërve dhe baballarëve tanë të cilët u detyruan në braktisnin atdheun si emigrantë politikë, duke lënë pas familjet dhe të afërmit e tyre, miqtë e tyre, të cilët u nështruan një kalvari të pashembullt vuajtsh nëpër kampe dhe burgje për 47 vjet me radhë, theksoi ndër të tjera poetja Luljeta Lleshanaku.

Diplomati dhe gazetari Virgjil Kule u shpreh se romani "Brenga" rrjedh si një lumë i rrëmbyeshëm empatie për të vuajturit pa faj. Dy shokë të ngushtë të cilët, në një moment të caktuar të jetës së tyre rinore, detyrohen të ndahen. I pari i jep fund anktheve dhe pasigurisë sociale e fizike duke ndërmarrë një udhëtim rokambolesk arratisjeje në Perëndim, ndërsa i dyti fillon kalvarin e vështirë të stigmës politike dhe burgjeve të diktaturës në vendlindje. Të rrethuar nga mjedise të ndryshme të dy pësojnë transformime thelbësore në mentalitet dhe në këndvështrimet ndaj

“Vatra”, “Onufri” dhe Qendra Kulturore “Nënë Tereza” promovuan romanin “Brenga” të autorit dr.Pashko Camaj

Nga Sokol Paja

fatit dhe fatalitetit. Në fjalët e personazhit Mark, autori Camaj i bën jehonë fjalëve monumentale të Tomas Xhafersonit të integruara në deklaratën amerikane të pavarësisë: "E drejta për të kërkuar lumturinë është një e drejtë fundamentale e patjetërsueshme e cdo njeriu.

Ajo nënkupton realizimin personal, begatinë shpirtërore dhe mirëqënien materiale pa ndërhyrjen e shtetit, me kushtin e vetëm që të mos shkelë të drejtat e tjetrit". Autori bën kështu letërsi për lirinë. Albert Kamy thotë se arti dhe letërsia shpallin lirinë edhe kur ajo duket e pamundur. Në veprën e Pashko Camaj bashkëtojnë si liria e fituar ashtu edhe pamundësia për ta pasur atë. Tonini dhe Marku, dy zogj që ëndëruan qiellin dhe diellin, i cili për ta nuk ndriçoi sipas ligjeve të natyrës por sipas ligjeve të shpirtit të tyre. Te personazhi Mark unë psikologjis diçka nga vetë autori, empathinë, ndjeshmërinë, paqedashjen dhe urtësinë e gjykimit, të cilat duket se ai i ka në doza të larta, tha ndër të tjera diplomati Kule.

Gazetari i shquar i "Zërit të Amerikës" z.Frank Shkreli deklaroi se "Brenga" është një dëshmi morale dhe historike për një epokë që ka lënë plagë të thella në shpirtin e Kombit shqiptar. "Brenga" vjen para nesh si një zë që flet për dhimbjen e sakrificën por dhe për përvojën e një kohe që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në jetën e shumë shqiptarëve. "Brenga" është një rrëfim i thellë njerëzor dhe një dëshmi e fuqishme e kujtesës sonë historike theksoi z.Shkreli. "Brenga" është më shumë se një rrëfim letrar, është një kujtesë e gjallë e dramës njerëzore që përjetoj populli ynë në një periudhë të vështirë të historisë së tij, theksoi ndër të tjera z.Shkreli.


Dr. Ardiana Mici në fjalën e saj theksoi se romani "Brenga" hedh dritë mbi përvojat e dhimbshme të individëve gjatë periudhës së diktaturës komuniste, përvoja që për një kohë të gjatë mbetën të pazëshme. Letërsia e realizmit socialist nuk përcillte vërtetësi, kështu që këto dhimbje kanë qenë të kycura mes vuajtësve dhe shkaktarëve të tyre. Romani Brenga kontribuon në ndërtimin e

një letërsie të kujtesës, e cila synon të ruajë të vërtetën, të nxisë reflektimin dhe ti shërbejë kombit që ngjarje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Romani në thelb është një homazh për qëndrueshmërinë njerëzore, për aftësinë e njeriut për të ruajtur dinjitetin dhe vlerat edhe përballë një sistemi të ndërtuar për ti shkatërruar ato. Në letërsinë që trajton temat e identitetit, emigrimit dhe traumës historike, "Brenga" zë një vend të çmuar si dëshmi artistike dhe njerëzore e një periudhe nga më të vështirat e historisë shqiptare, theksoi ndër të tjera Dr. Mici.

Gazetari i shquar z.Gjekë Gjonlekaj shprehu vlerësim e falënderim ndaj shtëpisë së famshme botuese "Onufri" për botimet cilësore të librave të Martin Camaj e Pashko Camaj dhe përmendi të kaluarën e hershme historike të familjes Camaj. "Brengën" z.Gjonlekaj e cilësoi një vepër të shkëlqyer letrare që depërton thellë në jetën personazheve.

Gazetarja e shquar e "Zërit të Amerikës" znj.Laura Konda në fjalën e lexuar nga Meri Camaj shprehet se "Brenga" i ngjan një skenari filmi, që shpall skena tragjike për syrin e lexuesit. Autori përshkruan paralelisht e me ngjyra reale dy kalvare: nga njëra anë rruga plot peripecira e arratisjes së familjes së Toninit dhe e dy familjeve të tjera. Ata kaptojnë male, lumenj, në mes të të ftohtit të netëve e shiut, të uritur e të rrekosur.

Autori përshkruan paralelisht kalvarin e Markut, që e torturojnë me forma nga më çnjerëzoret për ta detyruar të pohojë se ka bashkëpunuar me Toninin për arratisjen. Përmes personazhit të Markut, autori shpall një ide themelore të romanit, humanizmin. Të burgosurit, edhe pse të rraskapitur, të sakatuar fizikisht e të uritur, nuk e humbën ndjenjën e humanizmit. Historia njerëzore është e mbushur me kapituj të errët, ku pushteti, apo ideologjia kanë tentuar ta zhbëjnë thelbin e qenies njerëzore. Procesi i këtij dehumanizimi nuk synon vetëm dhimbjen fizike, ai synon asgjësimin e identitetit dhe mbi të gjitha, moralit. Por në shumë raste, individit, ndonëse i zhveshur nga çdo liri e jashtme,



refuzon të dorëzojë lirinë e tij të brendshme, thekson në analizën e veprës "Brenga" gazetarja Laura Konda.

Gjon F. Ivezaj prezantoi jetëshkrimin, formimin dhe kontributin komunitar, letrar e atdhetar të Pashko Camajt duke bërë edhe një analizë kritike të romanit "Brenga".

Personazhi i gjallë i romanit "Brenga" z.Tonin Mirakaj në fjalën e tij analizoi veprat e Dr.Pashko Camajt, theksoi pandëshkueshmërinë e dënimit të krimeve të komunizmit në Shqipëri, persekutimin, burgosjen e torturat ndaj familjeve fisnike antikomuniste në regjimin monstruoz e primitiv në komunizëm.

Botuesi i "Brengës" z.Bujar Hudhri në fjalën e tij vlerësoi Vatrën legjendare për vlerat historike dhe ruajtjen e shqiptarisë, vuri theksin se në diktaturë nuk kishte dhimbje e dashuri njerëzore, një kohë ku për krimet e komunizmit nuk kërkoi askush falje. Libri përmban dramën e dhimbshme të arratisjes së shqiptarëve dhe shoqëria shqiptare që nuk u ndërgjegjësu kurrë dhe nuk u vë në vend morali, jetët e shkatërruara e dinjiteti njerëzor. Z. Hudhri analizoi me detaje veprat letrare të Camajt ku historia personale e njerëzore bëhet pronë e të gjithëve në një vepër për të cilën ka interes shoqëria, institucionet, letërsia e historia.

Skenografi e piktori i komunitetit shqiptar në New York, artisti Astrit Tota vlerësoi personalitetin e Dr.Pashko Camajt dhe i dhuroi një portret punuar enkas për këtë ditë.

Autori i romanit "Brenga" Dr. Pashko R. Camaj në fjalën përmbyllëse e falenderuese u shpreh se vepra e tij u jep zë atyre zërave të heshtur dhe të shuar që kurrë nuk u dëgjuan në diktaturë. Në përfundim të promovimit shtëpia botuese "Onufri" shtroi një koktejl për gjithë të pranishmit. Promovimi i "Brengës" shënoi një ngjarje kulturore që bashkoi shqiptarët e Amerikës në një festë libri që përkujton, lirinë, guximin, shpresën e dinjitetin njerëzor.



OKSIMORON

Qepenat gjysmë të mbyllur
Kryet mbështetur mbi oksimoronë
Lajmet që vijnë mbytyrazi nga televizori i fqinjit
Përvelimi i shputave nga zjarrmia e tokës
Parehatia e vendeve intime mbi shezlong
kur gishtat e diellit futen gjithandej
Vramendja për të gjetur diçka tjetër
që peshon sa ty mbi mua
(thjesht, sa për t' u ndjerë më e lehtë, një çast.)
Bipi i lavatriçes që punon nonstop
por nuk i lan dot asnjëherë të gjitha idetë fikse
Zhurma që bëjnë automjetet në nisje ndërsa
ç' nuk bëjmë për të qendruar në periferi të vetes
Aroma e bukës së ngrohtë vërvitur rafteve,
te Mbarimja
si u vervisim fjalët njerëzve ku nuk kemi ndërmend
të rrimë shumë
Fëmijëria e mbathur me sandale me gomë peshku
(Mbj mend cironkat e stufuara për darkë)
Fletët e zhvatura të ditareve ku mbaja shënime
rreth gjithçkaje që nuk ndodhte
Gjithçka që ndodhi dhe nuk u shënua dot në kalendar
Edhe trupi qenka mbështetur mbi oksimoron!

Ajo që dua të them ka të bëjë me pajtimin
si një shumësi mospajtimesh.

NOSTALGIA

Një duhmë e fortë rakie nga një skutë kujtimesh
zbut këtë muzg si gurmaz i përcëlluar dimri
Unë strukesha bri tij dhe nuk di
a e shihja në ëndërr kalin e bardhë
apo avujt e dehur të dhomës e pikturonin,
shpresë e gjallë e një vullneti të topitur
(Herët e pat humbur gjyshi një krah
dhe zemrën fill, një bir)
Ndaj nuk dita, ndoshta, asnjëherë të vërvit
thika fjalësh në ajër dhe kur u gjenda kasaphanave
Kam thithur gjatë ajrin e rënduar të një dhome
me muret përplot me fantazma që më kujton
sa të brishtë janë krahët e kësaj fluturë.

IKJA E DIEJVE

(për Ilir Belliu-n dhe të ikur të tjerë në gjallje)

Ikin diejt ndërsa ushqimet tona gjithnjë e më industriale
I pëgjëjnë mizat e demokracisë me pjesëmarrje
Tash, krahët i rrahin natën,
fluturat
Në pusin e dhimbjes ka më shumë dritë,
ndërsa diejt vazhdojnë e ikin.
Jo se kërkojnë Eldoradon.
Tokat janë zënë që prej fillimit.
Asgjë nuk e përndrit dot babëzinë,
andaj ikën diejt.
Edhe qielli është i vogël tani që linjat ajrore
i kanë ulur çmimet e fluturimeve
e në korridoret e kaltra janë shtuar galopet.
U rrokullisën diejt prej qiejve.
U arratisën prej tokës
për t' u ulur në bashin e erës
për n' Asgjëkund.
Se diejt jetojnë veç në tokat e lira
si toka e përjetshme e harrimit.
Ikën, ikën diejt prej nesh,
marramendthi, si prej dorëzimit.

TRIBUT VJERSHËS

Vjershë, ti që u dukesh pak
disa poetëve.

Me vargje si të tuat shkruajnë
dhe i quajnë poezi.

(Për vepra me peshë duhen fjalë sa më ndërkombëtare.)

Duhet muzë, thonë,
që të ta zgjasë dorën
frymëzim, ndjenjë,
si ato që njeriu s'i njeh ndoshta kurrë.



Ti tingëllon paksa e vjetëruar, vjershë, si unë
që nuk di të shkruaj
për çështjet e ditës.

MUZG

Muzgu i kësaj dite i ngjan një xhakete të dorës së dytë
veshur dikur nga një qytetar i dorës së parë
Varur në kremastarin e një hëne treçerekshe
ia fsheh njollat gri kësaj rruge që zgjatet plot dredha
Symbullur kapërcej një hendek
me iluzionin se gjithçka e kam në kontroll
Bie pikërisht poshtë shigjetave
që shënojnë një vister qytetesh në një tabelë
E kam patur përherë keq me drejtimet e diktuar
Gjithqysh mbeta diktuesja e vetes
Në rrugën e ngushtë sa një fije peri
u shtyva, u zhvata e u çorra
për të mbërritur në këtë muzg të pashkëlqimtë,
ku të vetmet shkëndijime krijohen
nga pikëpjekjet me të parët e mi
dhe shpresa imcake se me pasardhësit
do takohem kur të mos rëndo më asnjë gram.

Një peme me degë të thyera
në pranverën që lind,
pa cicërima, mbytur gjatë rënies,
i ngjaj.

Me drojë shkel tokën, shtrat
i krahut tim të kalbur në të,
as qiellin nuk arrij ta cik,
kështu mbetur cung nga moskuptimi.

Të rrish brenda morsës së paplotësisë
që nga dy anët të shtrëngon,
në një tërheqje të pandalshme
të jetosh,
të dobëson në pikën qendrore,
te e tashmja
që kurrë s'është vërtet e tillë.

Një fidan në bulëzim
dhe një trung i moshuar
me koren plot shenja rrëfenjash
pikëpiqen pafund e më shtangin,
pastaj më nxjerrin nga aksi
i kësaj dite si shumë të tjera
ku jam në kërkim
të pjesëve të mia, dhuatë
prej nënës e babait.

Është Ditë Vere,
ende mund ta shpresoj
një qukapik
të më çukisë ndonjë krimb.

Këmbët?
Ah, gjithnjë e më të drunjta
i ndiej.

GUASKË NË BREG

Të shoh si mbytesh
bashkë me kohën
më rrëshqisni mes gishtash
pas shkumëzim duke lënë
të ngjashëm me atë të deteve
turfullues kur i kalërojnë anije

Kam vënë re se mbytet
ç'është e re dhe e bukur
Pata frikë për shpresën
por e di se njësoj do firojë
dhe në mos e thinjsa ja,
me këto duar
Me ka mbetur aq dritë syri
sa të shquaj si mbytesh
aty ku mbaresh me të rëndë

Veç, deti vazhdon të të nxjerrë
O guaska ime, në breg

PA FILL KUJTESE

Ka një çudi të madhe;
kujtesa jonë individuale
po na lë,
kolektivja rritet
stivuar në arkiva digjitalë.

S' është më dhe aq e nevojshme
që ne të jemi ne
Pa përgjakje a rezistencë
kjo diktaturë!

Dikur, në burgje, në mure skalitej
kujtesa
a në fleta cigaresh.
Ekzistonte një liri në kuti.

Tani, të lirë tundim kokën
vetëm në mënyrë pohore
Pranimi i mohimit tonë
sporti kolektiv ditëve tona.
Qëndrojmë aty të bashkuar
të gjithë
pa mësuar të duhemi më mirë.

Sëmurë jemi shumë,
por plot art
që krijohet në demencë.

Karikaturë nga Arben Mexsi

